



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYEMINISTRIA
MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E
VETËQEVERISJES VENDORE

RAPORT MONITORIMI

mbi Realizimin e Planeve të Integritetit
të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore

*për periudhën
Janar – Dhjetor 2025*



Tiranë, 2026

RAPORT MONITORIMI

mbi Realizimin e Planeve të Integritetit
të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore

për periudhën
Janar – Dhjetor 2025



Tiranë, 2026



RAPORT MONITORIMI

mbi Realizimin e Planeve të Integritetit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore
për periudhën Janar – Dhjetor 2025

Drejtor i Përgjithshëm i Komanduar: Stiljan Llavdaniti

Në përgatitjen e këtij raporti kontribuan:

Olta Caca
Majlinda Rrisa

Redaktimi dhe përpunimi i dizanjit:

Paola Mallkas

Monitorimi i zbatimit të Planeve të Integritetit:

Ajdi Lajthia
Arnela Hetoja
Elda Hysa
Ema Minxolli
Erlisa Labi
Gersi Çabiri
Jonela Gjinaj
Julian Uzeir
Ornela Ruçi
Redi Kala
Sara Dema
Xhanina Llango

E drejta e autorit: AMVV 2026

Ndalohet riprodhimi i këtij botimi apo transmetimi i tij në çfarëdo forme, pa autorizim paraprak me shkrim të mbajtësit të së drejtës së autorit nga AMVV.

AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE

Bulevardi “Zhan d’Ark”, Ish Shtëpia e Ushtarakëve
Tiranë, Shqipëri
www.amvv.gov.al

PËRMBAJTJA

I. Hyrje	6
II. Metodologjia e Vlerësimit.....	6
Raportimet e Dërguara nga Bashkitë	7
Analizimi i Masave dhe Aktiviteteve të Parashikuara në PI Për 2025.....	8
Monitorimi në Terren nga AMVV	8
III. Monitorimi i Zbatueshmërisë së Planeve të Integritetit.....	10
Gjetjet e Raportit	10
IV. Vlerësimi i Shkallës së Zbatueshmërisë së Masave të Planit të Integritetit sipas Objektivave.....	13
Objekti i Specifik – Forcimi i Sistemit të Integritetit në Bashki përmes Sigurimit të një Kuadri të Brendshëm Rregullator	14
Objekti i Specifik – Rritja e Efikasitetit të Sistemit të Integritetit përmes Fuqizimit të Burimeve Njerëzore	15
Objekti i Specifik – Forcimi i Transparencës dhe Llogaridhënies Publike.....	16
Objekti i Specifik – Menaxhimi i Riskut të Integritetit në Fusha të Veçanta të Përgjegjësisë së Bashkisë	17
V. Konkluzione	18
VI. Rekomandime.....	19
Monitorimi i Zbatueshmërisë së Planit të Integritetit për Vitin 2025.....	22
Bashkia Berat	22
Bashkia Dibër.....	28
Bashkia Divjakë	34
Bashkia Dropull.....	44
Bashkia Elbasan	53
Bashkia Finiq.....	62
Bashkia Fushë-Arrëz	72
Bashkia Gramsh	81
Bashkia Has.....	91
Bashkia Himarë	99
Bashkia Klos	106
Bashkia Kolonjë	114
Bashkia Konispol	122
Bashkia Kukës.....	133
Bashkia Kurbin.....	140
Bashkia Libohovë.....	148
Bashkia Librazhd.....	157

Bashkia Lushnjë	163
Bashkia Maliq	173
Bashkia Malësi E Madhe.....	180
Bashkia Patos	189
Bashkia Peqin.....	197
Bashkia Pogradec	205
Bashkia Poliçan	213
Bashkia Prrenjas.....	223
Bashkia Pukë	233
Bashkia Përmet.....	241
Bashkia Roskovec	249
Bashkia Shijak.....	258
Bashkia Tiranë.....	264
Bashkia Tropojë	272
Bashkia Vlorë.....	280
Bashkia Vorë	288
Aneks.....	298
Shkalla e Zbatueshmërisë së Planeve të Integritetit sipas Bashkive, 2025	298

LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Zbatimi i Planit të Integritetit, 2025 (%).....	11
Figura 2. Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025.....	11
Figura 3. Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit sipas bashkive, 2025.....	12
Figura 4. Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit sipas popullsisë së bashkive, 2025	12
Figura 5. Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve sipas objektivave specifike, 2025.....	13
Figura 6. Kuadri Rregullator – Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit.....	14
Figura 7. Burimet Njerëzore – Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit	15
Figura 8. Transparenca dhe Llogaridhënia - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit	16
Figura 9. Fusha të Veçanta – Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit	17

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Plani i punës mbi Monitorimin e Zbatimit të Planit të Integritetit	7
Tabela 2. Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve për 33 bashki, 2025.....	10
Tabela 3. Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve sipas objektivave specifike, 2025	13
Tabela 4. Kuadri Rregullator – Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025.....	14
Tabela 5. Burimet Njerëzore – Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025	15
Tabela 6. Transparenca dhe Llogaridhënia – Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025	16
Tabela 7. Fusha të Veçanta – Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025.....	17

I. Hyrje

Integriteti institucional dhe lufta kundër korrupsionit është një nga prioritetet kryesore të Qeverisë Shqiptare. Në këtë kontekst, Plani i Integritetit përbën një instrument të luftës kundër korrupsionit, i cili u shërben institucioneve për identifikimin, vlerësimin dhe parandalimin e tërësisë së risqeve që çenojnë integritetin. Forcimi i integritetit dhe miratimi i masave sistematike antikorrupsion janë të rëndësishme në kuadër të reformave të administratës publike, pasi nëpërmjet tyre synohet të garantohet një administratë publike profesionale, me etikë, integritet dhe performancë të lartë.

Në qeverisjen vendore, zbatimi dhe monitorimi i politikave kundër korrupsionit është jetësuar përmes koordinimit dhe zbatimit të nismave antikorrupsion të parashikuara në Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit (SNKK) 2015–2023, e cila vijon me Strategjinë 2024–2030 dhe Planin e Veprimit 2024–2026, si dhe Strategjinë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023–2030. Ky proces është gjithashtu në përputhje me rekomandimet e Komisionit Europian për Shqipërinë, në kuadër të procesit të integritetit në Bashkimin Evropian.

Sa më sipër, për garantimin e qeverisjes së mirë, ky instrument parandalues antikorrupsion është fuqizuar duke u bërë pjesë e Udhëzimit të Përbashkët të Ministrisë së Shtetit për Pushtetin Vendor dhe Ministrisë së Financave nr. 1, datë 10.6.2026, “Për kriteret, procedurat dhe treguesit për shpërndarjen e Fondit të Grantit të Bazuar në Përformancë, për bashkitë për vitin 2026”.

Procesi i menaxhimit të riskut të integritetit në nivel vendor zbatohet përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse, që përfshin të gjitha strukturat e brendshme të bashkisë. Hapi i parë i këtij procesi është hartimi i Planit të Integritetit për njësinë vendore, detajuar edhe me një Plan Veprimi afatmesëm. Monitorimi dhe raportimi i këtij plani përbëjnë etapën tjetër të menaxhimit të riskut në bashki. Monitorimi zhvillohet periodikisht (çdo vit) dhe përfshin kryerjen e aktiviteteve nga punonjësit dhe drejtuesit e bashkisë për zbatimin e masave të miratuara për trajtimin e risqeve, në përputhje me përgjegjësitë që ata mbajnë.

Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV), në kuadër të funksioneve të saj për realizimin e objektivave të Qeverisë Shqiptare për garantimin e qeverisjes së mirë, ka vijuar me procesin e monitorimit të zbatimit të Planeve të Integritetit në nivel bashkie për vitin 2025.

II. Metodologjia e Vlerësimit

Raporti i monitorimit të Planeve të Integritetit në nivel bashkie për vitin 2025 rezultate mbi zbatimin e objektivave dhe masave të parashikuara për periudhën e kërkuar, progresin e zhvilluar në kuadër të rritjes së integritetit institucional, burimeve njerëzore të trajnuara dhe kualifikuara, transparencës dhe llogaridhënies, si dhe masat e ndërmarra për plotësimin dhe rishikimin e legjislacionit në fuqi, me qëllim përmirësimin dhe forcimin e integritetit në qeverisjen vendore.

Raporti përmban një analizë të përgjithshme për realizimin e masave/aktiviteteve në bazë të objektivave dhe afateve të përcaktuara në Planin e Veprimit të Planit të Integritetit të bashkive, dhe është hartuar mbi bazën e kontributit të dhënë nga strukturat përgjegjëse për procesin e monitorimit në bashki, nga të dhëna transparente, të besueshme dhe të verifikueshme.

AMVV është struktura përgjegjëse për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave dhe ka kryer koordinimin me të gjitha strukturat përgjegjëse, duke vijuar me hartimin e raporteve të monitorimit për 33 bashki: Berat, Dibër, Divjakë, Dropull, Elbasan, Finiq, Fushë-Arrëz, Gramsh, Has, Himarë, Klos, Kolonjë, Konispol, Kukës, Kurbin, Libohovë, Librazhd, Lushnjë, Malësi e Madhe, Maliq, Patos, Peqin, Përmet, Pogradec, Poliçan, Prrenjas, Pukë, Roskovec, Shijak, Tiranë, Tropojë, Vlorë, Vorë.

AMVV nëpërmjet Urdhrit Nr. 37, datë 17.04.2026, “Për ngritjen e grupit të punës për monitorimit e implementimit të masave të Planeve të Integritetit”, nisi punën me organizimin e takimeve, me ndarjen e detyrave nga kryetarët e grupit dhe monitorimin e zbatimit të planeve të Integritetit për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2025.

Tabela 1. Plani i punës mbi Monitorimin e Zbatimit të Planint të Integritetit

Nr	Detyra për ndjekje	Përgjegjës	Afati
1	Krijim skedari: Evidentimi i numrit dhe masave sipas PI për çdo Bashki	DSP ¹	17.04.2026
2	Analizimi i masave duke i prioritzuar dhe specifikuar mjetin që e bën të verifikueshëm masën/aktivitetin	Grupi i punës	23.04.2026
3	Analizimi i raportimeve paraprake të dërguara me email nga bashkitë	Grupi i punës	23.04.2026
4	Monitorimi në terren, takime mbi mënyrën e raportimit nga bashkitë dhe prezantimi i metodologjisë së raportimit	Grupi i punës	27.04 – 29.05.2026
5	Analizimi dhe verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga bashkitë	Grupi i punës	01 – 25.06.2026
6	Rishikimi dhe konfirmimi i rezultateve	Kryetar i Grupit të punës	29.06 – 03.07.2026
7	Hartimi i raportit përmbledhës të monitorimit të PI 2025 dhe raporteve individuale	Këshilltar Kryetar i Grupit të punës	05.07 – 31.08.2026

Raportimet e dërguara nga Bashkitë

Në kuadër të procesit të monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit për vitin 2025, nga shqyrtimi i raportimeve të paraqitura nga bashkitë janë evidentuar disa mangësi të përsëritura, të cilat ndikojnë në cilësinë, saktësinë dhe krahasueshmërinë e të dhënave.

¹ DSP – Drejtoria Statistikave dhe Performancës në AMVV

Problematikat kryesore:

- Mungesa e përqindjes së realizimit për një pjesë të masave të raportuara si “të realizuara” ose “në proces”, duke e bërë të paqartë nivelin real të progresit;
- Mungesa e dokumentacionit verifikues (akte, vendime, raporte apo evidenca të tjera), që pamundëson konfirmimin objektiv të zbatimit të masave;
- Mospërdorimi i një formati të unifikuar raportimi, duke krijuar paqartësi dhe vështirësi në analizën krahasimore ndërmjet bashkive;
- Mungesa e link-eve për masat që lidhen me publikime online, duke kufizuar verifikimin e transparencës dhe aksesit publik në informacion.

Impakti në procesin e vlerësimit:

- Pasqyrim jo i saktë i nivelit të zbatimit të masave dhe i progresit real;
- Deformim i analizës së performancës së bashkive;
- Ndikim në vendimmarrjen për përfitimin nga granti i bazuar në performancë, me rrezik për kualifikim ose skualifikim jo të drejtë;
- Rritje e numrit të ankesave nga NJVV-të, si pasojë e perceptimit për vlerësim të padrejtë.

Në tërësi, këto mangësi çenojnë integritetin dhe besueshmërinë e procesit të monitorimit, duke evidentuar nevojën për standardizim të raportimit dhe forcim të mekanizmave të verifikimit dhe kontrollit.

Analizimi i masave dhe aktiviteteve të parashikuara në PI për 2025

Një element thelbësor i procesit lidhet me mënyrën e verifikimit dhe dokumentimit të masave. Vlerësimi nuk mbështetet vetëm në raportimin e bashkive, por kërkoi **evidenca konkrete dhe të verifikueshme**, si **dokumente administrative, raporte zbatimi dhe burime të tjera institucionale**. Kjo qasje synon të garantojë që rezultatet të jenë të besueshme, të krahasueshme dhe të mbështetura në prova reale.

Gjatë analizës u bë e mundur identifikimi i mjetit që e bën të verifikueshëm masën dhe aktivitetin në mënyrë të standartizuar, duke theksuar rëndësinë e një raportimi të plotë, të strukturuar dhe të mbështetur në dokumentacion përkatës. Përvoja e mëparshme ka evidentuar mangësi të lidhura kryesisht me mungesën e provave, raportimin e pjesshëm dhe mospërputhjen me të dhënat zyrtare. Për këtë arsye, ky proces synon të unifikojë qasjen e bashkive dhe të rrisë cilësinë, saktësinë dhe besueshmërinë e raportimit.

Monitorimi në terren nga AMVV

Nisur nga problematikat e hasura me raportimin nga NJVV, AMVV synon të standartizojë monitorimin duke asistuar në terren bashkitë dhe prezantuar metodologjinë e raportimit.

Takimet kanë patur në fokus prezantimin e mekanizmit të GBP 2026, i ndërtuar mbi dy komponentët kryesorë: komponentin e planeve vendore dhe komponentin e treguesve të performancës. Komponenti i planeve vendore synon përmirësimin dhe forcimin e dokumenteve strategjike të bashkisë, ndërsa komponenti i performancës fokusohet në matjen e rezultateve konkrete dhe të verifikueshme.

Gjithashtu në takime është prezantuar mënyra e raportimit dhe masat e vitit 2025 të Planeve të Integritetit, si një tregues i përfshirë në mekanizmin e GBP 2026. Vlerësimi mbështetet në nivelin e zbatimit të këtyre masave, ku kërkohet që të paktën 50% e tyre të jenë të realizuara dhe të mbështetura me dokumentacion përkatës. Kjo siguron që përmbushja e tyre të mos jetë vetëm formale, por e provueshme dhe në përputhje me kriteret e mekanizmit.

Të dhënat për hartimin e këtij raporti janë mbledhur dhe raportuar nga Koordinatorët e Integritetit të Njërive të Vetëqeverisjes Vendore. Monitorimi është kryer duke u bazuar në Urdhrin nr. 553, datë 30.09.2021 “Për miratimin e metodologjisë së monitorimit të Planit të Integritetit për institucionet qendrore”, të Ministrit të Drejtësisë.

Planet e integritetit në nivel vendor vlerësojnë risqet e integritetit dhe parashikojnë masa konkrete për forcimin e efikasitetit, transparencës dhe llogaridhënies. Vlerësimi bazohet në metodologjinë përkatëse për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, sipas fushave të përgjegjësisë së bashkisë dhe kuadrit rregullator të brendshëm.

Në kontekstin e këtij raporti, objektivat e përfshira në planet e veprimit të Planeve të Integritetit në nivel bashkie, pavarësisht mënyrës së formulimit të tyre nga secila bashki, përmbledhen në katër objektiva kryesorë:

- Forcimi i sistemit të integritetit në bashki, përmes sigurimit të një kuadri të brendshëm rregullator me qasje pro-integriteti;
- Rritja e efikasitetit të sistemit të integritetit në bashki përmes menaxhimit efektiv të burimeve njerëzore dhe financiare;
- Forcimi i transparencës, efikasitetit sipas fushave të përgjegjësisë dhe llogaridhënies publike të bashkisë;
- Menaxhimin e riskut të integritetit në fusha të veçanta të përgjegjësisë së bashkisë.

Sa më sipër, ky raport analizon të dhënat sipas katër kategorive:

- E realizuar: masa/aktivitete që janë përmbushur plotësisht;
- Pjesërisht e realizuar / në proces: masa/aktivitete që janë përmbushur pjesërisht ose vijnë në proces;
- E parealizuar: masa/aktivitete që nuk kanë regjistruar progres gjatë periudhës raportuese, ose për të cilat nuk është dhënë raportim nga struktura përgjegjëse.

Në përfundim të analizës, shkalla e zbatimit të Planit të Integritetit vlerësohet përmes një treguesi të përgjithshëm, i cili përmbledh vlerësimin sipas objektivave, duke u dhënë peshë të barabartë secilit objektiv. Në këtë mënyrë, treguesi i vlerësimit të zbatueshmërisë së Planit të Integritetit në bashki varion nga 0% deri në 100%, duke reflektuar nivelin e zbatimit.

Duke qenë se monitorimi i kryer është cilësor dhe jo sasior, ndarja në nivele vlerësimi e Planeve të Integritetit nuk është matematikisht uniforme.

III. Monitorimi i Zbatueshmërisë së Planeve të Integritetit

Monitorimi synon të identifikojë dhe të vërë në funksion mekanizmat e nevojshëm për minimizimin e faktorëve që lidhen me shkaqe, raste apo mundësi të krijuara, të cilat shërbejnë si bazë për shfaqjen e fenomeneve korruptive. Në këtë mënyrë, ai kontribuon në menaxhimin efektiv të fushave me risk dhe në sigurimin e ofrimit të shërbimeve publike cilësore, të paanshme dhe të përgjegjshme ndaj qytetarëve. Vlerësimi i zbatimit të Planeve të Integritetit në nivel bashkie synon njëkohësisht të identifikojë ndryshime të mundshme për rishikimin e Metodologjisë së Vlerësimit të Riskut për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, të kuptojë në mënyrë të thelluar gjendjen e deritanishme të zbatimit të planeve të integritetit, si dhe të identifikojë sfidat dhe pengesat për zbatimin efikas të tyre, të vlerësojë ndikimin e planit të integritetit në reduktimin e praktikave korruptive dhe të hartojë rekomandime për të ardhmen.

Nga ky proces, në vijim të përpjekjeve për të konsoliduar integritetin institucional në nivel vendor dhe për ta mbrojtur nga cenimi i tij, gjatë periudhës janar–dhjetor 2025 janë shënuar disa arritje: nga llogaritja e shkallës së zbatueshmërisë së Planeve të Integritetit rezulton se planet e veprimit janë realizuar mesatarisht në masën 53.1% (nga 22% deri në 87%), duke arritur kështu nivelin bazë të zbatimit të planeve të integritetit në nivel kombëtar. Në nivel bashkie, ka bashki që kanë arritur nivel realizimi mbi mesataren (60–70%), si dhe bashki me nivel të lartë realizimi (80–90%).

Gjetjet e raportit



Monitorimi i zbatimit të masave të parashikuara në Planet e Integritetit në nivel vendor është një hap i rëndësishëm për të garantuar integritetin institucional. Konkretisht, nëpërmjet hartimit të raportit të monitorimit synohet:

- Mbikëqyrja e vazhdueshme e nivelit të zbatimit të masave të parashikuara në plan;
- Forcimi i llogaridhënies publike dhe transparencës në institucion, për të siguruar rritjen e besueshmërisë publike;
- Rishikimi dhe plotësimi i vazhdueshëm i legjislacionit në fuqi, me qëllim përmirësimin dhe forcimin e integritetit.

Për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2025, në Planet e Integritetit të 33 bashkive janë parashikuar për zbatim **962 masa/aktivitete** për realizimin e objektivave. Nga procesi i monitorimit rezulton se janë përmbushur plotësisht **511 masa/aktivitete (53%)**, 51 masa/aktivitete janë në proces (5%) dhe 400 masa/aktivitete (42%) nuk janë realizuar.

Tabela 2. Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve për 33 bashki, 2025

	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të pa realizuara
Numri i masave / aktiviteteve	962	511	51	400
Në % ndaj totalit	100%	53.1%	5.3%	41.6%

Figura 1. Zbatimi i Planit të Integritetit, 2025 (%)**Figura 2. Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025**


Nga monitorimi i realizimit të masave dhe aktiviteteve të ndërmarra nga bashkitë, evidentohet në përgjithësi përmirësimi i shkallës së integritetit institucional, e cila përfshin miratimin e kodeve të sjelljes, përmirësimin e praktikave të menaxhimit të burimeve njerëzore, si dhe plotësimin dhe publikimin e programeve të transparencës në faqet zyrtare të NJVV-ve.

Zbatimi i Planeve të Integritetit ka sjellë efekte pozitive në procedurat e prokurimeve publike, llogaridhënien dhe forcimin e rolit të audituesve të brendshëm, qartësimin e detyrave të personelit, si dhe përmirësimin e transparencës me komunitetin, veçanërisht në treguesit financiarë. Progres është konstatuar në ngritjen dhe funksionimin e njësive të sinjalizuesve, si dhe në krijimin dhe mirëmbajtjen e regjistrave për shmangien e konfliktit të interesit, për dhuratat, si dhe për administrimin e ankesave dhe kërkesave të qytetarëve.

Monitorimi i zbatimit të masave të përcaktuara në Planet e Veprimit përbën një mekanizëm të rëndësishëm për vlerësimin e impaktit të këtyre masave. Zbatimi i masave me efektivitet është një tregues pozitiv i përparimeve në parandalimin e korrupsionit dhe përmirësimin e integritetit në nivel vendor.


Referuar grafikut të mëposhtëm, 22 nga 33 bashki rezultojnë mbi mesataren kombëtare prej 53.1% nga të cilat me shkallën më të lartë të realizimit për vitin 2025 janë Prrenjasi (87%), Tirana (83%) dhe Elbasani (82%). Nivelet më të ulëta shënohen nga Vlora (22%), Dibra (25%) dhe Malësi e Madhe (27%).

Figura 3. Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit sipas bashkive, 2025



Sipas ndarjes së bashkive në grupe madhësie të popullsisë, bashkia me nivelin më të lartë të realizimit në grupin deri në 10.000 banorë është Libohova (70%), në grupin 10.000–50.000 banorë është Prrenjasi (87%), ndërsa në grupin 50.000–150.000 banorë renditet Elbasani (82%). Bashkia Tiranë, e vetmja në kategorinë e vet, shënon një nivel realizimi prej 83%. Performanca e lartë shfaqet në secilin grup madhësie dhe jo vetëm në një prej tyre, çka mbështet konkluzionin se faktorë të tjerë institucionalë (kapaciteti administrativ, angazhimi i strukturave përgjegjëse) ndikojnë më shumë se madhësia e bashkisë.

Figura 4. Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit sipas popullsisë së bashkive, 2025



IV. Vlerësimi i Shkallës së Zbatueshmërisë së Masave të Planit të Integritetit sipas Objektivave


Impakti i zbatimit të masave të përfshira në Planet e Integritetit në nivel vendor lidhet drejtpërdrejt me nivelin e realizimit të objektivave të planifikuara. Pavarësisht mënyrës së formulimit të këtyre objektivave nga secila bashki, siç theksuam edhe më lart, Planet e Integritetit me funksion parandalues ndaj korrupsionit kanë synuar të forcojnë kuadrin rregullator dhe të nxisin krijimin e një kulture organizative të orientuar drejt integritetit, në katër fusha kryesore:

- së pari, në përmirësimin dhe zbatimin e kuadrit të brendshëm rregullator për çështje të veçanta që lidhen me integritetin;
- së dyti, në fuqizimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore nëpërmjet rekrutimit të personelit të kualifikuar dhe ofrimit të trajnimeve të vazhdueshme, për t'u bërë rezistentë ndaj shkeljeve të mundshme të integritetit;
- së treti, në rritjen dhe konsolidimin e transparencës institucionale, në përputhje me fushat përkatëse të përgjegjësisë.
- së katërti, në menaxhimin e riskut të integritetit në fusha të veçanta të përgjegjësisë së bashkisë.

Tabela 3. Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve sipas objektivave specifike, 2025

Objektivat specifike	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të pa realizuara
Përmirësimi i Kuadrit Rregullator	318	143	17	158
Fuqizimi i Burimeve Njerëzore	290	163	17	110
Forcimi i transparencës dhe llogaridhënies publike	219	138	11	70
Menaxhimi i riskut të integritetit në fusha të veçanta	135	67	6	62

Figura 5. Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve sipas objektivave specifike, 2025



Objektivi specifik – Forcimi i sistemit të integritetit në bashki përmes sigurimit të një kuadri të brendshëm rregullator


Përmes këtij objektivi synohet përmirësimi dhe forcimi i integritetit në nivel vendor nëpërmjet miratimit dhe zbatimit të kuadrit të nevojshëm rregullator për parandalimin e korrupsionit, i cili është edhe hapi i parë i shprehjes së vullnetit dhe angazhimit institucional për të promovuar një kulturë pro-integritet.

Ky objektivi për vitin 2025 përmban një numër prej **318 masash** specifike të planifikuara për t'u zbatuar nga bashkitë dhe 45% e tyre janë realizuar, të cilat i referohen **kuadrit rregullator të brendshëm të integritetit**. Në shumicën e bashkive vihet re një përmirësim i dukshëm i rregulloreve të brendshme, kodeve të etikës dhe akteve të tjera të orientuara drejt minimizimit të sjelljeve joetike apo të dëmshme. Këto përmirësime kanë kontribuar ndjeshëm në ndërtimin e një kulture institucionale pro-integritet, ku etika konsiderohet si një komponent thelbësor i procesit vendimmarrës.

Tabela 4. Kuadri Rregullator – Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objektivi specifik	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të pa realizuara
Përmirësimi i Kuadrit Rregullator	318	143	17	158
Në % ndaj objektivit	100%	45.0%	5.3%	49.7%

Figura 6. Kuadri Rregullator – Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Bashkitë që kanë arritur rezultatet më të mira në drejtim të aspektit të ndryshimit të kuadrit rregullator dhe forcimit të kulturës pro-integritet janë Elbasan, Fushë-Arrëz, Has, Klos dhe Tiranë me një realizim prej 100%, të cilat kanë kontribuar ndjeshëm në ndërtimin e një kulture institucionale pro-integritet, ku etika konsiderohet si një komponent thelbësor i procesit vendimmarrës. Nivelet më të ulëta të realizimit për këtë objektivi shënohen nga bashkitë Vlorë (20%), Malësi e Madhe (24%) dhe Divjakë (27%).

Njëkohësisht janë përmirësuar mekanizmat e auditimit të brendshëm, ndërkohë që janë krijuar dhe funksionalizuar instrumente të posaçme për sinjalizimin e shkeljeve dhe për mbrojtjen e sinjalizuesve, duke mundësuar identifikimin më të hershëm i problematikave dhe janë ndërmarrë veprime parandaluese më efikase, ndaj rreziqeve që çenojnë integritetin institucional.

Objektivi specifik – Rritja e efikasitetit të sistemit të integritetit përmes fuqizimit të burimeve njerëzore


Ky objektivi synon të forcojë mekanizmat që lidhen me garantimin e integritetit, duke përmirësuar menaxhimin dhe kapacitetet e burimeve njerëzore të bashkisë. Nëpërmjet përmirësimit të proceseve të menaxhimit të burimeve njerëzore në institucion sigurohen kapacitetet dhe aftësitë e nevojshme për zbatimin dhe konsolidimin e mekanizmave garantues të integritetit, me qëllim rritjen e profesionalizmit të personelit dhe zhvillimin në karrierë të zyrtarëve, në përputhje me performancën e tyre në punë.

Ky objektivi për vitin 2025 përmban një numër prej **290 masash** specifike të planifikuara për t'u zbatuar nga bashkitë e përfshira dhe 56% e tyre janë realizuar, të cilat i referohen **fuqizimit të burimeve njerëzore** nëpërmjet vendosjes së linjave të qarta hierarkike, sanksionimit të një procedure të qartë për të gjitha proceset e punës në bashki, trajnimit dhe forcimit të kapaciteteve njerëzore e profesionale të fushës, si dhe rekrutimit të stafit në mungesë, në përputhje me strukturën dhe organikën në fuqi dhe kuadrin rregullator të brendshëm të integritetit.

Tabela 5. Burimet Njerëzore – Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objektivi Specifik	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të pa realizuara
Fuqizimi i Burimeve Njerëzore	290	163	17	110
Në % ndaj totalit	100%	56.2%	5.9%	37.9%

Figura 7. Burimet Njerëzore – Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Ndikimi i masave të Planit të Integritetit në menaxhimin me integritet të burimeve njerëzore dhe financiare ka nxjerrë në pah një lidhje të qartë midis forcimit të kulturës organizative pro-integritet dhe përmirësimit të mirë-menaxhimit institucional. Edhe pse kjo lidhje nuk është gjithmonë e drejtpërdrejtë, rezultatet tregojnë se promovimi i integritetit në strukturat organizative përforcon ndjeshëm kapacitetet për menaxhim të përgjegjshëm dhe transparent.

Në përgjithësi, bashkitë kanë ndërmarrë masa të rëndësishme në drejtim të trajnimit të stafit, vlerësimit të performancës, përmirësimit të përshkrimeve të vendeve të punës, si dhe rritjes së transparencës në proceset e rekrutimit, dhe vërehet një tendencë pozitive drejt vlerësimit të meritokracisë dhe profesionalizmit. Bashkitë me shkallën më të lartë të realizimit për këtë objektiv janë Klos (100%), Konispol (87%), Pukë (83%) dhe Prrenjas (80%), ndërsa nivelet më të ulëta shënohen nga Peqin (8%), Malësi e Madhe (25%) dhe Vlorë (30%).

Objektivi specifik – Forcimi i transparencës dhe llogaridhënies publike


Transparenca e bashkisë gjatë procesit të zbatimit të politikave vendore është shumë e rëndësishme për rritjen e pjesëmarrjes së aktorëve të ndryshëm në veprimtarinë e bashkisë dhe të publikut në tërësi. Në këtë kuadër, është me rëndësi edhe siguri i pjesëmarrjes së publikut në procesin e identifikimit të prioritetëve strategjike afatgjata. Për këtë arsye, bashkia angazhohet të forcojë mekanizmat e pjesëmarrjes për shoqërinë civile dhe grupe të veçanta interesi, gjatë hartimit dhe konsultimit të dokumenteve të politikave të ndryshme vendore.

Ky objektiv për vitin 2025 përmban një numër prej **219 masash** specifike të planifikuara për t'u zbatuar nga bashkitë dhe 63% e tyre janë realizuar, të cilat i referohen **transparencës dhe llogaridhënies**.

Tabela 6. Transparenca dhe Llogaridhënia – Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objektivi Specifik	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në process	Masa të pa realizuara
Forcimi i transparencës dhe llogaridhënies	219	138	11	70
Në % ndaj totalit	100%	63%	5%	32%

Figura 8. Transparenca dhe Llogaridhënia - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Zbatimi i këtyre masave ka ndikuar pozitivisht në forcimin e këtyre dy elementëve ku, shumica e bashkive përfshirë edhe disa bashki të vogla kanë shënuar përparim të ndjeshëm në transparencën proaktive, kryesisht përmes përditësimit të rregullt të faqeve zyrtare. Referuar të dhënave të grafikut më sipër ndikimi më i lartë (100%) është evidentuar në bashkitë Libohovë, Kurbin, Peqin, Prrenjas dhe Lushnje, ndërsa bashkitë Fushë-Arrëz, Has dhe Maliq nuk kanë realizuar asnjë masë të këtij objekti specifik.

Transparenca dhe llogaridhënia rezulton si objekti specifik më i suksesshëm, duke reflektuar edhe një prioritet të qartë të bashkive për forcimin e llogaridhënies dhe përfshirjen e publikut për vitin 2025. Njëkohësisht, nëpërmjet përfshirjes së komunitetit në konsultime dhe raportimeve të hapura, është forcuar ndjeshëm perceptimi i integritetit dhe përgjegjshmërisë nga qytetarët.

Objekti specifik – Menaxhimi i riskut të integritetit në fusha të veçanta të përgjegjësisë së bashkisë


Ky objektiv adreson risqet e integritetit në fushat funksionale të përgjegjësisë së bashkisë, të cilat paraqesin një nivel të lartë ekspozimi ndaj rrezikut të korrupsionit, si menaxhimi financiar, menaxhimi i pronave dhe asetëve publike, shërbimet publike, planifikimi i territorit dhe arkivimi. Nëpërmjet forcimit të integritetit në këto fusha synohet përmirësimi i efektivitetit, efikasitetit dhe cilësisë së proceseve të punës në bashki.

Ky objektiv për vitin 2025 përmban një numër prej **135 masash** specifike të planifikuara për t'u zbatuar nga bashkitë dhe 50% e tyre janë realizuar, të cilat i referohen **fushave të veçanta të përgjegjësisë së bashkive**.

Tabela 7. Fusha të Veçanta – Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objekti Specifik	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të pa realizuara
Menaxhimi i riskut të integritetit në fusha të veçanta	135	67	6	62
Në % ndaj totalit	100%	50%	4%	46%

Figura 9. Fusha të Veçanta – Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Bashkitë me shkallën më të lartë të realizimit për këtë objektiv janë Prrenjas dhe Tiranë (100%), Gramsh (71%), ndërsa nivelet më të ulëta shënohen në Fushë-Arrëz (17%), ndërsa Finiq dhe Dibër nuk kanë realizuar asnjë masë të këtij objekti specifik. Bashkitë e vogla dhe të mesme paraqesin performancë të përzier në këtë objektiv, duke reflektuar shkallë të ndryshme angazhimi institucional në menaxhimin financiar, të pronave dhe të shërbimeve publike.

V. Konkluzione

Ky raport monitorimi është hartuar në përputhje me metodologjinë për hartimin e raportit të monitorimit të Planit të Integritetit, të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr. 553, datë 30.09.2021 “Për miratimin e metodologjisë së monitorimit të Planit të Integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore”.

Raporti jep informacion përmblledhës mbi zbatueshmërinë e masave dhe aktiviteteve, realizueshmërinë e treguesve sipas vlerave të synuara dhe atyre të arritura, të parashikuara në Planin e Veprimit 2025 për realizimin e objektivave të Planit të Integritetit, nga 33 bashkitë në procesin e monitorimit.

Për periudhën janar–dhjetor 2025, bazuar në evidencat dhe raportimet e bashkive si edhe analizën e verifikimit të këtyre evidencave, rezultojnë se:

- Nga 962 masa/aktivitete të planifikuara në Planet e Integritetit të 33 bashkive, paraqitet një nivel bazë i zbatimit në shkallë kombëtare:
 - 511 masa janë realizuar plotësisht (53%);
 - 51 masa janë në proces realizimi (5%);
 - 400 masa nuk janë realizuar (42%).
- Bashkitë Prrenjas (87%), Tiranë (83%) dhe Elbasan (82%) shënojnë nivelet më të larta të realizimit të plotë të masave;
- Objektivi specifik për Transparencën dhe Llogaridhënien shënon shkallën më të lartë të realizimit në krahasim me objektivat e tjerë (63%), ndjekur nga objektivi specifik për Burimet Njerëzore (56%), objektivi specifik për Fusha të Veçanta (50%) dhe objektivi specifik për Kuadrin Rregullator (45%).
- Performanca e bashkive nuk rezulton e përcaktuar në mënyrë mekanike nga madhësia e popullsisë së tyre - brenda çdo grupi madhësie evidentohen si bashki me nivel të lartë realizimi, ashtu edhe bashki me nivel të ulët, çka sugjeron praninë e faktorëve të tjerë përveç madhësisë demografike. Identifikimi i saktë i këtyre faktorëve kërkon analizë shtesë, përfshirë të dhëna mbi kapacitetin administrativ dhe angazhimin e strukturave përgjegjëse në secilën bashki.
- Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore kanë vijuar punën për përmirësimin e kuadrit rregullator dhe forcimin e etikës institucionale, kanë ndërmarrë masa për trajnimin e stafit, vlerësimin e performancës dhe përmirësimin e proceseve të rekrutimit;

- Është konstatuar përmirësim i mekanizmave të auditimit të brendshëm dhe janë ndërtuar instrumente për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, në zbatim të akteve ligjore në fuqi.
- Bashkitë kanë vijuar me përmirësimin e transparencës në ofrimin e informacionit mbi aktivitetin e tyre për publikun, nëpërmjet përditësimit të faqeve zyrtare.

VI. Rekomandime

Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi për periudhën janar–dhjetor 2025, bazuar në gjetjet, evidencat e raportuara nga strukturat e bashkive, si dhe në analizën e kryer të monitorimit, rekomandohet të ndërmerren hapat si më poshtë:

- Të përfundohen masat/aktivitet ende të pararealizuara në Planet e Integritetit, me prioritet masat me afat të tejkaluar;
- Të përditësohet kuadri rregullator i brendshëm për integritetin institucional, për forcimin e etikës institucionale;
- Të organizohen trajnime periodike për stafin, me qëllim fuqizimin e kapaciteteve në menaxhimin e riskut të integritetit;
- Bashkitë me nivel të ulët realizimi të masave/aktiviteteve nën 40%, konkretisht Berat, Dibër, Finiq, Malësi e Madhe dhe Vlorë, nevojitet të rishikojnë vlerësimin e riskut të integritetit dhe të hartojnë një plan veprimi me prioritete, afate dhe përgjegjësi të qarta;
- Të përgatitet institucionalisht zbatimi i metodologjisë së re të hartimit dhe monitorimit të Planeve të Integritetit në Qeverisjen Vendore, pas miratimit të saj.



RAPORT MONITORIMI

mbi Realizimin e Planeve të Integritetit
të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore

BASHKIA BERAT

për periudhën
Janar – Dhjetor 2025

Monitorimi i zbatueshmërisë së Planit të Integritetit për vitin 2025

Raporti i Monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit të **Bashkisë Berat** për vitin 2025 përbën dokumentin e parë të Planit vijues të Integritetit të hartuar në përputhje me Metodologjinë e Monitorimit të Planit të Integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore, të miratuar me urdhrin e Ministrit të Drejtësisë 553, datë 30.09.2021.

Plani i Integritetit është konceptuar për t'u zbatuar përgjatë një periudhe katër-vjeçare, konkretisht 2025-2028.

Në Planin e Integritetit të bashkisë janë përcaktuar gjithsej tre objektiva kryesorë, për të cilat janë parashikuar fushat me risk, si dhe janë planifikuar masat dhe aktivitetet për realizimin e tyre, si vijon:

- **Objektivi I** - Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit.
- **Objektivi II** - Forcimi i rezistencës institucionale ndaj shkeljeve të integritetit nëpërmjet konsolidimit të menaxhimit dhe zhvillimit të burimeve njerëzore në bashki.
- **Objektivi III** - Forcimi i transparencës dhe efikasitetit sipas fushave të përgjegjësisë dhe llogaridhënies publike të bashkisë.

Për bashkinë Berat, Plani i Integritetit për periudhën janar-dhjetor 2025, referuar Planit të Veprimit, përmban masa dhe aktivitete të planifikuara sipas objektivave të përcaktuara në Planin e Veprimit.

Situata e monitorimit të Planit të Integritetit të Bashkisë Berat për periudhën janar–dhjetor 2025



Nga procesi i monitorimit rezulton se, në totalin prej 29 masash (aktivitetesh) të parashikuara për zbatim për vitin 2025:

- 11 masa/aktivitete janë realizuar plotësisht, që përfaqëson 38% të totalit
- 6 masa/aktivitete janë në proces realizimi, ose 21%
- 12 masa/aktivitete mbeten të porealizuara, ose 41%

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun vijues.

Tabela 8. Shkalla e realizimit të masave/aktiviteve, 2025

Bashkia Berat	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të porealizuara
Numri i masave / aktiviteteve	29	11	6	12

Figura 10. Zbatimi i Planit të Integritetit, 2025 (%)**Figura 11. Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025**

Bashkia Berat, gjatë vitit 2025, ka bërë një hap fillestar në drejtim të zbatimit të planit të veprimit të Planit të Integritetit, me 38% të realizimit të planit të veprimit.

Gjetjet e Raportit

Objektivi I - Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit

Ky objektiv synon forcimin e kuadrit të brendshëm rregullator për etikën dhe integritetin, në përputhje me kornizën ligjore për vetëqeverisjen vendore, të drejtën e informimit, konsultimin publik, menaxhimin dhe kontrollin financiar, sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesit, parandalimin e konfliktit të interesit, etj.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objektivi, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 14 masa/aktivitete, nga të cilat:

- Janë realizuar 5 masa/aktivitete ose 35.7%
- Janë në proces realizimi 4 masa/aktivitete ose 28.6%


- Nuk janë realizuar 5 masa/aktivitete ose 35.7%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 9. Objektivi I - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objektivi I	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Përmirësimi i Kuadrit Rregullator	14	5	4	5

Figura 12. Objektivi I - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, bashkia ka realizuar masa/aktivitete si:

- Organizimi i trajnimeve të brendshme lidhur me çështjet e etikës dhe integritetit për personelin e bashkisë.

Objektivi II - Forcimi i rezistencës institucionale ndaj shkeljeve të integritetit nëpërmjet konsolidimit të menaxhimit dhe zhvillimit të burimeve njerëzore në bashki

Ky objektivi synon të forcojë mekanizmat që lidhen me garantimin e integritetit duke përmirësuar menaxhimin dhe kapacitetet e burimeve njerëzore të bashkisë. Nëpërmjet përmirësimit të proceseve të menaxhimit të burimeve njerëzore në institucion, do të sigurohen kapacitetet dhe aftësitë e nevojshme për zbatimin dhe konsolidimin e mekanizmave garantues të integritetit në institucion, me qëllim rritjen e profesionalizimit të personelit dhe zhvillimin në karrierë të zyrtarëve, në përputhje me performancën e tyre në punë.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objektivi, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 12 masa/aktivitete, nga të cilat:


- Janë realizuar 5 masa/aktivitete ose 41.6%
- Janë në proces realizimi 2 masa/aktivitete ose 16.7%
- Nuk janë realizuar 5 masa/aktivitete ose 41.7%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 10. Objektivi II - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objektivi II	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të porealizuara
Fuqizimi i Burimeve Njerëzore	12	5	2	5

Figura 13. Objektivi II - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, për këtë objektiv janë realizuar masa/aktivitete si më poshtë:

- Hartimi i një plani për zhvillimin e PSV-ve dhe gjurmëve të auditit për të gjitha llojet e auditimit.

Objektivi III - Forcimi i transparencës dhe efikasitetit sipas fushave të përgjegjesisë dhe llogaridhënies publike të bashkisë

Transparenca e bashkisë gjatë procesit të zbatimit të politikave vendore është shumë e rëndësishme për rritjen e pjesëmarrjes së aktorëve të ndryshëm në veprimtarinë e bashkisë dhe të publikut në tërësi. Në këtë kuadër, është me rëndësi edhe siguri i pjesëmarrjes së publikut në procesin e identifikimit të prioritetëve strategjike afatgjata. Për këtë arsye, bashkia angazhohet të forcojë mekanizmat e pjesëmarrjes për shoqërinë civile dhe grupe të veçanta të interesit, gjatë hartimit dhe konsultimit të dokumenteve të politikave të ndryshme vendore.


Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objekti, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 3 masa/aktivitete, nga të cilat:

- Janë realizuar 1 masë/aktivitet ose 33%
- Nuk janë realizuar 2 masa/aktivitete ose 67%

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 11. Objektivi III - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objektivi III	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Forcimi i transparencës dhe llogaridhënies	3	1	0	2

Figura 14. Objektivi III - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit

Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, objektivi është realizuar në masën 33%, me zbatimin e masave/aktiviteteve si më poshtë:

- Plotësimi i Programit të Transparencës së bashkisë me informacionin e kërkuar në përbushje të detyrimeve ligjore për transparencë proactive.

Konkluzione

Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi për periudhën raportuese janar-dhjetor 2025, bazuar në gjetjet që ky dokument ofron, të dhënat analitike të raportuara nga drejtoritë përkatëse dhe analizën e kryer, rezulton se Bashkia Berat ka vijuar me zbatimin e Planit të Integritetit, por nuk ka arritur nivelin minimal të zbatimit të masave të planifikuara për vitin 2025 (40-60%), duke realizuar 38 % të masave të planifikuara për vitin 2025.

Rekomandime

- Bashkia Berat duhet të kryejë një analizë të shkaqeve të mosrealizimit të masave/aktiviteteve të planifikuara;
- Të rishikojë vlerësimin e riskut të integritetit institucional dhe të hartojë një plan veprimi me prioritet, afate dhe përgjegjësi të qarta;
- Të forcojë mekanizmat e monitorimit dhe të sigurojë angazhimin e strukturave drejtuese për përbushjen dhe zbatimin e Planit të Veprimit të Planit të Integritetit brenda afateve të përcaktuara.



RAPORT MONITORIMI

mbi Realizimin e Planeve të Integritetit
të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore

BASHKIA DIBËR

për periudhën
Janar – Dhjetor 2025

Monitorimi i zbatueshmërisë të Planit të Integritetit

Raporti i Monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit të **Bashkisë Dibër** për vitin 2025 përbën dokumentin e parë të monitorimit të planit të veprimit të Planit të Integritetit të bashkisë. Plani i Integritetit është konceptuar për t'u zbatuar përgjatë një periudhe katërvjeçare, konkretisht 2025-2028.

Në Planin e Integritetit të bashkisë janë përcaktuar gjithsej dy objektiva, për të cilat janë parashikuar fushat me risk, si dhe janë planifikuar masat dhe aktivitetet për realizimin e tyre, si vijon:

- **Objektivi I** - Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit, me qëllim funksionimin efektiv të menaxhimit të riskut dhe përmirësimin e performancës.
- **Objektivi II** - Përmirësimi i procedurave të kontrollit dhe monitorimit, forcimi i integritetit në proceset dhe fushat funksionale të bashkisë.

Për bashkinë Dibër, Plani i Integritetit për periudhën janar-dhjetor 2025, referuar Planit të Veprimit, përmban masa dhe aktivitete të planifikuara në mbështetje të objektivave të planifikuara.

Situata e monitorimit të Planit të Integritetit të Bashkisë Dibër për periudhën janar–dhjetor 2025



Nga procesi i monitorimit rezulton se, në totalin prej 4 masash (aktivitetesh) të parashikuara për zbatim për vitin 2025:

- 1 masë/aktivitet është realizuar plotësisht, që përfaqëson 25% të totalit
- 0 masa/aktivitete janë në proces realizimi, ose 0%
- 3 masa/aktivitete mbeten të porealizuara, ose 75%

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun vijues.

Tabela 12. Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Bashkia Dibër	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të porealizuara
Numri i masave / aktiviteteve	4	1	0	3

Figura 15. Zbatimi i Planit të Integritetit, 2025 (%)*Figura 16. Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025*

Sa më sipër, gjatë vitit 2025, Bashkia Dibër ka filluar të bëjë hapa fillestare në drejtim të forcimit të qeverisjes së mirë dhe integritetit institucional.

Gjetjet e Raportit

Objektivi I - Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit, me qëllim funksionimin efektiv të menaxhimit të riskut dhe përmirësimin e performancës

Ky objektivi synon adresimin e risqeve të integritetit në fushat funksionale të përgjegjësisë së bashkisë. Masat e parashikuara synojnë të përmirësojnë efektivitetin, eficiencën dhe cilësinë e proceseve të punës në fushat funksionale të bashkisë, me qëllim përmirësimin e shërbimeve publike, planifikimin e territorit, menaxhimin e pronave dhe aseteve publike, menaxhimin financiar, etj.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objektivi, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar në vijimësi gjithsej 3 masa/aktivitete, nga të cilat:


- Janë realizuar 1 masë/aktivitet ose 33%
- Nuk janë realizuar 2 masa/aktivitete ose 67%

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 13. Objektivi I - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objektivi I	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Forcimi i Kuadrit Rregullator	3	1	0	2

Figura 17. Objektivi I - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektivi është realizuar në masën 33%, me zbatimin e masave/aktiviteteve si më poshtë:

- Harmonizim i Kodit të Etikës në përputhje me Ligjin Nr.9131/2003, VKM-në nr. 714/2004, si dhe kuadrin rregullator horizontal për shmangien e konfliktit të interesit, mbrojtjen e të dhënave personale etj.

Objektivi II - Përmirësimi i procedurave të kontrollit dhe monitorimit, forcimi i integritetit në proceset dhe fushat funksionale të bashkisë

Nëpërmjet këtij objektivi synohet menaxhimi i riskut të integritetit në fushat kryesore të përgjegjësisë së bashkisë, duke u fokusuar në proceset e punës të vlerësuara si më të ekspozuarat ndaj rrezikut të korrupsionit. Në tërësinë e tij, menaxhimi i integritetit i bashkisë paraqet sfida, të cilat janë parashikuar edhe në Strategjinë për Qeverisjen Vendore dhe që hasen më së shumti në fusha të veçanta të përgjegjësisë, të tilla si fusha e menaxhimit financiar, menaxhimi i pronave të bashkisë, shërbimet publike dhe arkivimi.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objektivi, për vitin 2025 është planifikuar për t'u realizuar gjithsej 1 masë/aktivitet, e cila:


- Nuk është realizuar, ose 0%

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 14. Objektivi II - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objektivi II	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Përmirësimi i Procedurave të Kontrollit	1	0	0	1

Figura 18. Objektivi II - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektiv nuk është realizuar.

Konkluzione

Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi për periudhën raportuese janar-dhjetor 2025, bazuar në gjetjet që ky dokument ofron, të dhënat analitike të raportuara nga drejtoritë përkatëse dhe analizën e kryer, rezulton se:

Bashkia Dibër ka vijuar me zbatimin e Planit të Integritetit, por nuk ka arritur nivelin minimal të zbatimit të masave të planifikuara për vitin 2025 (40-60%), duke realizuar vetëm 25% të masave të planifikuara për vitin 2025.

Rekomandime

- Bashkia Dibër të kryejë një analizë të shkaqeve të mosrealizimit të masave/aktiviteteve të planifikuara;
- Të rishikojë vlerësimin e riskut të integritetit institucional dhe të hartojë një plan veprimi me prioritet, afate dhe përgjegjësi të qarta;
- Të forcojë mekanizmat e monitorimit dhe të sigurojë angazhimin e strukturave drejtuese për përmbushjen dhe zbatimin e Planit të Veprimit të Planit të Integritetit brenda afateve të përcaktuara.



RAPORT MONITORIMI

mbi Realizimin e Planeve të Integritetit
të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore

BASHKIA DIVJAKË

për periudhën
Janar – Dhjetor 2025

Monitorimi i zbatueshmërisë të Planit të Integritetit për vitin 2025

Raporti i Monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit të **Bashkisë Divjakë** për vitin 2025 përbën dokumentin e parë të monitorimit të planit të veprimit të Planit të Integritetit të bashkisë.

Plani i Integritetit është konceptuar për t'u zbatuar përgjatë një periudhe trevjeçare, konkretisht 2025-2027.

Në Planin e Integritetit të bashkisë janë përcaktuar gjithsej katër objektiva, për të cilat janë parashikuar fushat me risk, si dhe janë planifikuar masat dhe aktivitetet për realizimin e tyre, si vijon:

- **Objektivi I** - Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit;
- **Objektivi II** - Menaxhimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore në bashki, për identifikimin dhe parandalimin e risqeve të integritetit;
- **Objektivi III** - Përmirësimi i transparencës proaktive për të mundësuar rritjen e llogaridhënies dhe aksesit të qytetarëve në informacion;
- **Objektivi IV** - Menaxhimi i riskut të integritetit në fusha të veçanta të përgjegjësisë së bashkisë;

Për bashkinë Divjakë, Plani i Integritetit për periudhën janar-dhjetor 2025, referuar Planit të Veprimit, përmban masa dhe aktivitete të planifikuara sipas objektivave të përcaktuara në Planin e Veprimit.

Situata e monitorimit të Planit të Integritetit të Bashkisë Divjakë për periudhën janar–dhjetor 2025



Nga procesi i monitorimit rezulton se, në totalin prej 41 masash (aktivitetesh) të parashikuara për zbatim për vitin 2025:

- 22 masa/aktivitete janë realizuar plotësisht, që përfaqëson 54% të totalit
- 3 masa/aktivitete janë në proces realizimi, ose 7%
- 16 masa/aktivitete mbeten të porealizuara, ose 39%

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun vijues.

Tabela 15. Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Bashkia Divjakë	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të porealizuara
Numri i masave / aktiviteteve	41	22	3	16

Figura 19. Zbatimi i Planit të Integritetit, 2025 (%)**Figura 20. Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025**

Bashkia Divjakë, gjatë vitit 2025, ka ndërmarrë hapa në drejtim të forcimit të qeverisjes së mirë dhe integritetit institucional. Në këtë kuadër, ka hartuar dhe miratuar disa dokumente strategjike që adresojnë forcimin e etikës dhe integritetit, përmirësimin e funksionimit të strukturave vendore antikorrupsion, konsolidimin e kuadrit të brendshëm institucional, zhvillimin dhe fuqizimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore, rritjen e rezistencës institucionale ndaj risqeve të integritetit, si dhe përmirësimin e transparencës dhe besueshmërisë publike.

Gjetjet e Raportit

Objektivi I - Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit

Ky objektivi synon forcimin e kuadrit të brendshëm rregullator për etikën dhe integritetin, në përputhje me kornizën ligjore për vetëqeverisjen vendore, të drejtën e informimit, konsultimin publik, menaxhimin dhe kontrollin financiar, sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesit, parandalimin e konfliktit të interesit, etj.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objekti, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 11 masa/aktivitete, nga të cilat:


- Janë realizuar 3 masa/aktivitete ose 27%
- Janë në proces realizimi 2 masa/aktivitete ose 18%
- Nuk janë realizuar 6 masa/aktivitete ose 55%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 16. Objekti I - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objekti I	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Forcimi i Kuadrit Rregullator	11	3	2	6

Figura 21. Objekti I - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektiv është realizuar në masën 27%, me zbatimin e masave/aktiviteteve si më poshtë:

- Krijimi i regjistrimit për deklarimin e konfliktit të interesit në bashki;
- Krijimi i regjistrimit për deklarimin e dhuratave në bashki;
- Përfundimi i procedurave të rekrutimit për të gjitha pozicionet e punës që janë pjesë e shërbimit civil.

Objekti II - Menaxhimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore në bashki, për identifikimin dhe parandalimin e risqeve të integritetit

Ky objektiv synon të forcojë mekanizmat që lidhen me garantimin e integritetit duke përmirësuar menaxhimin dhe kapacitetet e burimeve njerëzore të bashkisë. Nëpërmjet përmirësimit të proceseve të menaxhimit të burimeve njerëzore në institucion, do të sigurohen kapacitetet dhe aftësitë e nevojshme për zbatimin dhe konsolidimin e mekanizmave garantues

të integritetit në institucion, me qëllim rritjen e profesionalizimit të personelit dhe zhvillimin në karrierë të zyrtarëve, në përputhje me performancën e tyre në punë.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objekti, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 18 masa/aktivitete, nga të cilat:


- Janë realizuar 11 masa/aktivitete ose 61%
- Janë në proces realizimi 0 masa/aktivitete ose 0%
- Nuk janë realizuar 7 masa/aktivitete ose 39%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 17.Objekti II - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objekti II	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Fuqizimi i Burimeve Njerëzore	18	11	0	7

Figura 22.Objekti II - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektiv është realizuar në masën 61%, me zbatimin e masave/aktiviteteve si më poshtë:

- Plotësimi me kapacitete të duhura i sektorit të burimeve njerëzore;
- Komunikimi nëpërmjet kërkesës zyrtare me Departamentin e Administratës Publike për marrjen e aksesit në sistemin HRMIS;
- Trajnimi i specialistit të IT;
- Organizimi i trajnimeve për personelin në lidhje me çështje të etikës dhe parandalimit të konfliktit të interesit;
- Sigurimi i rotacionit të vazhdueshëm të anëtarëve të KVO-së, për të shmangur mbingarkesën në punë dhe ekspozimin e lartë ndaj situatave të konfliktit të interesit;

- Trajnimi i vazhdueshëm i punonjësve mbi ndryshimet ligjore në fushën e prokurimit publik, në bashkëpunim me ASPA-n;
- Plotësimi i kapaciteteve teknike dhe në burime njerëzore;
- Analizë gjithëpërfshirëse e nevojës së stafit për trajnime mbi fushat e tyre të veprimtarisë;
- Bashkëpunim me ASPA apo institucionet përkatëse të specializuara për realizimin e trajnimeve;
- Dedikim i një fondi të veçantë në buxhetin e bashkisë për trajnime specifike që nuk ofrohen falas nga institucionet përkatëse;
- Ofrimi i trajnimeve të personelit të njësisë së integritetit evropian, financës dhe sektorit juridik, në këtë fushë.

Objektivi III - Përmirësimi i transparencës proaktive për të mundësuar rritjen e llogaridhënies dhe aksesit të qytetarëve në informacion

Transparenca e bashkisë gjatë procesit të zbatimit të politikave vendore është shumë e rëndësishme për rritjen e pjesëmarrjes së aktorëve të ndryshëm në veprimtarinë e bashkisë dhe të publikut në tërësi. Në këtë kuadër, është me rëndësi edhe siguri i pjesëmarrjes së publikut në procesin e identifikimit të prioritetëve strategjike afatgjatë. Për këtë arsye, bashkia angazhohet të forcojë mekanizmat e pjesëmarrjes për shoqërinë civile dhe grupe të veçanta të interesit, gjatë hartimit dhe konsultimit të dokumenteve të politikave të ndryshme vendore.


Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objekti, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 10 masa/aktivitete, nga të cilat:

- Janë realizuar 7 masa/aktivitete ose 70%
- Janë në proces realizimi 1 masë/aktivitet ose 10%
- Nuk janë realizuar 2 masa/aktivitete ose 20%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 18. Objektivi III - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objektivi III	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Forcimi i transparencës dhe llogaridhënies	10	7	1	2

Figura 23. Objektivi III - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit

Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektivi është realizuar në masën 70%, me zbatimin e masave/aktiviteteve si më poshtë:

- Publikimi i regjistrit të kërkesave në programin e transparencës;
- Publikimi i regjistrit të kontratave për pronat në pronësi ose administrim të bashkisë në faqen zyrtare të bashkisë;
- Marrja e masave për publikimin e rregulloreve mbi sinjalizimin dhe njësinë përgjegjëse në faqen zyrtare të bashkisë;
- Marrja e masave për publikimin e regjistrit në programin e transparencës;
- Publikimi i informacionit publik me fokus procesin e konsultimeve publike, si dhe atë të pjesëmarrjes në vendimmarrjen e bashkisë;
- Marrja e masave për përditësimin e faqes zyrtare të bashkisë, në seksionin “Taksa dhe Tarifa Vendore”;
- Publikimi i taksave dhe tarifave vendore për vitin aktual.

Objektivi IV - Menaxhimi i riskut të integritetit në fusha të veçanta të përgjegjësisë së bashkisë

Nëpërmjet këtij objektivi synohet menaxhimi i riskut të integritetit në fushat kryesore të përgjegjësisë së bashkisë, duke u fokusuar në proceset e punës të vlerësuara si më të ekspozuarat ndaj rrezikut të korrupsionit. Në tërësinë e tij, menaxhimi i integritetit i Bashkisë Divjakë paraqet sfida, të cilat janë parashikuar edhe në Strategjinë për Qeverisjen Vendore dhe që hasen më së shumti në fusha të veçanta të përgjegjësisë, të tilla si fusha e menaxhimit financiar, menaxhimi i pronave të bashkisë, shërbimet publike dhe arkivimi.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objektivi, për vitin 2025 janë planifikuar për t’u realizuar gjithsej 2 masa/aktivitete, nga të cilat:


- Janë realizuar 1 masë/aktivitet ose 50%
- Nuk janë realizuar 1 masë/aktivitet ose 50%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 19. Objektivi IV - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objektivi IV	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Fusha të Veçanta	2	1	0	1

Figura 24. Objektivi IV - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektivi është realizuar në masën 50%, me zbatimin e masave/aktiviteteve si më poshtë:

- Ndjekja e të gjitha procedurave ligjore për të siguruar arkëtimin e detyrimeve nga debitorët e taksave dhe tarifave vendore.

Konkluzione

Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi për periudhën raportuese janar-dhjetor 2025, bazuar në gjetjet që ky dokument ofron, të dhënat analitike të raportuara nga drejtoritë përkatëse dhe analizën e kryer, rezulton se:

Bashkia Divjakë ka vijuar me zbatimin e Planit të Integritetit, duke arritur një nivel realizimi prej 54% të masave të planifikuara për vitin 2025 (në intervalin 40-60%). Gjatë kësaj periudhe janë realizuar dhe arritur rezultate në drejtim të:

- Ngritjes së nivelit të transparencës me 70%;
- Trajnimeve dhe aktiviteteve që mbështesin etikën institucionale;
- Trajnimit dhe zhvillimit të burimeve njerëzore;
- Rritjes së nivelit të transparencës dhe llogaridhënies.

Rekomandime

- Të vijojë puna për realizimin e masave/aktiviteteve të planifikuara në Planin e Integritetit;
- Të zbatohen masat dhe aktivitetet për fuqizimin e kuadrit të brendshëm rregullator mbi etikën dhe integritetin institucional;
- Të rritet niveli i koordinimit dhe bashkëpunimit ndërmjet drejtorive, për një raportim më të rregullt mbi masat e Planit të Integritetit;
- Sigurimi i një raportimi periodik, përmes publikimit të raporteve 6-mujore mbi zbatimin e Planit të Integritetit;
- Trajnimi në vijimësi i Koordinatorit të Integritetit të bashkisë.



RAPORT MONITORIMI

mbi Realizimin e Planeve të Integritetit
të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore

BASHKIA DROPULL

për periudhën
Janar – Dhjetor 2025

Monitorimi i zbatueshmërisë të Planit të Integritetit për vitin 2025

Raporti i Monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit të **Bashkisë Dropull** për vitin 2025 përbën dokumentin e parë të monitorimit të planit të veprimit të Planit të Integritetit të bashkisë.

Plani i Integritetit është konceptuar për t'u zbatuar përgjatë një periudhe trevjeçare, konkretisht 2025-2027.

Në Planin e Integritetit të bashkisë janë përcaktuar gjithsej katër objektiva, për të cilat janë parashikuar fushat me risk, si dhe janë planifikuar masat dhe aktivitetet për realizimin e tyre, si vijon:

- **Objektivi I** - Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit;
- **Objektivi II** - Menaxhimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore në bashki, për identifikimin dhe parandalimin e risqeve të integritetit;
- **Objektivi III** - Rritja e transparencës dhe llogaridhënies publike;
- **Objektivi IV** - Menaxhimi i riskut të integritetit në fusha të veçanta të përgjegjësisë së bashkisë;

Për bashkinë Dropull, Plani i Integritetit për periudhën janar-dhjetor 2025, referuar Planit të Veprimit, përmban masa dhe aktivitete të planifikuara sipas objektivave të përcaktuara në Planin e Veprimit.

Situata e monitorimit të Planit të Integritetit të Bashkisë Dropull për periudhën janar–dhjetor 2025



Nga procesi i monitorimit rezulton se, në totalin prej 45 masash (aktivitetesh) të parashikuara për zbatim për vitin 2025:

- 18 masa/aktivitete janë realizuar plotësisht, që përfaqëson 40% të totalit
- 1 masë/aktivitet është në proces realizimi, ose 2%
- 26 masa/aktivitete mbeten të porealizuara, ose 58%

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun vijues.

Tabela 20. Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Bashkia Dropull	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të porealizuara
Numri i masave / aktiviteteve	45	18	1	26

Figura 25. Zbatimi i Planit të Integritetit, 2025 (%)**Figura 26. Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025**

Bashkia Dropull, gjatë vitit 2025, ka ndërmarrë hapa në drejtim të forcimit të qeverisjes së mirë dhe integritetit institucional. Në këtë kuadër, ka hartuar dhe miratuar disa dokumente strategjike që adresojnë forcimin e etikës dhe integritetit, përmirësimin e funksionimit të strukturave vendore antikorruption, konsolidimin e kuadrit të brendshëm institucional, zhvillimin dhe fuqizimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore, rritjen e rezistencës institucionale ndaj risqeve të integritetit, si dhe përmirësimin e transparencës dhe besueshmërisë publike.

Gjetjet e Raportit

Objektivi I - Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit

Ky objektivi synon forcimin e kuadrit të brendshëm rregullator për etikën dhe integritetin, në përputhje me kornizën ligjore për vetëqeverisjen vendore, të drejtën e informimit, konsultimin publik, menaxhimin dhe kontrollin financiar, sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesit, parandalimin e konfliktit të interesit, etj.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objekti, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 23 masa/aktivitete, nga të cilat:


- Janë realizuar 9 masa/aktivitete ose 40%
- Është në proces realizimi 1 masë/aktivitet ose 4%
- Nuk janë realizuar 13 masa/aktivitete ose 56%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 21. Objekti I - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objekti I	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Forcimi i Kuadrit Rregullator	23	9	1	13

Figura 27. Objekti I - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektiv është realizuar në masën 40%, me zbatimin e masave/aktiviteteve si më poshtë:

- Përditësimi (dhe miratimi) i rregullores së bashkisë me strukturën aktuale;
- Përcaktimi i plotë dhe i qartë në rregullore i detyrave dhe linjave të komunikimit dhe hierarkisë ndërmjet strukturave të bashkisë;
- Hartimi dhe miratimi i Kodit të Sjelljes për administratën e bashkisë, duke përfshirë rregulla në lidhje me parandalimin dhe deklarimin e konfliktit të interesit, veprimtaritë e jashtme, pranimin dhe deklarimin e dhuratave, si dhe deklarimin e pasurisë;
- Përcaktimi në Rregulloren e Brendshme i detyrimit për hartimin e Planit Vjetor të Trajnimeve;
- Përcaktimi në Rregulloren e Brendshme i detyrimit për kryerjen e Analizës Vjetore të Performancës, si bazë për identifikimin e nevojave për trajnim dhe hartimin e Planit Vjetor të Trajnimeve;
- Hartimi i Planit të Brendshëm të Trajnimeve dhe Analizës së Performancës, çdo vit;

- Ngritja e një grupi pune me urdhër të titullarit, për hartimin e standardeve të cilësisë për çdo shërbim;
- Hartimi i standardeve të administrimit të performancës;
- Publikimi i instrumentit të miratuar dhe treguesve përkatës të performancës në Programin e Transparencës së bashkisë.

Objektivi II - Menaxhimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore në bashki, për identifikimin dhe parandalimin e risqeve të integritetit

Ky objektivi synon të forcojë mekanizmat që lidhen me garantimin e integritetit duke përmirësuar menaxhimin dhe kapacitetet e burimeve njerëzore të bashkisë. Nëpërmjet përmirësimit të proceseve të menaxhimit të burimeve njerëzore në institucion, do të sigurohen kapacitetet dhe aftësitë e nevojshme për zbatimin dhe konsolidimin e mekanizmave garantues të integritetit në institucion, me qëllim rritjen e profesionalizimit të personelit dhe zhvillimin në karrierë të zyrtarëve, në përputhje me performancën e tyre në punë.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objektivi, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 14 masa/aktivitete, nga të cilat:


- Janë realizuar 7 masa/aktivitete ose 50%
- Janë në proces realizimi 0 masa/aktivitete ose 0%
- Nuk janë realizuar 7 masa/aktivitete ose 50%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 22. Objektivi II - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objektivi II	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Fuqizimi i Burimeve Njerëzore	14	7	0	7

Figura 28. Objektivi II - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektiv është realizuar në masën 50%, me zbatimin e masave/aktiviteteve si më poshtë:

- Marrja e masave për trajnimin e punonjësve lidhur me standardet e cilësisë dhe monitorimin e ofrimit të shërbimeve publike;
- Përfshirja e tyre në Planin Vjetor të Trajnimeve;
- Informimi i të gjithë punonjësve mbi rregulloren e sinjalizuesit dhe vënia në dispozicion e saj;
- Rikujtesë periodike e punonjësve mbi funksionin dhe kontaktin e sinjalizuesit;
- Publikimi i informacionit për njësinë e sinjalizimit dhe për kontaktet e saj në Programin e Transparencës;
- Hartimi i planeve vjetore të punës për çdo drejtori të bashkisë;
- Dorëzimi i tyre pranë titullarit të bashkisë.

Objektivi III - Rritja e transparencës dhe llogaridhënies publike

Ky objektiv synon të forcojë strukturat dhe mekanizmat që funksionojnë në nivelin e vetëqeverisjes vendore, të cilat kontribuojnë në rritjen e integritetit institucional dhe veprojnë si instrumente antikorrupsion. Këto struktura dhe mekanizma ngrihen dhe funksionojnë në përputhje me kornizën ligjore për vetëqeverisjen vendore, të drejtën e informimit, konsultimin publik, menaxhimin dhe kontrollin financiar, sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesit, parandalimin e konfliktit të interesit, etj.


Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objektivi, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 4 masa/aktivitete, nga të cilat:

- Është realizuar 1 masë/aktivitet ose 25%
- Janë në proces realizimi 0 masa/aktivitete ose 0%
- Nuk janë realizuar 3 masa/aktivitete ose 75%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 23. Objektivi III - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objektivi III	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Forcimi i transparencës dhe llogaridhënies	4	1	0	3

Figura 29. Objektivi III - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit

Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektiv është realizuar në masën 25%, me zbatimin e masave/aktiviteteve si më poshtë:

- Publikimi në Programin e Transparencës i informacionit për donacionet e përfituara nga bashkia, duke përfshirë emrin e donatorit, shumën e donacionit dhe qëllimin e donacionit.

Objektivi IV - Menaxhimi i riskut të integritetit në fusha të veçanta të përgjegjësisë së bashkisë

Nëpërmjet këtij objektivi synohet menaxhimi i riskut të integritetit në fushat kryesore të përgjegjësisë së bashkisë, duke u fokusuar në proceset e punës të vlerësuara si më të ekspozuarat ndaj rrezikut të korrupsionit. Në tërësinë e tij, menaxhimi i integritetit i Bashkisë Dropull paraqet sfida, të cilat janë parashikuar edhe në Strategjinë për Qeverisjen Vendore dhe që hasen më së shumti në fusha të veçanta të përgjegjësisë, të tilla si fusha e menaxhimit financiar, menaxhimi i pronave të bashkisë, shërbimet publike dhe arkivimi.


Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objektivi, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 4 masa/aktivitete, nga të cilat:

- Është realizuar 1 masë/aktivitet ose 25%
- Janë në proces realizimi 0 masa/aktivitete ose 0%
- Nuk janë realizuar 3 masa/aktivitete ose 75%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 24. Objektivi IV - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objektivi IV	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Fusha të Veçanta	4	1	0	3

Figura 30. Objektivi IV - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit

Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektivi është realizuar në masën 25%, me zbatimin e masave/aktiviteteve.

Konkluzione

Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi për periudhën raportuese janar-dhjetor 2025, bazuar në gjetjet që ky dokument ofron, të dhënat analitike të raportuara nga drejtoritë përkatëse dhe analizën e kryer, rezulton se:


Bashkia Dropull ka vijuar me zbatimin e Planit të Integritetit, duke arritur një nivel fillestar të planit të veprimit, me një nivel realizimi prej 40% të masave të planifikuara për vitin 2025 (në intervalin 40-60%). Gjatë kësaj periudhe janë realizuar disa arritje në drejtim të:

- Ngritjes së kulturës së integritetit dhe llogaridhënies në bashki;
- Trajnimit dhe zhvillimit të burimeve njerëzore;
- Njohjes së personelit me bazën ligjore antikorrupsion.

Masat dhe aktivitetet e realizuara në kuadër të zbatimit të Planit të Integritetit kanë dhënë një ndikim fillestar në rritjen e shkallës së kulturës së integritetit institucional. Si rezultat, janë hartuar disa dokumente strategjike mbi etikën në aspekte të punës dhe të shërbimeve të ofruara, si dhe fuqizimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore nëpërmjet trajnimeve dhe njohjes së paketës ligjore antikorrupsion.

Rekomandime

- Të vijohet me zbatimin e masave/aktiviteteve të planifikuara në Planin e Integritetit;
- Rritja e pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje;
- Forcimi i koordinimit dhe bashkëpunimit ndërmjet drejtorive, për një raportim më të rregullt mbi masat e Planit të Integritetit;
- Sigurimi i një raportimi periodik transparent, përmes publikimit të raporteve 6-mujore mbi zbatimin e Planit të Integritetit.



RAPORT MONITORIMI

mbi Realizimin e Planeve të Integritetit
të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore

BASHKIA ELBASAN

për periudhën
Janar – Dhjetor 2025

Monitorimi i zbatueshmërisë të Planit të Integritetit për vitin 2025

Raporti i Monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit të **Bashkisë Elbasan** për vitin 2025 përbën dokumentin e parë të monitorimit të planit të veprimit të Planit të Integritetit të bashkisë.

Plani i Integritetit është konceptuar për t'u zbatuar përgjatë një periudhe katërvjeçare, konkretisht 2025-2028.

Në Planin e Integritetit të bashkisë janë përcaktuar gjithsej katër objektiva, për të cilat janë parashikuar fushat me risk, si dhe janë planifikuar masat dhe aktivitetet për realizimin e tyre, si vijon:

- **Objektivi I** - Konsolidimi i sistemit të integruar të Menaxhimit të Riskut të Integritetit;
- **Objektivi II** - Transparencë dhe llogaridhënie;
- **Objektivi III** - Zhvillim i Burimeve Njerëzore;
- **Objektivi IV** - Mekanizma të Pjesëmarrjes Qytetare.

Për bashkinë Elbasan, Plani i Integritetit për periudhën janar-dhjetor 2025, referuar Planit të Veprimit, përmban masa dhe aktivitete të planifikuara sipas objektivave të përcaktuara në Planin e Veprimit.

Situata e monitorimit të Planit të Integritetit të Bashkisë Elbasan për periudhën janar–dhjetor 2025



Nga procesi i monitorimit rezulton se, në totalin prej 28 masash (aktivitetesh) të parashikuara për zbatim për vitin 2025:

- 23 masa/aktivitete janë realizuar plotësisht, që përfaqëson 82% të totalit
- 0 masa/aktivitete janë në proces realizimi, ose 0%
- 5 masa/aktivitete mbeten të parealizuara, ose 18%

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun vijues.

Tabela 1. Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Bashkia Elbasan	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Numri i masave / aktiviteteve	28	23	0	5

Figura 1. Zbatimi i Planit të Integritetit, 2025 (%)**Figura 2. Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025**

Bashkia Elbasan, gjatë vitit 2025, ka ndërmarrë një sërë hapash në drejtim të forcimit të qeverisjes së mirë dhe integritetit institucional. Në këtë kuadër, ka hartuar dhe miratuar disa dokumente strategjike që adresojnë forcimin e etikës dhe integritetit, përmirësimin e funksionimit të strukturave vendore antikorruption, konsolidimin e kuadrit të brendshëm institucional, zhvillimin dhe fuqizimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore, rritjen e rezistencës institucionale ndaj risqeve të integritetit, si dhe përmirësimin e transparencës dhe besueshmërisë publike.

Gjetjet e Raportit

Objektivi I - Konsolidimi i sistemit të integruar të Menaxhimit të Riskut të Integritetit

Ky objektivi synon forcimin e kuadrit të brendshëm rregullator për etikën dhe integritetin, në përputhje me kornizën ligjore për vetëqeverisjen vendore, të drejtën e informimit, konsultimin

publik, menaxhimin dhe kontrollin financiar, sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesit, parandalimin e konfliktit të interesit, etj.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objekti, për vitin 2025 është planifikuar për t'u realizuar gjithsej 1 masë/aktivitet, e cila:


- Është realizuar, ose 100%

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 2. Objekti I - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objekti I	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të përealizuara
Konsolidimi i Sistemit të Menaxhimit të Riskut	1	1	0	0

Figura 3. Objekti I - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektiv është realizuar në masën 100%, me zbatimin e masave/aktiviteteve si më poshtë:

- Draft ndryshimesh, konsultim dhe miratim i Kodit Etik.

Objekti II - Transparencë dhe llogaridhënie

Transparenca e bashkisë gjatë procesit të zbatimit të politikave vendore është shumë e rëndësishme për rritjen e pjesëmarrjes së aktorëve të ndryshëm në veprimtarinë e bashkisë dhe të publikut në tërësi. Në këtë kuadër, është me rëndësi edhe siguri i pjesëmarrjes së publikut në procesin e identifikimit të prioritetëve strategjike afatgjatë. Për këtë arsye, bashkia angazhohet të forcojë mekanizmat e pjesëmarrjes për shoqërinë civile dhe grupe të veçanta të interesit, gjatë hartimit dhe konsultimit të dokumenteve të politikave të ndryshme vendore.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objekti, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 4 masa/aktivitete, nga të cilat:

- Janë realizuar 3 masa/aktivitete ose 75%


- Janë në proces realizimi 0 masa/aktivitete ose 0%
- Nuk është realizuar 1 masë/aktivitet ose 25%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 3. Objektivi II - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objektivi II	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të porealizuara
Transparencë dhe Llogaridhënie	4	3	0	1

Figura 4. Objektivi II - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektivi është realizuar në masën 75%, me zbatimin e masave/aktiviteteve si më poshtë:

- Raportimi publik vjetor mbi numrin e projekt-vendimeve të publikuara paraprakisht dhe komentet e marra;
- Krijimi i një seksioni të dedikuar “Konsultim Publik”, ku vendosen projekt-vendimet, afatet dhe mënyrat e dërgimit të komenteve;
- Publikimi në faqen zyrtare të bashkisë të të gjitha projekt-vendimeve që plotësojnë kriteret, minimum 10 ditë pune para miratimit.

Objektivi III - Zhvillim i Burimeve Njerëzore

Ky objektivi synon të forcojë mekanizmat që lidhen me garantimin e integritetit duke përmirësuar menaxhimin dhe kapacitetet e burimeve njerëzore të bashkisë. Nëpërmjet përmirësimit të proceseve të menaxhimit të burimeve njerëzore në institucion, do të sigurohen kapacitetet dhe aftësitë e nevojshme për zbatimin dhe konsolidimin e mekanizmave garantues të integritetit në institucion, me qëllim rritjen e profesionalizimit të personelit dhe zhvillimin në karrierë të zyrtarëve, në përputhje me performancën e tyre në punë.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objekti, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 10 masa/aktivitete, nga të cilat:


- Janë realizuar 7 masa/aktivitete ose 70%
- Janë në proces realizimi 0 masa/aktivitete ose 0%
- Nuk janë realizuar 3 masa/aktivitete ose 30%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 4. Objekti III - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objekti III	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Zhvillimi i Burimeve Njerëzore	10	7	0	3

Figura 5. Objekti III - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektiv është realizuar në masën 70%, me zbatimin e masave/aktiviteteve si më poshtë:

- Publikimi i të dhënave në faqen e bashkisë;
- Raportim gjashtëmuor mbi përbërjen gjinore të aplikantëve dhe fituesve;
- Hartimi i udhëzuesit për procedurat e konkursit me barazi gjinore;
- Përgatitja e planit të përmirësimit për shërbimet me akses të kufizuar;
- Publikimi online i “Hartës së Aksesit” dhe përditësimi vjetor i saj;
- Publikimi në faqen zyrtare dhe diskutimi në Forumin e Integritetit;
- Regjistrimi i strukturës drejtuese sipas gjinisë dhe përkatësive sociale.

Objekti IV - Mekanizma të Pjesëmarrjes Qytetare

Nëpërmjet këtij objekti synohet të rritet pjesëmarrja qytetare në vendimmarrjen e bashkisë, lidhur me pjesëmarrjen në hartimin e buxhetit, në Ditët e Hapura kundër Korrupsionit, duke

krijuar Klubet e Integritetit Rinor, nëpërmjet platformave “Qytetari Propozon”, monitorimit të iniciativave të grave këshilltare, etj.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objektivi, për vitin 2025 janë planifikuar për t’u realizuar gjithsej 13 masa/aktivitete, nga të cilat:


- Janë realizuar 12 masa/aktivitete ose 92%
- Nuk është realizuar 1 masë/aktivitet ose 8%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 5. Objektivi IV - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objektivi IV	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Mekanizma të Pjesëmarrjes Qytetare	13	12	0	1

Figura 6. Objektivi IV - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektivi është realizuar në masën 92%, me zbatimin e masave/aktiviteteve si më poshtë:

- Diskutim vjetor në kuadër të Ditëve të Hapura kundër Korrupsionit;
- Raportim gjashtëmujor nga Sekretariati i Këshillit Bashkiak;
- Hartimi i një metodologjie për matjen e treguesit;
- Vendosja e një targeti minimal prej 40% pjesëmarrje të grave/vajzave në konsultime deri në fund të vitit 2028;
- Publikimi i të dhënave të disagreguara gjinore dhe sociale pas çdo konsultimi, në faqen zyrtare të bashkisë dhe në raportet e monitorimit të Planit të Integritetit;
- Përfshirja e rubrikës “Përqindja e pjesëmarrësve që janë gra/vajza dhe përfaqësues/e të grupeve vulnerabël” në formularët e pjesëmarrjes;

- Workshop-e, programe mentorimi, projekte antikorruption;
- Monitorim dhe publikim i përqindjes së investimeve që adresojnë nevoja të grave, vajzave dhe grupeve të marginalizuara;
- Mbështetje logjistike dhe transport për pjesëmarrësit nga grupet vulnerabël;
- Sesione informimi të dedikuara në lagjet rome dhe egjiptiane (Rapishtë, Mëhalla e Madhe);
- Votim online dhe fizik për projektet komunitare;
- Publikim ftesash dhe informim paraprak mbi procesin.

Konkluzione

Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi për periudhën raportuese janar-dhjetor 2025, bazuar në gjetjet që ky dokument ofron, të dhënat analitike të raportuara nga drejtoritë përkatëse dhe analizën e kryer, rezulton se:

Bashkia Elbasan ka vijuar me zbatimin e Planit të Integritetit, duke arritur një nivel të mirë të zbatimit të planit të veprimit, me një nivel realizimi prej 82% të masave të planifikuara për vitin 2025 (në intervalin 80-100%). Gjatë kësaj periudhe janë arritur rezultate si:

- Ngritja e kulturës së integritetit dhe llogaridhënies në bashki;
- Trajnime dhe aktivitete që mbështesin etikën institucionale;
- Trajnimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore;
- Pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje, etj.

Masat dhe aktivitetet e realizuara në kuadër të zbatimit të Planit të Integritetit kanë ndikuar në rritjen e shkallës së kulturës së integritetit institucional. Si rezultat, janë hartuar disa dokumente strategjike mbi etikën në aspekte të punës dhe të shërbimeve të ofruara, si dhe instrumente për raportimin e korrupsionit apo shkeljeve të tjera, të cilat janë bërë të aksesueshme online në adresën zyrtare të bashkisë.

Rekomandime

- Të vijojë puna për zbatimin e Planit të Veprimit të Planit të Integritetit;
- Forcimi i koordinimit dhe bashkëpunimit ndërmjet drejtorive, për një raportim më të rregullt mbi masat e Planit të Integritetit;
- Sigurimi i një raportimi periodik transparent, përmes publikimit të raporteve 6-mujore mbi zbatimin e Planit të Integritetit;
- Trajnimi në vijimësi i Koordinatorit të Integritetit të bashkisë.



RAPORT MONITORIMI

mbi Realizimin e Planeve të Integritetit
të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore

BASHKIA FINIQ

për periudhën
Janar – Dhjetor 2025

Monitorimi i zbatueshmërisë të Planit të Integritetit për vitin 2025

Raporti i Monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit të **Bashkisë Finiq** për vitin 2025 përbën dokumentin e parë të monitorimit të planit të veprimit të Planit të Integritetit të bashkisë.

Plani i Integritetit është konceptuar për t’u zbatuar përgjatë një periudhe trevjeçare, konkretisht 2025-2027.

Në Planin e Integritetit të bashkisë janë përcaktuar gjithsej katër objektiva, për të cilat janë parashikuar fushat me risk, si dhe janë planifikuar masat dhe aktivitetet për realizimin e tyre, si vijon:

- **Objektivi I** - Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator dhe strategjik në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit;
- **Objektivi II** - Menaxhimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore në bashki, për identifikimin dhe parandalimin e risqeve të integritetit;
- **Objektivi III** - Rritja e transparencës dhe llogaridhënies së bashkisë;
- **Objektivi IV** - Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të riskut të integritetit, me fokus në fusha të veçanta të përgjegjësisë së bashkisë.

Për bashkinë Finiq, Plani i Integritetit për periudhën janar-dhjetor 2025, referuar Planit të Veprimit, përmban masa dhe aktivitete të planifikuara sipas objektivave të përcaktuara në Planin e Veprimit.

Situata e monitorimit të Planit të Integritetit të Bashkisë Finiq për periudhën janar–dhjetor 2025



Nga procesi i monitorimit rezulton se, në totalin prej 67 masash (aktivitetesh) të parashikuara për zbatim për vitin 2025:

- 23 masa/aktivitete janë realizuar plotësisht, që përfaqëson 34% të totalit
- 0 masa/aktivitete janë në proces realizimi, ose 0%
- 44 masa/aktivitete mbeten të porealizuara, ose 66%

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun vijues.

Tabela 1. Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Bashkia Finiq	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të porealizuara
Numri i masave / aktiviteteve	67	23	0	44

Figura 1. Zbatimi i Planit të Integritetit, 2025 (%)**Figura 2. Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025**

Bashkia Finiq, gjatë vitit 2025, ka ndërmarrë disa hapa në drejtim të forcimit të qeverisjes së mirë dhe integritetit institucional. Në këtë kuadër, ka hartuar dhe miratuar disa dokumente strategjike që adresojnë forcimin e etikës dhe integritetit, përmirësimin e funksionimit të strukturave vendore antikorruption, konsolidimin e kuadrit të brendshëm institucional, zhvillimin dhe fuqizimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore, si dhe përmirësimin e transparencës dhe besueshmërisë publike.

Gjetjet e Raportit

Objektivi I - Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator dhe strategjik në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit

Ky objektivi synon forcimin e kuadrit të brendshëm rregullator për etikën dhe integritetin, në përputhje me kornizën ligjore për vetëqeverisjen vendore, të drejtën e informimit, konsultimin publik, menaxhimin dhe kontrollin financiar, sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesit, parandalimin e konfliktit të interesit, etj.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objekti, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 20 masa/aktivitete, nga të cilat:


- Janë realizuar 9 masa/aktivitete ose 45%
- Janë në proces realizimi 0 masa/aktivitete ose 0%
- Nuk janë realizuar 11 masa/aktivitete ose 55%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 2. Objekti I - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objekti I	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Forcimi i Kuadrit Rregullator	20	9	0	11

Figura 3. Objekti I - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektiv është realizuar në masën 45%, me zbatimin e masave/aktiviteteve si më poshtë:

- Përditësimi (dhe miratimi) i rregullores së bashkisë me strukturën aktuale;
- Përcaktimi i plotë dhe i qartë në rregullore i detyrave dhe linjave të komunikimit dhe hierarkisë ndërmjet strukturave të bashkisë;
- Hartimi dhe miratimi i Kodit të Sjelljes për administratën e bashkisë, duke përfshirë rregulla në lidhje me parandalimin dhe deklarimin e konfliktit të interesit, veprimtaritë e jashtme, pranimin dhe deklarimin e dhuratave, si dhe deklarimin e pasurisë;
- Krijimi i një regjistri për evidentimin e donacioneve në formë monetare, aktive dhe shërbime të kushtëzuara ose jo (duke përfshirë subjektin, donacionin dhe kushtet, nëse ka);
- Përfshirja në rregulloren e Koordinatorit të Integritetit e rregullave mbi parandalimin e konfliktit të interesit në fushën e shërbimeve publike;

- Përfshirja në strukturën organizative të bashkisë e Sektorit të Prokurimeve Publike;
- Rregullimi dhe plotësimi i bazës ligjore rregullatore të sektorit sipas procedurave standarde për prokurimet;
- Krijimi i regjistrit për deklarimin e dhuratave në bashki;
- Informimi i personelit në lidhje me krijimin e regjistrit dhe detyrimet që lidhen me deklarimin e dhuratave.

Objektivi II - Menaxhimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore në bashki, për identifikimin dhe parandalimin e risqeve të integritetit

Ky objektivi synon të forcojë mekanizmat që lidhen me garantimin e integritetit duke përmirësuar menaxhimin dhe kapacitetet e burimeve njerëzore të bashkisë. Nëpërmjet përmirësimit të proceseve të menaxhimit të burimeve njerëzore në institucion, do të sigurohen kapacitetet dhe aftësitë e nevojshme për zbatimin dhe konsolidimin e mekanizmave garantues të integritetit në institucion, me qëllim rritjen e profesionalizimit të personelit dhe zhvillimin në karrierë të zyrtarëve, në përputhje me performancën e tyre në punë.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objektivi, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 23 masa/aktivitete, nga të cilat:


- Janë realizuar 8 masa/aktivitete ose 35%
- Janë në proces realizimi 0 masa/aktivitete ose 0%
- Nuk janë realizuar 15 masa/aktivitete ose 65%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 3. Objektivi II - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objektivi II	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të përealizuara
Fuqizimi i Burimeve Njerëzore	23	8	0	15

Figura 4. Objektivi II - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektiv është realizuar në masën 35%, me zbatimin e masave/aktiviteteve si më poshtë:

- Komunikimi nëpërmjet kërkesës zyrtare me Departamentin e Administratës Publike për marrjen e aksesit në sistemin HRMIS;
- Trajnimi i vazhdueshëm i punonjësve mbi ndryshimet ligjore në fushën e prokurimit publik, në bashkëpunim me AMVV-në dhe ASPA-n;
- Alokimi i një zëri të posaçëm buxhetor për mbulimin e kostove të trajnimeve dhe certifikimeve profesionale për punonjësit e bashkisë;
- Rishikimi i strukturës organizative;
- Vlerësimi i nevojave për burime njerëzore në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, me dorëzimin e rezultateve të vlerësimit të Kryetari i Bashkisë;
- Shpallja e vakancave ekzistuese për përmbushjen e organikës në Drejtorinë e Planifikimit dhe Administrimit të Territorit;
- Marrja e masave për koordinimin e kërkesave buxhetore me të gjithë sektorët e bashkisë;
- Miratimi i kërkesave në nivel drejtorie/sektori dhe diskutimi i tyre me Ekipet e Menaxhimit të Buxhetit.

Objektivi III - Rritja e transparencës dhe llogaridhënies së bashkisë

Transparenca e bashkisë gjatë procesit të zbatimit të politikave vendore është shumë e rëndësishme për rritjen e pjesëmarrjes së aktorëve të ndryshëm në veprimtarinë e bashkisë dhe të publikut në tërësi. Në këtë kuadër, është me rëndësi edhe siguri i pjesëmarrjes së publikut në procesin e identifikimit të prioritetëve strategjike afatgjatë. Për këtë arsye, bashkia angazhohet të forcojë mekanizmat e pjesëmarrjes për shoqërinë civile dhe grupe të veçanta të interesit, gjatë hartimit dhe konsultimit të dokumenteve të politikave të ndryshme vendore.


Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objektivi, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 16 masa/aktivitete, nga të cilat:

- Janë realizuar 6 masa/aktivitete ose 37%
- Janë në proces realizimi 0 masa/aktivitete ose 0%
- Nuk janë realizuar 10 masa/aktivitete ose 63%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 4. Objektivi III - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objektivi III	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Forcimi i transparencës dhe llogaridhënies	16	6	0	10

Figura 5. Objektivi III - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit

Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektiv është realizuar në masën 37%, me zbatimin e masave/aktiviteteve si më poshtë:

- Hartimi i Raportit Vjetor të Transparencës;
- Publikimi i Raportit Vjetor të Transparencës;
- Në bazë të “Listës tip të dokumenteve me afatet e ruajtjes” dhe të “Listës së dokumenteve me rëndësi historike kombëtare”, të shpallura nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, të hartohet dhe publikohet lista konkrete e dokumenteve me rëndësi historike kombëtare dhe e dokumenteve me afat ruajtjeje të përkohshme, si dhe të përcaktohen afatet e ruajtjes sipas modelit nr. 11 të DPA-së;
- Publikimi i informacionit publik me fokus nevojat e komunitetit (p.sh. rastet kur lejet nuk janë të nevojshme, procedurat e përshpejtuara etj.);
- Hartimi dhe publikimi i një udhëzuesi/rregulloreje që do të zbërthente kuadrin rregullator në kontekstin e bashkisë;
- Hartimi periodik i raporteve gjashtëmujore mbi të gjitha donacionet e përfituara nga bashkia (jo vetëm bashkëfinancimet me fonde IPA), sipas kërkesave të Rregullores së Këshillit Bashkiak.

Objektivi IV - Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të riskut të integritetit, me fokus në fusha të veçanta të përgjegjësisë së bashkisë

Nëpërmjet këtij objektivi synohet menaxhimi i riskut të integritetit në fushat kryesore të përgjegjësisë së bashkisë, duke u fokusuar në proceset e punës të vlerësuara si më të ekspozuarat ndaj rrezikut të korrupsionit. Në tërësinë e tij, menaxhimi i integritetit i Bashkisë Finiq paraqet sfida, të cilat janë parashikuar edhe në Strategjinë për Qeverisjen Vendore dhe që hasen më së shumti në fusha të veçanta të përgjegjësisë, të tilla si fusha e menaxhimit financiar, menaxhimi i pronave të bashkisë, shërbimet publike dhe arkivimi.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objektivi, për vitin 2025 janë planifikuar për t’u realizuar gjithsej 8 masa/aktivitete, nga të cilat:


- Nuk janë realizuar 8 masa/aktivitete, ose 100%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 5. Objektivi IV - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objektivi IV	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Fusha të Veçanta	8	0	0	8

Figura 6. Objektivi IV - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektivi nuk është realizuar.

Konkluzione

Bashkia Finiq ka vijuar me zbatimin e Planit të Integritetit, duke arritur një nivel fillestar të planit të veprimit, me një nivel realizimi prej 34% të masave të planifikuara për vitin 2025, pa arritur nivelin bazë (40-60%). Gjatë kësaj periudhe janë realizuar disa masa fillestare në drejtim të:

- Kulturës së integritetit;
- Transparencës dhe llogaridhënies në bashki;
- Trajnimeve dhe aktiviteteve që mbështesin etikën institucionale;

Masat dhe aktivitetet e realizuara në kuadër të zbatimit të Planit të Integritetit, pavarësisht nivelit prej 34%, kanë dhënë një ndikim në rritjen e shkallës së kulturës së integritetit institucional. Si rezultat, janë hartuar disa dokumente strategjike mbi etikën në aspekte të punës dhe të shërbimeve të ofruara, si dhe instrumente për raportimin e korrupsionit.

Rekomandime

- Bashkia Finiq të rishikojë edhe një herë vlerësimin e riskut të integritetit, me qëllim hartimin e masave/aktiviteteve në përputhje me nevojat dhe mundësitë aktuale të saj;
- Forcimi i koordinimit dhe bashkëpunimit ndërmjet drejtorive, për një raportim më të rregullt mbi masat e Planit të Integritetit;
- Sigurimi i një raportimi periodik transparent, përmes publikimit të raporteve 6-mujore mbi zbatimin e Planit të Integritetit;
- Trajnimi në vijimësi i Koordinatorit të Integritetit të bashkisë.



RAPORT MONITORIMI

mbi Realizimin e Planeve të Integritetit
të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore

BASHKIA FUSHË-ARRËZ

për periudhën
Janar – Dhjetor 2025

Monitorimi i zbatueshmërisë të Planit të Integritetit për vitin 2025

Raporti i Monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit të **Bashkisë Fushë-Arrëz** për vitin 2025 përbën dokumentin e parë të monitorimit të planit të veprimit të Planit të Integritetit të bashkisë.

Plani i Integritetit është konceptuar për t'u zbatuar përgjatë një periudhe katërvjeçare, konkretisht 2025-2028.

Në Planin e Integritetit të bashkisë janë përcaktuar gjithsej katër objektiva, për të cilat janë parashikuar fushat me risk, si dhe janë planifikuar masat dhe aktivitetet për realizimin e tyre, si vijon:

- **Objektivi I** - Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator dhe institucional;
- **Objektivi II** - Rritja e transparencës dhe llogaridhënies publike;
- **Objektivi III** - Menaxhimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore në bashki, për identifikimin dhe parandalimin e risqeve të integritetit;
- **Objektivi IV** - Menaxhimi i riskut të integritetit në fusha të veçanta të përgjegjësisë së bashkisë;

Për bashkinë Fushë-Arrëz, Plani i Integritetit për periudhën janar-dhjetor 2025, referuar Planit të Veprimit, përmban masa dhe aktivitete të planifikuara sipas objektivave të përcaktuara në Planin e Veprimit.

Situata e monitorimit të Planit të Integritetit të Bashkisë Fushë-Arrëz për periudhën janar–dhjetor 2025



Nga procesi i monitorimit rezulton se, në totalin prej 16 masash (aktivitetesh) të parashikuara për zbatim për vitin 2025:

- 8 masa/aktivitete janë realizuar plotësisht, që përfaqëson 50% të totalit
- 0 masa/aktivitete janë në proces realizimi, ose 0%
- 8 masa/aktivitete mbeten të parealizuara, ose 50%

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun vijues.

Tabela 1. Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Bashkia Fushë-Arrëz	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Numri i masave / aktiviteteve	16	8	0	8

Figura 1. Zbatimi i Planit të Integritetit, 2025 (%)**Figura 2. Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025**

Bashkia Fushë-Arrëz, gjatë vitit 2025, ka ndërmarrë një sërë hapash në drejtim të forcimit të qeverisjes së mirë dhe integritetit institucional. Në këtë kuadër, ka hartuar dhe miratuar disa dokumente strategjike që adresojnë forcimin e etikës dhe integritetit, përmirësimin e funksionimit të strukturave vendore antikorruption, konsolidimin e kuadrit të brendshëm institucional, zhvillimin dhe fuqizimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore, si dhe rritjen e rezistencës institucionale ndaj risqeve të integritetit.

Gjetjet e Raportit

Objektivi I - Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator dhe institucional

Ky objektiv synon forcimin e kuadrit të brendshëm rregullator për etikën dhe integritetin, në përputhje me kornizën ligjore për vetëqeverisjen vendore, të drejtën e informimit, konsultimin publik, menaxhimin dhe kontrollin financiar, sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesit, parandalimin e konfliktit të interesit, etj.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objektivi, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 4 masa/aktivitete, nga të cilat:


- Janë realizuar 4 masa/aktivitete ose 100%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 2. Objektivi I - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objektivi I	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Forcimi i Kuadrit Rregullator	4	4	0	0

Figura 3. Objektivi I - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektiv është realizuar në masën 100%, me zbatimin e masave/aktiviteteve si më poshtë:

- Miratimi i urdhrat për caktimin e autoritetit përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesave në bashki;
- Informimi i stafit të bashkisë në lidhje me autoritetin përgjegjës dhe detyrat e tij;
- Hartimi dhe miratimi i rregullores së brendshme të bashkisë për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike;

- Informimi i stafit të bashkisë për detyrimet ligjore të rregullores, në lidhje me deklarimin e konfliktit të interesit.

Objektivi II - Rritja e transparencës dhe llogaridhënies publike

Ky objektivi synon forcimin e llogaridhënies publike dhe transparencës në bashki, duke përmirësuar transparencën proaktive të institucionit, nëpërmjet plotësimit dhe përditësimit të rregullt të Programit të Transparencës. Përmirësimi i këtyre proceseve do të ndikojë në rritjen e besimit të publikut dhe përfshirjen e tij në veprimtarinë e bashkisë, duke shfrytëzuar aksesin e shtuar në informacion.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objekti, për vitin 2025 është planifikuar për t'u realizuar gjithsej 1 masë/aktivitet, e cila:


- Nuk është realizuar, ose 0%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 3. Objektivi II - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objektivi II	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Forcimi i transparencës dhe llogaridhënies	1	0	0	1

Figura 4. Objektivi II - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektivi nuk është realizuar.

Objektivi III - Menaxhimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore në bashki, për identifikimin dhe parandalimin e risqeve të integritetit

Ky objektivi synon të forcojë mekanizmat që lidhen me garantimin e integritetit duke përmirësuar menaxhimin dhe kapacitetet e burimeve njerëzore të bashkisë. Nëpërmjet përmirësimit të proceseve të menaxhimit të burimeve njerëzore në institucion, do të sigurohen

kapacitetet dhe aftësitë e nevojshme për zbatimin dhe konsolidimin e mekanizmave garantues të integritetit në institucion, me qëllim rritjen e profesionalizimit të personelit dhe zhvillimin në karrierë të zyrtarëve, në përputhje me performancën e tyre në punë.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objekti, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 5 masa/aktivitete, nga të cilat:


- Janë realizuar 3 masa/aktivitete ose 60%
- Nuk janë realizuar 2 masa/aktivitete ose 40%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 4. Objekti III - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objekti III	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të përealizuara
Fuqizimi i Burimeve Njerëzore	5	3	0	2

Figura 5. Objekti III - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektiv është realizuar në masën 60%, me zbatimin e masave/aktiviteteve si më poshtë:

- Alokimi i një zëri të posaçëm buxhetor për mbulimin e kostove të trajnimeve dhe certifikimeve profesionale për punonjësit e bashkisë;
- Trajnimi i vazhdueshëm i stafit për përdorimin efektiv të sistemit elektronik për pasqyrimin e të dhënave të PBA-së dhe buxhetit, si dhe përfshirja e tij në planin vjetor të trajnimeve për stafin e bashkisë;
- Sigurimi i rotacionit të vazhdueshëm të anëtarëve të KVO-së, për të shmangur mbingarkesën në punë dhe ekspozimin e lartë ndaj situatave të konfliktit të interesit.

Objektivi IV - Menaxhimi i riskut të integritetit në fusha të veçanta të përgjegjësisë së bashkisë

Nëpërmjet këtij objektiivi synohet menaxhimi i riskut të integritetit në fushat kryesore të përgjegjësisë së bashkisë, duke u fokusuar në proceset e punës të vlerësuara si më të ekspozuarat ndaj rrezikut të korrupsionit. Në tërësinë e tij, menaxhimi i integritetit i Bashkisë Fushë-Arrëz paraqet sfida, të cilat janë parashikuar edhe në Strategjinë për Qeverisjen Vendore dhe që hasen më së shumti në fusha të veçanta të përgjegjësisë, të tilla si fusha e menaxhimit financiar, menaxhimi i pronave të bashkisë, shërbimet publike dhe arkivimi.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objektiivi, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 6 masa/aktivitete, nga të cilat:


- Është realizuar 1 masë/aktivitet ose 17%
- Nuk janë realizuar 5 masa/aktivitete ose 83%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 5. Objektivi IV - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objektivi IV	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Fusha të Veçanta	6	1	0	5

Figura 6. Objektivi IV - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektivi është realizuar në masën 17%, me zbatimin e masave/aktiviteteve si më poshtë:

- Marrja e masave për pajisjen e njësisë me burime njerëzore të mjaftueshme dhe të kualifikuara për sektorin e menaxhimit të aseteve.

Konkluzione

Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi për periudhën raportuese janar-dhjetor 2025, bazuar në gjetjet që ky dokument ofron, të dhënat analitike të raportuara nga drejtoritë përkatëse dhe analizën e kryer, rezulton se:

Bashkia Fushë-Arrëz ka vijuar me zbatimin e Planit të Integritetit, duke arritur një nivel realizimi prej 50% të masave të planifikuara për vitin 2025 (në intervalin 40-60%). Gjatë kësaj periudhe janë arritur rezultate në drejtim të:

- Ngritjes së kulturës së integritetit në bashki;
- Trajnimeve dhe aktiviteteve që mbështesin etikën institucionale;
- Trajnimit dhe zhvillimit të burimeve njerëzore.

Masat dhe aktivitetet e realizuara në kuadër të zbatimit të Planit të Integritetit kanë ndikuar në rritjen e shkallës së kulturës së integritetit institucional. Si rezultat, janë hartuar disa dokumente strategjike mbi etikën në aspekte të punës, si dhe instrumente për trajnimin e burimeve njerëzore dhe plotësimin e strukturës me burime njerëzore sipas strukturës së miratuar.

Rekomandime

- Të vijojë puna për realizimin e masave/aktiviteteve të planifikuara në Planin e Integritetit;
- Forcimi i zbatimit të masave për transparencë dhe përmirësimi i kuadrit rregullator, me synim rritjen e integritetit në menaxhimin financiar;
- Rritja e pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje;
- Forcimi i koordinimit dhe bashkëpunimit ndërmjet drejtorive, për një raportim më të rregullt mbi masat e Planit të Integritetit;
- Sigurimi i një raportimi periodik transparent, përmes publikimit të raporteve 6-mujore mbi zbatimin e Planit të Integritetit;
- Trajnimi në vijimësi i Koordinatorit të Integritetit të bashkisë.



RAPORT MONITORIMI

mbi Realizimin e Planeve të Integritetit
të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore

BASHKIA GRAMSH

për periudhën
Janar – Dhjetor 2025

Monitorimi i zbatueshmërisë të Planit të Integritetit për vitin 2025

Raporti i Monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit të **Bashkisë Gramsh** për vitin 2025 përbën dokumentin e parë të monitorimit të planit të veprimit të Planit të Integritetit të bashkisë.

Plani i Integritetit është konceptuar për t’u zbatuar përgjatë një periudhe trevjeçare, konkretisht 2025-2027.

Në Planin e Integritetit të bashkisë janë përcaktuar gjithsej katër objektiva, për të cilat janë parashikuar fushat me risk, si dhe janë planifikuar masat dhe aktivitetet për realizimin e tyre, si vijon:

- **Objektivi I** - Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator dhe strategjik në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit;
- **Objektivi II** - Forcimi i rezistencës institucionale ndaj shkeljeve të integritetit nëpërmjet menaxhimit dhe zhvillimit të burimeve njerëzore në bashki;
- **Objektivi III** - Përmirësimi i transparencës dhe llogaridhënies së bashkisë;
- **Objektivi IV** - Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të riskut të integritetit, me fokus në fusha të veçanta të përgjegjësisë së bashkisë.

Për bashkinë Gramsh, Plani i Integritetit për periudhën janar-dhjetor 2025, referuar Planit të Veprimit, përmban masa dhe aktivitete të planifikuara sipas objektivave të përcaktuara në Planin e Veprimit.

Situata e monitorimit të Planit të Integritetit të Bashkisë Gramsh për periudhën janar–dhjetor 2025



Nga procesi i monitorimit rezulton se, në totalin prej 52 masash (aktivitetesh) të parashikuara për zbatim për vitin 2025:

- 27 masa/aktivitete janë realizuar plotësisht, që përfaqëson 52% të totalit
- 2 masa/aktivitete janë në proces realizimi, ose 4%
- 23 masa/aktivitete mbeten të porealizuara, ose 44%

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun vijues.

Tabela 1. Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Bashkia Gramsh	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të porealizuara
Numri i masave / aktiviteteve	52	27	2	23

Figura 1. Zbatimi i Planit të Integritetit, 2025 (%)**Figura 2. Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025**

Bashkia Gramsh, gjatë vitit 2025, ka ndërmarrë një sërë hapash fillestare në drejtim të forcimit të qeverisjes së mirë dhe integritetit institucional. Në këtë kuadër, ka hartuar dhe miratuar disa dokumente strategjike që adresojnë forcimin e etikës dhe integritetit, përmirësimin e funksionimit të strukturave vendore antikorrupsion, konsolidimin e kuadrit të brendshëm institucional, zhvillimin dhe fuqizimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore, rritjen e rezistencës institucionale ndaj risqeve të integritetit, si dhe përmirësimin e transparencës dhe besueshmërisë publike.

Gjetjet e Raportit

Objektivi I - Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator dhe strategjik në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit

Ky objektiv synon forcimin e kuadrit të brendshëm rregullator për etikën dhe integritetin, në përputhje me kornizën ligjore për vetëqeverisjen vendore, të drejtën e informimit, konsultimin publik, menaxhimin dhe kontrollin financiar, sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesit, parandalimin e konfliktit të interesit, etj.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objektivi, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 14 masa/aktivitete, nga të cilat:


- Janë realizuar 4 masa/aktivitete ose 28%
- Janë në proces realizimi 0 masa/aktivitete ose 0%
- Nuk janë realizuar 10 masa/aktivitete ose 72%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 2. Objektivi I - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objektivi I	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Forcimi i Kuadrit Rregullator	14	4	0	10

Figura 3. Objektivi I - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektiv është realizuar në masën 28%, me zbatimin e masave/aktiviteteve si më poshtë:

- Publikimi i instrumentit të miratuar dhe treguesve përkatës të performancës në Programin e Transparencës së bashkisë;
- Krijimi i regjistrit për deklarimin e dhuratave në bashki;
- Informimi i personelit në lidhje me krijimin e regjistrit dhe detyrimet që lidhen me deklarimin e dhuratave;
- Rekrutimi i specialistit IT.

Objektivi II - Forcimi i rezistencës institucionale ndaj shkeljeve të integritetit nëpërmjet menaxhimit dhe zhvillimit të burimeve njerëzore në bashki

Ky objektivi synon të forcojë mekanizmat që lidhen me garantimin e integritetit duke përmirësuar menaxhimin dhe kapacitetet e burimeve njerëzore të bashkisë. Nëpërmjet përmirësimit të proceseve të menaxhimit të burimeve njerëzore në institucion, do të sigurohen kapacitetet dhe aftësitë e nevojshme për zbatimin dhe konsolidimin e mekanizmave garantues të integritetit në institucion, me qëllim rritjen e profesionalizimit të personelit dhe zhvillimin në karrierë të zyrtarëve, në përputhje me performancën e tyre në punë.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objekti, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 18 masa/aktivitete, nga të cilat:


- Janë realizuar 13 masa/aktivitete ose 72%
- Janë në proces realizimi 0 masa/aktivitete ose 0%
- Nuk janë realizuar 5 masa/aktivitete ose 28%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 3. Objektivi II - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objektivi II	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Fuqizimi i Burimeve Njerëzore	18	13	0	5

Figura 4. Objektivi II - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektivi është realizuar në masën 72%, me zbatimin e masave/aktiviteteve si më poshtë:

- Organizimi i trajnimeve në lidhje me çështjet e etikës dhe parandalimit të konfliktit të interesit, të përfshira në planin vjetor të bashkisë për trajnimet;

- Organizimi i takimeve informuese me personelin e bashkisë, për të rritur ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e procedurës së vlerësimit të rezultateve në punë;
- Informimi i të gjithë punonjësve mbi rregulloren e sinjalizuesit dhe vënia në dispozicion e saj;
- Rikujtesë periodike e punonjësve mbi funksionin dhe kontaktin e sinjalizuesit;
- Plotësimi i Sektorit të Auditimit të Brendshëm me burimet njerëzore, sipas kriterëve të përcaktuara, bazës ligjore përkatëse dhe në përputhje me strukturën e miratuar të bashkisë;
- Vlerësimi i nevojës për rekrutimin e burimeve njerëzore;
- Ngritja dhe funksionimi i Komitetit të Përhershëm të Pranimit;
- Ofrimi i trajnimeve të personelit në këtë fushë;
- Plotësimi i kapaciteteve teknike dhe në burime njerëzore.

Objektivi III - Përmirësimi i transparencës dhe llogaridhënies së bashkisë

Transparenca e bashkisë gjatë procesit të zbatimit të politikave vendore është shumë e rëndësishme për rritjen e pjesëmarrjes së aktorëve të ndryshëm në veprimtarinë e bashkisë dhe të publikut në tërësi. Në këtë kuadër, është me rëndësi edhe siguri i pjesëmarrjes së publikut në procesin e identifikimit të prioriteteve strategjike afatgjata. Për këtë arsye, bashkia angazhohet të forcojë mekanizmat e pjesëmarrjes për shoqërinë civile dhe grupe të veçanta të interesit, gjatë hartimit dhe konsultimit të dokumenteve të politikave të ndryshme vendore.


Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objektivi, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 13 masa/aktivitete, nga të cilat:

- Janë realizuar 5 masa/aktivitete ose 38%
- Janë në proces realizimi 2 masa/aktivitete ose 16%
- Nuk janë realizuar 6 masa/aktivitete ose 46%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 4. Objektivi III - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objektivi III	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Forcimi i transparencës dhe llogaridhënies	13	5	2	6

Figura 5. Objektivi III - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit

Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektivi është realizuar në masën 38%, me zbatimin e masave/aktiviteteve si më poshtë:

- Plotësimi i sektorit me specialistin e IT (masë e njëjtë me rekrutimin e specialistit IT);
- Trajnimi i specialistit të IT;
- Në bazë të Listës tip të dokumenteve me afatet e ruajtjes dhe të listës së dokumenteve me rëndësi historike kombëtare, të shpallura nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, të hartohet dhe publikohet lista konkrete e dokumenteve me rëndësi historike kombëtare dhe e dokumenteve me afat ruajtjeje të përkohshme, si dhe të përcaktohen afatet e ruajtjes sipas modelit nr. 11 të DPA-së;
- Publikimi i informacionit publik me fokus nevojat e komunitetit (p.sh. rastet kur lejet nuk janë të nevojshme, procedurat e përshpejtuara etj.);
- Hartimi dhe publikimi i një udhëzuesi/rregulloreje që do të zbërthente kuadrin rregullator në kontekstin e bashkisë.

Objektivi IV - Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të riskut të integritetit, me fokus në fusha të veçanta të përgjegjësisë së bashkisë

Nëpërmjet këtij objektivi synohet menaxhimi i riskut të integritetit në fushat kryesore të përgjegjësisë së bashkisë, duke u fokusuar në proceset e punës të vlerësuara si më të ekspozuarat ndaj rrezikut të korrupsionit. Në tërësinë e tij, menaxhimi i integritetit i Bashkisë Gramsh paraqet sfida, të cilat janë parashikuar edhe në Strategjinë për Qeverisjen Vendore dhe që hasen më së shumti në fusha të veçanta të përgjegjësisë, të tilla si fusha e menaxhimit financiar, menaxhimi i pronave të bashkisë, shërbimet publike dhe arkivimi.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objektivi, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 7 masa/aktivitete, nga të cilat:


- Janë realizuar 5 masa/aktivitete ose 71%
- Nuk janë realizuar 2 masa/aktivitete ose 29%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 5. Objektivi IV - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objektivi IV	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Fusha të Veçanta	7	5	0	2

Figura 6. Objektivi IV - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektivi është realizuar në masën 71%, me zbatimin e masave/aktiviteteve si më poshtë:

- Trajnimi i stafit mbi udhëzuesin e Bashkimit Europian;
- Vlerësimi i mundësisë së rishikimit dhe ripunimit të Planit të Përgjithshëm Vendor, në mënyrë që të reflektojë nevojat dhe vizionin aktual të bashkisë;
- Trajnimi i vazhdueshëm i punonjësve mbi ndryshimet ligjore në fushën e prokurimit publik, në bashkëpunim me ASPA-n;
- Sigurimi i konsultimit publik të PPV-së së rishikuar me qytetarët e bashkisë;
- Hartimi i një PSV-je për trajtimin e ankesave dhe kërkesave të qytetarëve në lidhje me administrimin e pronave, dhe publikimi i saj në Programin e Transparencës.

Konkluzione

Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi për periudhën raportuese janar-dhjetor 2025, bazuar në gjetjet që ky dokument ofron, të dhënat analitike të raportuara nga drejtoritë përkatëse dhe analizën e kryer, rezulton se:

Bashkia Gramsh ka vijuar me zbatimin e Planit të Integritetit, duke realizuar një nivel të kënaqshëm zbatimi prej 52% të masave të planifikuara për vitin 2025 (në intervalin 40-60%). Gjatë kësaj periudhe janë arritur disa rezultate si:

- Ngritja e kulturës së integritetit dhe llogaridhënies në bashki;
- Trajnime dhe aktivitete që mbështesin etikën institucionale;
- Trajnimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore;
- Njohja e punonjësve me bazën ligjore antikorrupsion.

Masat dhe aktivitetet e realizuara në kuadër të zbatimit të Planit të Integritetit kanë ndikuar në rritjen e shkallës së kulturës së integritetit institucional. Si rezultat, janë organizuar trajnime mbi etikën dhe integritetin, në aspekte të punës dhe të shërbimeve të ofruara, si dhe instrumente për raportimin e korrupsionit apo shkeljeve të tjera, të cilat janë bërë të aksesueshme online në adresën zyrtare të bashkisë.

Rekomandime

- Vijimi i zbatimit të masave për transparencë dhe përmirësimi i kuadrit rregullator, me synim rritjen e integritetit;
- Rritja e pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje;
- Forcimi i koordinimit dhe bashkëpunimit ndërmjet drejtorive, për një raportim më të rregullt mbi masat e Planit të Integritetit;
- Sigurimi i një raportimi periodik transparent, përmes publikimit të raporteve 6-mujore mbi zbatimin e Planit të Integritetit;
- Trajnimi në vijimësi i Koordinatorit të Integritetit të bashkisë.



RAPORT MONITORIMI

mbi Realizimin e Planeve të Integritetit
të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore

BASHKIA HAS

për periudhën
Janar – Dhjetor 2025

Monitorimi i zbatueshmërisë të Planit të Integritetit për vitin 2025

Raporti i Monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit të Bashkisë Has për vitin 2025 përbën dokumentin e parë të monitorimit të planit të veprimit të Planit të Integritetit të bashkisë.

Plani i Integritetit është konceptuar për t'u zbatuar përgjatë një periudhe katërvjeçare, konkretisht 2025-2028.

Në Planin e Integritetit të bashkisë janë përcaktuar gjithsej katër objektiva, për të cilat janë parashikuar fushat me risk, si dhe janë planifikuar masat dhe aktivitetet për realizimin e tyre, si vijon:

- **Objektivi I** - Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit;
- **Objektivi II** - Menaxhimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore në bashki, për identifikimin dhe parandalimin e risqeve të integritetit;
- **Objektivi III** - Rritja e transparencës në ndarjen e të dhënave me publikun;
- **Objektivi IV** - Menaxhimi i riskut të integritetit në fusha të veçanta të përgjegjësisë së bashkisë.

Për bashkinë Has, Plani i Integritetit për periudhën janar-dhjetor 2025, referuar Planit të Veprimit, përmban masa dhe aktivitete të planifikuara vetëm në kuadër të Objektivit I, III dhe IV, sipas përcaktimeve në Planin e Veprimit.

Situata e monitorimit të Planit të Integritetit të Bashkisë Has për periudhën janar–dhjetor 2025



Nga procesi i monitorimit rezulton se, në totalin prej 6 masash (aktivitetesh) të parashikuara për zbatim për vitin 2025:

- 3 masa/aktivitete janë realizuar plotësisht, që përfaqëson 50% të totalit
- 0 masa/aktivitete janë në proces realizimi, ose 0%
- 3 masa/aktivitete mbeten të parealizuara, ose 50%

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun vijues.

Tabela 1. Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Bashkia Has	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Numri i masave / aktiviteteve	6	3	0	3

Figura 1. Zbatimi i Planit të Integritetit, 2025 (%)**Figura 2. Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025**

Bashkia Has, gjatë vitit 2025, ka ndërmarrë hapa në drejtim të forcimit të qeverisjes së mirë dhe integritetit institucional. Në këtë kuadër, ka hartuar dhe miratuar disa dokumente strategjike që adresojnë përmirësimin e legjislacionit për konsolidimin e kuadrit të brendshëm institucional, si dhe zhvillimin dhe rritjen e rezistencës institucionale ndaj risqeve të integritetit.

Gjetjet e Raportit

Objektivi I - Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit

Ky objektivi synon forcimin e kuadrit të brendshëm rregullator për etikën dhe integritetin, në përputhje me kornizën ligjore për vetëqeverisjen vendore, të drejtën e informimit, konsultimin publik, menaxhimin dhe kontrollin financiar, sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesit, parandalimin e konfliktit të interesit, etj.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objektivi, për vitin 2025 është planifikuar për t'u realizuar gjithsej 1 masë/aktivitet, e cila:


- Është realizuar, ose 100%

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 2. Objektivi I - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objektivi I	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Forcimi i Kuadrit Rregullator	1	1	0	0

Figura 3. Objektivi I - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektivi është realizuar në masën 100%, me zbatimin e masës/aktivitetit si më poshtë:

- Hartimi dhe miratimi i Planit Strategjik të Zhvillimit të Bashkisë Has, i cili përfshin: a) politikat për zhvillimin e qëndrueshëm në një afat kohor jo më pak se 5 vite; b) nevojat dhe potencialet e zhvillimit vendor, si dhe prioritetet rajonale e kombëtare të zhvillimit strategjik, duke parashikuar edhe kostot përkatëse; c) zbatimin nëpërmjet programit buxhetor afatmesëm të njësisë.

Objektivi III - Rritja e transparencës në ndarjen e të dhënave me publikun

Transparenca e bashkisë gjatë procesit të zbatimit të politikave vendore është shumë e rëndësishme për rritjen e pjesëmarrjes së aktorëve të ndryshëm në veprimtarinë e bashkisë dhe të publikut në tërësi. Në këtë kuadër, është me rëndësi edhe siguri i pjesëmarrjes së publikut në procesin e identifikimit të prioriteteve strategjike afatgjata. Për këtë arsye, bashkia angazhohet të forcojë mekanizmat e pjesëmarrjes për shoqërinë civile dhe grupe të veçanta të interesit, gjatë hartimit dhe konsultimit të dokumenteve të politikave të ndryshme vendore.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objektivi, për vitin 2025 është planifikuar për t'u realizuar gjithsej 1 masë/aktivitet, e cila:


- Nuk është realizuar, ose 0%

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 3. Objektivi III - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objektivi III	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Forcimi i transparencës dhe llogaridhënies	1	0	0	1

Figura 4. Objektivi III - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektivi nuk është realizuar.

Objektivi IV - Menaxhimi i riskut të integritetit në fusha të veçanta të përgjegjësisë së bashkisë

Nëpërmjet këtij objektivi synohet menaxhimi i riskut të integritetit në fushat kryesore të përgjegjësisë së bashkisë, duke u fokusuar në proceset e punës të vlerësuara si më të ekspozuarat ndaj rrezikut të korrupsionit. Në tërësinë e tij, menaxhimi i integritetit i Bashkisë Has paraqet sfida, të cilat janë parashikuar edhe në Strategjinë për Qeverisjen Vendore dhe që hasen më së shumti në fusha të veçanta të përgjegjësisë, të tilla si fusha e menaxhimit financiar, menaxhimi i pronave të bashkisë, shërbimet publike dhe arkivimi.


Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objektivi, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 4 masa/aktivitete, nga të cilat:

- Janë realizuar 2 masa/aktivitete ose 50%
- Nuk janë realizuar 2 masa/aktivitete ose 50%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 4. Objektivi IV - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objektivi IV	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Fusha të Veçanta	4	2	0	2

Figura 5. Objektivi IV - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit

Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektivi është realizuar në masën 50%, me zbatimin e masave/aktiviteteve si më poshtë:

- Ngritja e Njesisë së Auditit të Brendshëm, në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi;
- Ngritja e grupit për hartimin e Planit të Detajuar Vendor (PDV) me nismë publike, me qëllim detajimin e përcaktimeve të PPV-së, për: a) zhvillimin dhe/ose rihvillimin e njësisë; b) rigjenerimin/ripërtëritjen urbane; c) përdorimet e tokës dhe kushtet e zhvillimit; ç) investimet publike në infrastrukturë apo shërbimet publike që ndikojnë në ndryshimin ose rishpërndarjen e kushteve të zhvillimit; d) programet e drejtimit të zhvillimit nëpërmjet instrumenteve përkatëse.

Konkluzione

Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi për periudhën raportuese janar-dhjetor 2025, bazuar në gjetjet që ky dokument ofron, të dhënat analitike të raportuara nga drejtoritë përkatëse dhe analizën e kryer, rezulton se:

Bashkia Has ka vijuar me zbatimin e Planit të Integritetit, duke arritur një nivel realizimi prej 50% të masave të planifikuara për vitin 2025 (në intervalin 40-60%). Gjatë kësaj periudhe janë realizuar dhe arritur rezultate në drejtim të:

- Hartimit dhe miratimit të disa dokumenteve të rëndësishme strategjike të bashkisë;
- Ngritjes së kulturës së integritetit në bashki;
- Ngritjes së Njesisë së Auditit.

Rekomandime

- Të vijojë puna për realizimin e masave/aktiviteteve të planifikuara në Planin e Integritetit;
- Të rritet niveli i transparencës dhe llogaridhënies në bashki;
- Të rritet niveli i koordinimit dhe bashkëpunimit ndërmjet drejtorive, për një raportim më të rregullt mbi masat e Planit të Integritetit;
- Sigurimi i një raportimi periodik, përmes publikimit të raporteve 6-mujore mbi zbatimin e Planit të Integritetit;
- Trajnimi në vijimësi i Koordinatorit të Integritetit të bashkisë.



RAPORT MONITORIMI

mbi Realizimin e Planeve të Integritetit
të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore

BASHKIA HIMARË

për periudhën
Janar – Dhjetor 2025

Monitorimi i zbatueshmërisë të Planit të Integritetit për vitin 2025

Raporti i Monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit të **Bashkisë Himarë** për vitin 2025 përbën dokumentin e parë të monitorimit të planit të veprimit të Planit të Integritetit të bashkisë.

Plani i Integritetit është konceptuar për t'u zbatuar përgjatë një periudhe katërvjeçare, konkretisht 2025-2028.

Në Planin e Integritetit të bashkisë janë përcaktuar gjithsej katër objektiva, për të cilat janë parashikuar fushat me risk, si dhe janë planifikuar masat dhe aktivitetet për realizimin e tyre, si vijon:

- **Objektivi I** - Menaxhimi i burimeve njerëzore të bashkisë, me qëllim forcimin e rezistencës institucionale ndaj shkeljeve të integritetit;
- **Objektivi II** - Përmirësimi i kuadrit të brendshëm rregullator dhe strategjik për aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit;
- **Objektivi III** - Përmirësimi i transparencës proaktive të bashkisë, për të mundësuar rritjen e llogaridhënies dhe aksesit të qytetarëve në informacion;
- **Objektivi IV** - Menaxhimi i riskut të integritetit, me fokus në fushat e përgjegjësisë së bashkisë.

Për bashkinë Himarë, Plani i Integritetit për periudhën janar-dhjetor 2025, referuar Planit të Veprimit, përmban masa dhe aktivitete të planifikuara vetëm në mbështetje të Objektivit III dhe IV, sipas përcaktimeve në Planin e Veprimit.

Situata e monitorimit të Planit të Integritetit të Bashkisë Himarë për periudhën janar–dhjetor 2025



Nga procesi i monitorimit rezulton se, në totalin prej 11 masash (aktivitetesh) të parashikuara për zbatim për vitin 2025:

- 7 masa/aktivitete janë realizuar plotësisht, që përfaqëson 64% të totalit
- 0 masa/aktivitete janë në proces realizimi, ose 0%
- 4 masa/aktivitete mbeten të porealizuara, ose 36%

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun vijues.

Tabela 1. Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Bashkia Himarë	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të porealizuara
Numri i masave / aktiviteteve	11	7	0	4

Figura 1. Zbatimi i Planit të Integritetit, 2025 (%)**Figura 2. Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025**

Sa më sipër, gjatë vitit 2025, Bashkia Himarë ka ndërmarrë një sërë hapash të rëndësishëm në drejtim të forcimit të qeverisjes së mirë dhe integritetit institucional. Në këtë kuadër, janë hartuar dhe miratuar disa dokumente strategjike që adresojnë konsolidimin e kuadrit të brendshëm institucional, rritjen e rezistencës institucionale ndaj risqeve të integritetit, si dhe përmirësimin e transparencës dhe të besueshmërisë publike.

Gjetjet e Raportit

Objektivi III - Përmirësimi i transparencës proaktive të bashkisë për të mundësuar rritjen e llogaridhënies dhe aksesit të qytetarëve në informacion

Ky objektivi synon forcimin e llogaridhënies publike dhe transparencës në bashki, duke përmirësuar transparencën proaktive të institucionit, nëpërmjet plotësimit dhe përditësimit të rregullt të Programit të Transparencës. Përmirësimi i këtyre proceseve do të ndikojë në rritjen e besimit të publikut dhe përfshirjen e tij në veprimtarinë e bashkisë, duke shfrytëzuar aksesin e shtuar në informacion.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objektivi, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 5 masa/aktivitete, nga të cilat:


- Janë realizuar 3 masa/aktivitete ose 60%
- Nuk janë realizuar 2 masa/aktivitete ose 40%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 2. Objektivi III - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objektivi III	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Përmirësimi i Transparencës	5	3	0	2

Figura 3. Objektivi III - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektivi është realizuar në masën 60%, me zbatimin e masave/aktiviteteve si më poshtë:

- Publikimi i raporteve të brendshme të auditit në Programin e Transparencës së bashkisë;
- Përditësimi i faqes zyrtare të bashkisë me informacionin e plotë të procedurave dhe kritereve për lejet/licencat;

- Publikimi i rregullt, në Programin e Transparencës së bashkisë, i raporteve katërmujore të monitorimit të zbatimit të buxhetit vjetor të miratuar.

Objektivi IV - Menaxhimi i riskut të integritetit, me fokus në fushat e përgjegjësisë së bashkisë

Ky objektivi synon adresimin e risqeve të integritetit në fushat funksionale të përgjegjësisë së bashkisë. Masat e parashikuara synojnë të përmirësojnë efektivitetin, eficiencën dhe cilësinë e proceseve të punës në fushat funksionale të bashkisë, me qëllim përmirësimin e shërbimeve publike, planifikimin e territorit, menaxhimin e pronave dhe aseteve publike, menaxhimin financiar, etj.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objektivi, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 6 masa/aktivitete, nga të cilat:


- Janë realizuar 4 masa/aktivitete ose 66%
- Nuk janë realizuar 2 masa/aktivitete ose 34%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 3. Objektivi IV - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objektivi IV	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Fusha të Veçanta	6	4	0	2

Figura 4. Objektivi IV - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektivi është realizuar në masën 66%, me zbatimin e masave/aktiviteteve si më poshtë:

- Marrja e masave administrative dhe juridike lidhur me detyrimet e prapambetura të aktiviteteve sezonale;

- Realizimi i vlerësimeve objektive në etapat e dhënies së lejeve për bizneset sezonale, ku të parashtrihen qartazi detyrimet kundrejt bashkisë;
- Ngritja e komisioneve për asgjësimin e aseteve që kanë humbur vlerën e tyre, në respektim të dispozitave dhe standardeve të kontabilitetit për nxjerrjen jashtë përdorimit të aseteve;
- Realizimi periodik i inventarizimeve të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe atyre të patrupëzuara.

Konkluzione

Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi për periudhën raportuese janar-dhjetor 2025, bazuar në gjetjet që ky dokument ofron, të dhënat analitike të raportuara nga drejtoritë përkatëse dhe analizën e kryer, rezulton se:

Bashkia Himarë ka vijuar me zbatimin e Planit të ri të Integritetit, duke arritur një nivel të mirë realizimi prej 64% të masave të planifikuara për vitin 2025 (në intervalin 60-80%). Gjatë kësaj periudhe janë arritur rezultate pozitive në:

- Transparencën në publikimin e informacioneve;
- Ndërmarrjen e të gjitha masave administrative dhe ligjore për vjeljen e detyrimeve të pashlyera të të tretëve ndaj bashkisë;
- Hartimin e procedurave të dhënies së lejeve sezonale dhe kontraktimit të shërbimeve;
- Ngritjen e komisioneve për asgjësimin e aseteve jashtë përdorimit.

Masat dhe aktivitetet e realizuara në kuadër të zbatimit të Planit të Integritetit kanë ndikuar në përmirësimin e kuadrit rregullator, me synim rritjen e integritetit në menaxhimin financiar, administrimin e aseteve, si dhe të transparencës institucionale.

Rekomandime

- Të vijojë puna për realizimin e masave/aktiviteteve të planifikuara në Planin e Integritetit;
- Forcimi i koordinimit dhe bashkëpunimit ndërmjet drejtorive, për një raportim më të rregullt mbi masat e Planit të Integritetit;
- Sigurimi i një raportimi periodik transparent, përmes publikimit të raporteve 6-mujore mbi zbatimin e Planit të Integritetit;
- Trajnimi në vijimësi i Koordinatorit të Integritetit të bashkisë.



RAPORT MONITORIMI

mbi Realizimin e Planeve të Integritetit
të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore

BASHKIA KLOS

për periudhën
Janar – Dhjetor 2025

Monitorimi i zbatueshmërisë të Planit të Integritetit për vitin 2025

Raporti i Monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit të **Bashkisë Klos** për vitin 2025 përbën dokumentin e parë të monitorimit të planit të veprimit të Planit të Integritetit të bashkisë.

Plani i Integritetit është konceptuar për t'u zbatuar përgjatë një periudhe katërvjeçare, konkretisht 2025-2028.

Në Planin e Integritetit të bashkisë janë përcaktuar gjithsej tre objektiva, për të cilat janë parashikuar fushat me risk, si dhe janë planifikuar masat dhe aktivitetet për realizimin e tyre, si vijon:

- **Objektivi I** - Ndërtimi i një klime organizative që nxit integritetin në çdo nivel të strukturës bashkiake, si dhe zhvillimi i kapitalit njerëzor për integritet afatgjatë;
- **Objektivi II** - Forcimi i mbrojtjes institucionale në fushat me ekspozim të lartë ndaj abuzimeve;
- **Objektivi III** - Rritja e transparencës dhe llogaridhënies, për të forcuar besimin e qytetarëve.

Për bashkinë Klos, Plani i Integritetit për periudhën janar-dhjetor 2025, referuar Planit të Veprimit, përmban masa dhe aktivitete të planifikuara sipas objektivave të përcaktuara në Planin e Veprimit.

Situata e monitorimit të Planit të Integritetit të Bashkisë Klos për periudhën janar–dhjetor 2025



Nga procesi i monitorimit rezulton se, në totalin prej 11 masash (aktivitetesh) të parashikuara për zbatim për vitin 2025:

- 6 masa/aktivitete janë realizuar plotësisht, që përfaqëson 55% të totalit
- 0 masa/aktivitete janë në proces realizimi, ose 0%
- 5 masa/aktivitete mbeten të porealizuara, ose 45%

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun vijues.

Tabela 1. Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Bashkia Klos	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të porealizuara
Numri i masave / aktiviteteve	11	6	0	5

Figura 1. Zbatimi i Planit të Integritetit, 2025 (%)**Figura 2. Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025**

Bashkia Klos, gjatë vitit 2025, ka ndërmarrë një sërë hapash fillestare në drejtim të forcimit të qeverisjes së mirë dhe integritetit institucional. Në këtë kuadër, ka hartuar dhe miratuar disa dokumente strategjike që adresojnë forcimin e etikës dhe integritetit, përmirësimin e funksionimit të strukturave vendore antikorrupsion, konsolidimin e kuadrit të brendshëm institucional, zhvillimin dhe fuqizimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore, rritjen e rezistencës institucionale ndaj risqeve të integritetit, si dhe përmirësimin e transparencës dhe besueshmërisë publike.

Gjetjet e Raportit

Objektivi I - Ndërtimi i një klime organizative që nxit integritetin në çdo nivel të strukturës bashkiake, si dhe zhvillimi i kapitalit njerëzor për integritet afatgjatë

Ky objektiv synon të forcojë mekanizmat që lidhen me garantimin e integritetit duke përmirësuar menaxhimin dhe kapacitetet e burimeve njerëzore të bashkisë. Nëpërmjet përmirësimit të proceseve të menaxhimit të burimeve njerëzore në institucion, do të sigurohen kapacitetet dhe aftësitë e nevojshme për zbatimin dhe konsolidimin e mekanizmave garantues të integritetit në institucion, me qëllim rritjen e profesionalizimit të personelit dhe zhvillimin në karrierë të zyrtarëve, në përputhje me performancën e tyre në punë.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objektivi, për vitin 2025 është planifikuar për t'u realizuar gjithsej 1 masë/aktivitet, e cila:


- Është realizuar, ose 100%

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 2. Objektivi I - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objektivi I	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Ndërtimi i Klimës Organizative	1	1	0	0

Figura 3. Objektivi I - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektiv është realizuar në masën 100%, me zbatimin e masës/aktivitetit si më poshtë:

- Sigurimi i plotësisht të organikës me punonjës për Sektorin e Performancës — nisma e Qeverisë për Grantin bazuar në performancë duhet ta shtyjë këtë proces, pasi bashkitë do të testohen për performancën e tyre për të marrë fonde nga ky grant.

Objektivi II - Forcimi i mbrojtjes institucionale në fushat me ekspozim të lartë ndaj abuzimeve

Ky objektivi synon të forcojë strukturat dhe mekanizmat që funksionojnë në nivelin e vetëqeverisjes vendore, të cilat kontribuojnë në rritjen e integritetit institucional dhe veprojnë si instrumente antikorrupsion. Këto struktura dhe mekanizma ngrihen dhe funksionojnë në përputhje me kornizën ligjore për vetëqeverisjen vendore, të drejtën e informimit, konsultimin publik, menaxhimin dhe kontrollin financiar, sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesit, parandalimin e konfliktit të interesit, etj.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objektivi, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 3 masa/aktivitete, nga të cilat:


- Janë realizuar 3 masa/aktivitete ose 100%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 3. Objektivi II - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objektivi II	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Forcimi i Mbrojtjes Institucionale	3	3	0	0

Figura 4. Objektivi II - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektivi është realizuar në masën 100%, me zbatimin e masave/aktiviteteve si më poshtë:

- Bashkëpunimi me gjendjen civile për të përftuar informacion zyrtar, si dhe gjetja e mënyrave të përshtatshme për të arritur drejt një numri formal dhe real të familjeve që aktualisht jetojnë, mbi bazën e të cilave do të planifikohen taksat;
- Hartimi i një regjistri për konfliktin e interesit dhe administrimi i tij nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore (DBNJ);
- Informimi i personelit të bashkisë në lidhje me krijimin e regjistrimit.

Objektivi III - Rritja e transparencës dhe llogaridhënies, për të forcuar besimin e qytetarëve

Transparenca e bashkisë gjatë procesit të zbatimit të politikave vendore është shumë e rëndësishme për rritjen e pjesëmarrjes së aktorëve të ndryshëm në veprimtarinë e bashkisë dhe të publikut në tërësi. Në këtë kuadër, është me rëndësi edhe sigurimi i pjesëmarrjes së publikut në procesin e identifikimit të prioritetëve strategjike afatgjata. Për këtë arsye, bashkia angazhohet të forcojë mekanizmat e pjesëmarrjes për shoqërinë civile dhe grupe të veçanta të interesit, gjatë hartimit dhe konsultimit të dokumenteve të politikave të ndryshme vendore.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objekti, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 7 masa/aktivitete, nga të cilat:


- Janë realizuar 2 masa/aktivitete ose 28%
- Nuk janë realizuar 5 masa/aktivitete ose 72%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 4. Objektivi III - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objektivi III	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Forcimi i Transparencës dhe Llogaridhënies	7	2	0	5

Figura 5. Objektivi III - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektivi është realizuar në masën 28%, me zbatimin e masave/aktiviteteve si më poshtë:

- Plotësimi i Programit të Transparencës së publikuar në faqen zyrtare të internetit, me kategoritë e informacionit që mungojnë, dhe/ose përditësimi me informacion të ri, në përputhje me cilësitë e informacionit publik: i plotë, i saktë, i përditësuar, i thjeshtë në konsultim, i kuptueshëm, lehtësisht i aksesueshëm dhe lehtësisht i përdorshëm;

- Publikimi i raporteve të auditit të brendshëm dhe të jashtëm, me një përmbledhje të gjetjeve të tyre dhe mënyrën se si bashkia planifikon t'i përmirësojë apo adresojë.

Konkluzione

Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi për periudhën raportuese janar-dhjetor 2025, bazuar në gjetjet që ky dokument ofron, të dhënat analitike të raportuara nga drejtoritë përkatëse dhe analizën e kryer, rezulton se:

Bashkia Klos ka vijuar me zbatimin e Planit të Integritetit, duke arritur një nivel realizimi prej 55% të masave të planifikuara për vitin 2025 (në intervalin 40-60%). Gjatë kësaj periudhe janë arritur disa rezultate si:

- Ngritja e kulturës së integritetit dhe llogaridhënies në bashki;
- Njohja e personelit me bazën ligjore antikorrupsion;
- Plotësimi i Programit të Transparencës.

Masat dhe aktivitetet e realizuara në kuadër të zbatimit të Planit të Integritetit kanë ndikuar në rritjen e shkallës së kulturës së integritetit institucional. Si rezultat, janë hartuar disa dokumente strategjike mbi etikën në aspekte të punës, si dhe instrumente për raportimin e korrupsionit apo shkeljeve të tjera, të cilat janë bërë të aksesueshme online në adresën zyrtare të bashkisë.

Rekomandime

- Të vijojë puna lidhur me zbatimin e masave/aktiviteteve të Planit të Integritetit;
- Rritja e pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje;
- Të njihet personeli i bashkisë me ndryshimet e fundit ligjore të paketës antikorrupsion, si dhe të hartohet dhe miratohet rregullorja për konfliktin e interesit, në përputhje me ndryshimet e fundit ligjore;
- Sigurimi i një raportimi periodik transparent, përmes publikimit të raporteve 6-mujore mbi zbatimin e Planit të Integritetit;
- Trajnimi në vijimësi i Koordinatorit të Integritetit të bashkisë.



RAPORT MONITORIMI

mbi Realizimin e Planeve të Integritetit
të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore

BASHKIA KOLONJË

për periudhën
Janar – Dhjetor 2025

Monitorimi i zbatueshmërisë të Planit të Integritetit për vitin 2025

Raporti i Monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit të **Bashkisë Kolonjë** për vitin 2025 përbën dokumentin e parë të monitorimit të planit të veprimit të Planit të Integritetit të bashkisë.

Plani i Integritetit është konceptuar për t'u zbatuar përgjatë një periudhe trevjeçare, konkretisht 2025-2027.

Në Planin e Integritetit të bashkisë janë përcaktuar gjithsej tre objektiva, për të cilat janë parashikuar fushat me risk, si dhe janë planifikuar masat dhe aktivitetet për realizimin e tyre, si vijon:

- **Objektivi I** - Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator dhe institucional;
- **Objektivi II** - Menaxhimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore në bashki, për identifikimin dhe parandalimin e risqeve të integritetit;
- **Objektivi III** - Përmirësimi i transparencës dhe llogaridhënies publike.

Për bashkinë Kolonjë, Plani i Integritetit për periudhën janar-dhjetor 2025, referuar Planit të Veprimit, përmban masa dhe aktivitete të planifikuara sipas objektivave të përcaktuara në Planin e Veprimit.

Situata e monitorimit të Planit të Integritetit të Bashkisë Kolonjë për periudhën janar–dhjetor 2025



Nga procesi i monitorimit rezulton se, në totalin prej 34 masash (aktivitetesh) të parashikuara për zbatim për vitin 2025:

- 18 masa/aktivitete janë realizuar plotësisht, që përfaqëson 53% të totalit
- 3 masa/aktivitete janë në proces realizimi, ose 9%
- 13 masa/aktivitete mbeten të porealizuara, ose 38%

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun vijues.

Tabela 1. Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Bashkia Kolonjë	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të porealizuara
Numri i masave / aktiviteteve	34	18	3	13

Figura 1. Zbatimi i Planit të Integritetit, 2025 (%)**Figura 2. Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025**

Bashkia Kolonjë, gjatë vitit 2025, ka ndërmarrë disa hapa në drejtim të forcimit të qeverisjes së mirë dhe integritetit institucional. Në këtë kuadër, ka hartuar dhe miratuar disa dokumente strategjike që adresojnë forcimin e etikës dhe integritetit, përmirësimin e funksionimit të strukturave vendore antikorrupsion, konsolidimin e kuadrit të brendshëm institucional, zhvillimin dhe fuqizimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore, rritjen e rezistencës institucionale ndaj risqeve të integritetit, si dhe përmirësimin e transparencës dhe besueshmërisë publike.

Gjetjet e Raportit

Objektivi I - Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator dhe institucional

Ky objektivi synon forcimin e kuadrit të brendshëm rregullator për etikën dhe integritetin, në përputhje me kornizën ligjore për vetëqeverisjen vendore, të drejtën e informimit, konsultimin

publik, menaxhimin dhe kontrollin financiar, sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesit, parandalimin e konfliktit të interesit, etj.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objekti, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 22 masa/aktivitete, nga të cilat:


- Janë realizuar 10 masa/aktivitete ose 45%
- Është në proces realizimi 1 masë/aktivitet ose 4%
- Nuk janë realizuar 11 masa/aktivitete ose 50%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 2. Objekti I - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objekti I	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Forcimi i Kuadrit Rregullator	22	10	1	11

Figura 3. Objekti I - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektiv është realizuar në masën 45%, me zbatimin e masave/aktiviteteve si më poshtë:

- Hartimi, konsultimi dhe miratimi i Planit Strategjik të Zhvillimit të Bashkisë Kolonjë;
- Përcaktimi i plotë dhe i qartë në rregullore i detyrave dhe linjave të komunikimit dhe hierarkisë ndërmjet strukturave të bashkisë;
- Rishikimi i Regjistrisë të Riskut nga të gjitha drejtoritë;
- Trajnimi i personelit lidhur me metodologjinë e hartimit të Riskut;
- Hartimi i Planit të Brendshëm të Trajnimeve mbi kuadrin ligjor për etikën dhe integritetin;
- Realizimi i monitorimeve periodike dhe kryerja e një analize mbi këtë proces;
- Hartimi i standardeve të administrimit të performancës;

- Krijimi i regjistrit për deklarimin e dhuratave në bashki;
- Informimi i personelit në lidhje me krijimin e regjistrit dhe detyrimet që lidhen me deklarimin e dhuratave.

Objektivi II - Menaxhimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore në bashki, për identifikimin dhe parandalimin e risqeve të integritetit

Ky objektivi synon të forcojë mekanizmat që lidhen me garantimin e integritetit duke përmirësuar menaxhimin dhe kapacitetet e burimeve njerëzore të bashkisë. Nëpërmjet përmirësimit të proceseve të menaxhimit të burimeve njerëzore në institucion, do të sigurohen kapacitetet dhe aftësitë e nevojshme për zbatimin dhe konsolidimin e mekanizmave garantues të integritetit në institucion, me qëllim rritjen e profesionalizimit të personelit dhe zhvillimin në karrierë të zyrtarëve, në përputhje me performancën e tyre në punë.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objektivi, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 10 masa/aktivitete, nga të cilat:


- Janë realizuar 7 masa/aktivitete ose 70%
- Janë në proces realizimi 2 masa/aktivitete ose 20%
- Nuk është realizuar 1 masë/aktivitet ose 10%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 3. Objektivi II - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objektivi II	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Fuqizimi i Burimeve Njerëzore	10	7	2	1

Figura 4. Objektivi II - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektivi është realizuar në masën 70%, me zbatimin e masave/aktiviteteve si më poshtë:

- Komunikimi nëpërmjet kërkesës zyrtare me Departamentin e Administratës Publike për marrjen e aksesit në sistemin HRMIS;
- Plotësimi i Sektorit të Auditimit të Brendshëm me burime njerëzore, sipas kritereve të përcaktuara, bazës ligjore përkatëse dhe në përputhje me strukturën e miratuar të bashkisë;
- Vlerësimi i nevojës për rishikimin dhe rekrutimin e burimeve njerëzore të specializuara në Sektorin e Planifikimit të Territorit;
- Hartimi i planeve vjetore të punës për çdo drejtori të bashkisë;
- Dorëzimi i tyre pranë titullarit të bashkisë;
- Informimi i punonjësve të drejtorisë për planet e trajnimeve.

Objektivi III - Përmirësimi i transparencës dhe llogaridhënies publike

Ky objektivi synon forcimin e llogaridhënies publike dhe transparencës në bashki, duke përmirësuar transparencën proaktive të institucionit, nëpërmjet plotësimit dhe përditësimit të rregullt të Programit të Transparencës. Përmirësimi i këtyre proceseve do të ndikojë në rritjen e besimit të publikut dhe përfshirjen e tij në veprimtarinë e bashkisë, duke shfrytëzuar aksesin e shtuar në informacion.


Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objektivi, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 2 masa/aktivitete, nga të cilat:

- Është realizuar 1 masë/aktivitet ose 50%
- Nuk është realizuar 1 masë/aktivitet ose 50%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 4. Objektivi III - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objektivi III	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Forcimi i transparencës dhe llogaridhënies	2	1	0	1

Figura 5. Objektiv III - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit

Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektiv është realizuar në masën 50%, me zbatimin e masës/aktivitetit si më poshtë:

- Publikimi i Raportit Vjetor të Transparencës në procesin e vendimmarrjes, në Programin e Transparencës.

Konkluzione

Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi për periudhën raportuese janar-dhjetor 2025, bazuar në gjetjet që ky dokument ofron, të dhënat analitike të raportuara nga drejtoritë përkatëse dhe analizën e kryer, rezulton se:

Bashkia Kolonjë ka vijuar me zbatimin e Planit të Integritetit, duke arritur një nivel realizimi prej 53% të masave të planifikuara për vitin 2025 (në intervalin 40-60%). Gjatë kësaj periudhe janë arritur disa rezultate si:

- Ngritja e kulturës së integritetit në bashki;
- Trajnime dhe aktivitete që mbështesin etikën institucionale;
- Trajnimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore;
- Njohja e personelit me bazën ligjore antikorrupsion.

Masat dhe aktivitetet e realizuara në kuadër të zbatimit të Planit të Integritetit kanë ndikuar në rritjen e shkallës së kulturës së integritetit institucional. Si rezultat, janë hartuar disa dokumente strategjike mbi etikën në aspekte të punës dhe të shërbimeve të ofruara, si dhe instrumente për raportimin e korrupsionit.

Rekomandime

- Të vijojë puna lidhur me zbatimin e masave/aktiviteteve të Planit të Integritetit;
- Rritja e pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje;
- Të rritet niveli i koordinimit dhe bashkëpunimit ndërmjet drejtorive, për një raportim më të rregullt mbi masat e Planit të Integritetit.



RAPORT MONITORIMI

mbi Realizimin e Planeve të Integritetit
të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore

BASHKIA KONISPOL

për periudhën
Janar – Dhjetor 2025

Monitorimi i zbatueshmërisë të Planit të Integritetit për vitin 2025

Raporti i Monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit të **Bashkisë Konispol** për vitin 2025 përbën dokumentin e parë të monitorimit të planit të veprimit të Planit të Integritetit të bashkisë.

Plani i Integritetit është konceptuar për t'u zbatuar përgjatë një periudhe trevjeçare, konkretisht 2025-2027.

Në Planin e Integritetit të bashkisë janë përcaktuar gjithsej katër objektiva, për të cilat janë parashikuar fushat me risk, si dhe janë planifikuar masat dhe aktivitetet për realizimin e tyre, si vijon:

- **Objektivi I** - Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit;
- **Objektivi II** - Menaxhimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore në bashki, për identifikimin dhe parandalimin e risqeve të integritetit;
- **Objektivi III** - Rritja e transparencës dhe llogaridhënies publike;
- **Objektivi IV** - Menaxhimi i riskut të integritetit në fusha të veçanta të përgjegjësisë së bashkisë.

Për bashkinë Konispol, Plani i Integritetit për periudhën janar-dhjetor 2025, referuar Planit të Veprimit, përmban masa dhe aktivitete të planifikuara sipas objektivave të përcaktuara në Planin e Veprimit.

Situata e monitorimit të Planit të Integritetit të Bashkisë Konispol për periudhën janar–dhjetor 2025



Nga procesi i monitorimit rezulton se, në totalin prej 57 masash (aktivitetesh) të parashikuara për zbatim për vitin 2025:

- 37 masa/aktivitete janë realizuar plotësisht, që përfaqëson 65% të totalit
- 0 masa/aktivitete janë në proces realizimi, ose 0%
- 20 masa/aktivitete mbeten të porealizuara, ose 35%

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun vijues.

Tabela 1. Shkalla e realizimit të masave/aktiviteve, 2025

Bashkia Konispol	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të porealizuara
Numri i masave / aktiviteteve	57	37	0	20

Figura 1. Zbatimi i Planit të Integritetit, 2025 (%)**Figura 2. Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025**

Bashkia Konispol, gjatë vitit 2025, ka ndërmarrë një sërë hapash në drejtim të forcimit të qeverisjes së mirë dhe integritetit institucional. Në këtë kuadër, ka hartuar dhe miratuar disa dokumente strategjike që adresojnë forcimin e etikës dhe integritetit, përmirësimin e funksionimit të strukturave vendore antikorrupsion, konsolidimin e kuadrit të brendshëm institucional, zhvillimin dhe fuqizimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore, rritjen e rezistencës institucionale ndaj risqeve të integritetit, si dhe përmirësimin e transparencës dhe besueshmërisë publike.

Gjetjet e Raportit

Objektivi I - Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit

Ky objektivi synon forcimin e kuadrit të brendshëm rregullator për etikën dhe integritetin, në përputhje me kornizën ligjore për vetëqeverisjen vendore, të drejtën e informimit, konsultimin publik, menaxhimin dhe kontrollin financiar, sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesit, parandalimin e konfliktit të interesit, etj.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objektivi, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 16 masa/aktivitete, nga të cilat:


- Janë realizuar 10 masa/aktivitete ose 62%
- Janë në proces realizimi 0 masa/aktivitete ose 0%
- Nuk janë realizuar 6 masa/aktivitete ose 38%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 2. Objektivi I - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objektivi I	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Forcimi i Kuadrit Rregullator	16	10	0	6

Figura 3. Objektivi I - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektivi është realizuar në masën 62%, me zbatimin e masave/aktiviteteve si më poshtë:

- Përditësimi (dhe miratimi) i rregullores së bashkisë me strukturën aktuale;

- Përcaktimi i plotë dhe i qartë në rregullore i detyrave dhe linjave të komunikimit dhe hierarkisë ndërmjet strukturave të bashkisë;
- Hartimi dhe miratimi i Kodit të Sjelljes për administratën e bashkisë, duke përfshirë rregulla në lidhje me parandalimin dhe deklarimin e konfliktit të interesit, veprimtaritë e jashtme, pranimin dhe deklarimin e dhuratave, si dhe deklarimin e pasurisë;
- Përfshirja në rregulloren e Koordinatorit të Integritetit e rregullave mbi parandalimin e konfliktit të interesit në fushën e shërbimeve publike;
- Informimi i punonjësve të sektorit mbi rregulloren e Koordinatorit të Integritetit, përmes trajnimeve të dedikuara;
- Organizimi i sesioneve trajnuese/orientuese për drejtuesit e programeve mbi kryerjen e analizave, bazuar në informacionin financiar dhe jofinanciar të viteve të kaluara dhe vitit buxhetor aktual, si dhe procesin e kostimit, me përfshirjen e tyre në planin vjetor të trajnimeve;
- Ngritja e një grupi pune me urdhër të titullarit, për hartimin e standardeve të cilësisë për çdo shërbim;
- Publikimi i instrumentit të miratuar dhe treguesve përkatës të performancës në Programin e Transparencës së bashkisë;
- Krijimi i regjistrit për deklarimin e dhuratave në bashki;
- Informimi i personelit në lidhje me krijimin e regjistrit dhe detyrimet që lidhen me deklarimin e dhuratave.

Objektivi II - Menaxhimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore në bashki, për identifikimin dhe parandalimin e risqeve të integritetit

Ky objektivi synon të forcojë mekanizmat që lidhen me garantimin e integritetit duke përmirësuar menaxhimin dhe kapacitetet e burimeve njerëzore të bashkisë. Nëpërmjet përmirësimit të proceseve të menaxhimit të burimeve njerëzore në institucion, do të sigurohen kapacitetet dhe aftësitë e nevojshme për zbatimin dhe konsolidimin e mekanizmave garantues të integritetit në institucion, me qëllim rritjen e profesionalizimit të personelit dhe zhvillimin në karrierë të zyrtarëve, në përputhje me performancën e tyre në punë.


Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objektivi, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 23 masa/aktivitete, nga të cilat:

- Janë realizuar 20 masa/aktivitete ose 87%
- Janë në proces realizimi 0 masa/aktivitete ose 0%
- Nuk janë realizuar 3 masa/aktivitete ose 13%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 3. Objektivi II - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objektivi II	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Fuqizimi i Burimeve Njerëzore	23	20	0	3

Figura 4. Objektivi II - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit

Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektivi është realizuar në masën 87%, me zbatimin e masave/aktiviteteve si më poshtë:

- Hartimi i një PSV-je për trajtimin e ankesave dhe kërkesave të qytetarëve në lidhje me administrimin e pronave, dhe publikimi i saj në Programin e Transparencës;
- Komunikimi nëpërmjet kërkesës zyrtare me Departamentin e Administratës Publike për marrjen e aksesit në sistemin HRMIS;
- Trajnimi i vazhdueshëm i punonjësve mbi ndryshimet ligjore në fushën e prokurimit publik, në bashkëpunim me AMVV-në dhe ASPA-n;
- Rishikimi i strukturës organizative;
- Plotësimi i strukturës me staf të kualifikuar;
- Planifikimi i trajnimeve për rritjen e kapaciteteve;
- Vlerësimi i nevojave për burime njerëzore në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, me dorëzimin e rezultateve të vlerësimit të Kryetari i Bashkisë;
- Shpallja e vakancave ekzistuese për përmbushjen e organikës në Drejtorinë e Planifikimit dhe Administrimit të Territorit;
- Marrja e masave për koordinimin e kërkesave buxhetore me të gjithë sektorët e bashkisë;

- Miratimi i kërkesave në nivel drejtorie/sektori dhe diskutimi i tyre me Ekipet e Menaxhimit të Buxhetit;
- Trajnimi i punonjësve mbi rregullat dhe udhëzimet për përgatitjen e PBA-së;
- Organizimi i trajnimeve për personelin në lidhje me çështje të etikës dhe parandalimit të konfliktit të interesit, të përfshira në Planin Vjetor të Bashkisë për Trajnimet;
- Organizimi i takimeve informuese me personelin e bashkisë, për të rritur ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e procedurës së vlerësimit të rezultateve në punë, të përfshira në Planin Vjetor të Trajnimeve;
- Organizimi i trajnimeve për personelin e bashkisë në lidhje me procedurat e sinjalizimit, të përfshira në Planin Vjetor të Bashkisë për Trajnimet;
- Informimi i të gjithë punonjësve mbi rregulloren e sinjalizuesit dhe vënia në dispozicion e saj;
- Rikujtesë periodike e punonjësve mbi funksionin dhe kontaktin e sinjalizuesit;
- Publikimi i informacionit për njësinë e sinjalizimit dhe kontaktet e saj, në Programin e Transparencës.

Objektivi III - Rritja e transparencës dhe llogaridhënies publike

Transparenca e bashkisë gjatë procesit të zbatimit të politikave vendore është shumë e rëndësishme për rritjen e pjesëmarrjes së aktorëve të ndryshëm në veprimtarinë e bashkisë dhe të publikut në tërësi. Në këtë kuadër, është me rëndësi edhe siguri i pjesëmarrjes së publikut në procesin e identifikimit të prioritetëve strategjike afatgjata. Për këtë arsye, bashkia angazhohet të forcojë mekanizmat e pjesëmarrjes për shoqërinë civile dhe grupe të veçanta të interesit, gjatë hartimit dhe konsultimit të dokumenteve të politikave të ndryshme vendore.


Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objektivi, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 9 masa/aktivitete, nga të cilat:

- Janë realizuar 3 masa/aktivitete ose 33%
- Janë në proces realizimi 0 masa/aktivitete ose 0%
- Nuk janë realizuar 6 masa/aktivitete ose 66%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 4. Objektivi III - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objektivi III	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuar
Forcimi i Transparencës dhe Llogaridhënies	9	3	0	6

Figura 5. Objektivi III - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit

Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektivi është realizuar në masën 33%, me zbatimin e masave/aktiviteteve si më poshtë:

- Publikimi i vakancave në sektorin civil në faqen zyrtare të bashkisë, sipas parashikimeve të legjislacionit përkatës;
- Parashikimi i trajnimeve për koordinatorin për konsultimin publik, si dhe hartimi i përshkrimit të punës të dedikuar për këtë koordinator;
- Plotësimi i faqes së internetit të bashkisë në format user-friendly, si dhe publikimi pranë stendave të informimit të publikut të shërbimeve sociale të ofruara nga Bashkia Konispol, duke përfshirë kategoritë dhe mënyrën e përfitimit.

Objektivi IV - Menaxhimi i riskut të integritetit në fusha të veçanta të përgjegjësisë së bashkisë

Nëpërmjet këtij objektivi synohet menaxhimi i riskut të integritetit në fushat kryesore të përgjegjësisë së bashkisë, duke u fokusuar në proceset e punës të vlerësuara si më të ekspozuarat ndaj rrezikut të korrupsionit. Në tërësinë e tij, menaxhimi i integritetit i Bashkisë Konispol paraqet sfida, të cilat janë parashikuar edhe në Strategjinë për Qeverisjen Vendore dhe që hasen më së shumti në fusha të veçanta të përgjegjësisë, të tilla si fusha e menaxhimit financiar, menaxhimi i pronave të bashkisë, shërbimet publike dhe arkivimi.


Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objektivi, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 9 masa/aktivitete, nga të cilat:

- Janë realizuar 4 masa/aktivitete ose 44%
- Janë në proces realizimi 0 masa/aktivitete ose 0%
- Nuk janë realizuar 5 masa/aktivitete ose 56%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 5. Objektivi IV - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objektivi IV	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Fusha të Veçanta	9	4	0	5

Figura 6. Objektivi IV - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit

Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektivi është realizuar në masën 44%, me zbatimin e masave/aktiviteteve si më poshtë:

- Rritja e ndërgjegjësimit publik mbi shërbimet sociale të ofruara nga Bashkia Konispol dhe nxitja e bashkëpunimit me të për identifikimin e personave në nevojë në territor;
- Organizimi i trajnimeve të brendshme për personelin e drejtorive të përfshira në përgatitjen e PBA-së, për hartimin e kërkesave buxhetore, të parashikuara në Planin Vjetor të Bashkisë për Trajnimet;
- Ndjekja e të gjitha procedurave ligjore për të siguruar arkëtimin e detyrimeve nga debitorët e taksave dhe tarifave vendore.

Konkluzione

Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi për periudhën raportuese janar-dhjetor 2025, bazuar në gjetjet që ky dokument ofron, të dhënat analitike të raportuara nga drejtoritë përkatëse dhe analizën e kryer, rezulton se:

Bashkia Konispol ka vijuar me zbatimin e Planit të Integritetit, duke arritur një nivel mesatar realizimi prej 65% të masave të planifikuara për vitin 2025 (në intervalin 60-80%). Gjatë kësaj periudhe janë arritur disa rezultate si:

- Ngritja e kulturës së integritetit në bashki;
- Trajnime dhe aktivitete që mbështesin etikën institucionale;
- Trajnimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore;
- Njohja e punonjësve me bazën ligjore antikorrupsion;

Masat dhe aktivitetet e realizuara në kuadër të zbatimit të Planit të Integritetit kanë ndikuar në rritjen e shkallës së kulturës së integritetit institucional. Si rezultat, janë hartuar disa dokumente strategjike mbi etikën në aspekte të punës dhe të shërbimeve të ofruara, si dhe instrumente për raportimin e korrupsionit apo shkeljeve të tjera, të cilat janë bërë të aksesueshme online në adresën zyrtare të bashkisë.

Rekomandime

- Të vijojë puna për realizimin e masave/aktiviteteve të planifikuara në Planin e Integritetit;
- Rritja e pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje;
- Forcimi i koordinimit dhe bashkëpunimit ndërmjet drejtorive, për një raportim më të rregullt mbi masat e Planit të Integritetit;
- Sigurimi i një raportimi periodik transparent, përmes publikimit të raporteve 6-mujore mbi zbatimin e Planit të Integritetit;
- Trajnimi në vijimësi i Koordinatorit të Integritetit të bashkisë.



RAPORT MONITORIMI

mbi Realizimin e Planeve të Integritetit
të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore

BASHKIA KUKËS

për periudhën
Janar – Dhjetor 2025

Monitorimi i zbatueshmërisë të Planit të Integritetit për vitin 2025

Raporti i Monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit të Bashkisë Kukës për vitin 2025 përbën dokumentin e katërt të monitorimit të planit të veprimit të Planit të Integritetit të bashkisë.

Plani i Integritetit është konceptuar për t'u zbatuar përgjatë një periudhe katërvjeçare, konkretisht 2022-2025.

Në Planin e Integritetit të bashkisë janë përcaktuar gjithsej tre objektiva, për të cilat janë parashikuar fushat me risk, si dhe janë planifikuar masat dhe aktivitetet për realizimin e tyre, si vijon:

- **Objektivi I** - Menaxhimi i riskut të integritetit në fusha të veçanta të përgjegjësisë së bashkisë;
- **Objektivi II** - Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit;
- **Objektivi III** - Menaxhimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore në bashki, për identifikimin dhe parandalimin e risqeve të integritetit.

Për bashkinë Kukës, Plani i Integritetit për periudhën janar-dhjetor 2025, referuar Planit të Veprimit, përmban masa dhe aktivitete të planifikuara në vijimësi, vetëm në mbështetje të Objektivit I dhe III.

Situata e monitorimit të Planit të Integritetit të Bashkisë Kukës për periudhën janar–dhjetor 2025



Nga procesi i monitorimit rezulton se, në totalin prej 13 masash (aktivitetesh) të parashikuara për zbatim në vijimësi për vitin 2025:

- 8 masa/aktivitete janë realizuar plotësisht, që përfaqëson 61% të totalit
- 2 masa/aktivitete janë në proces realizimi, ose 15%
- 3 masa/aktivitete mbeten të porealizuara, ose 24%

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun vijues.

Tabela 1. Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Bashkia Kukës	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të porealizuara
Numri i masave / aktiviteteve	13	8	2	3

Figura 1. Zbatimi i Planit të Integritetit, 2025 (%)**Figura 2. Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025**

Sa më sipër, gjatë vitit 2025, Bashkia Kukës ka vijuar dhe ka ndërmarrë një sërë hapash në drejtim të forcimit të qeverisjes së mirë dhe integritetit institucional. Në këtë kuadër, është punuar në vijimësi për konsolidimin e kuadrit të brendshëm institucional, zhvillimin dhe fuqizimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore, rritjen e rezistencës institucionale ndaj risqeve të integritetit, si dhe përmirësimin e transparencës dhe të besueshmërisë publike.

Gjetjet e Raportit

Objektivi I - Menaxhimi i riskut të integritetit në fusha të veçanta të përgjegjësisë së bashkisë

Ky objektivi synon adresimin e risqeve të integritetit në fushat funksionale të përgjegjësisë së bashkisë. Masat e parashikuara synojnë të përmirësojnë efektivitetin, eficiencën dhe cilësinë e proceseve të punës në fushat funksionale të bashkisë, me qëllim përmirësimin e shërbimeve

publike, planifikimin e territorit, menaxhimin e pronave dhe aseteve publike, menaxhimin financiar, etj.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objekti, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar në vijimësi gjithsej 6 masa/aktivitete, nga të cilat:


- Janë realizuar 4 masa/aktivitete ose 67%
- Janë në proces realizimi 2 masa/aktivitete ose 33%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 2. Objekti I - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objekti I	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Fusha të veçanta	6	4	2	0

Figura 3. Objekti I - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektiv është realizuar në masën 67%, me zbatimin e masave/aktiviteteve si më poshtë:

- Koordinim i vazhdueshëm për respektimin e kalendarit të hartimit dhe miratimit të PBA-së dhe Buxhetit Vjetor, nga të gjitha palët e përfshira;
- Zhvillimi i konsultimeve të zgjeruara me banorët e bashkisë dhe njësive administrative gjatë përcaktimit të prioritetëve, për të siguruar përputhshmëri sa më të lartë të buxhetit me nevojat e komunitetit;
- Monitorimi i buxhetit bazuar në informacionin e viteve të kaluara dhe të vitit buxhetor aktual, dhe propozimi i ndryshimeve përkatëse në Këshillin Bashkiak;
- Planifikimi i taksave dhe tarifave, si dhe i të ardhurave dhe masave për mbledhjen e tyre, në përputhje me analizën e riskut dhe të dhënat faktike të treguesve në vitet e mëparshme.

Objektivi III - Menaxhimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore në bashki, për identifikimin dhe parandalimin e risqeve të integritetit

Ky objektivi synon të forcojë mekanizmat që lidhen me garantimin e integritetit, në nivelin e proceseve të punës, duke përmirësuar menaxhimin dhe kapacitetet e burimeve njerëzore të bashkisë, me qëllim rritjen e profesionalizimit të personelit dhe zhvillimin në karrierë të zyrtarëve, në përputhje me performancën në punë.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objektivi, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 7 masa/aktivitete, nga të cilat:


- Janë realizuar 4 masa/aktivitete ose 57%
- Nuk janë realizuar 3 masa/aktivitete ose 43%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 3. Objektivi III - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objektivi III	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Fuqizimi i Burimeve Njerëzore	7	4	0	3

Figura 4. Objektivi III - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektivi është realizuar në masën 57%, me zbatimin e masave/aktiviteteve si më poshtë:

- Publikimi i raportit të përmbledhur mbi ecurinë e realizimit të treguesve kryesorë të të ardhurave dhe shpenzimeve, në Programin e Transparencës;
- Zbatimi i kuadrit ligjor për mbrojtjen e privatësisë gjatë publikimit në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve;
- Përditësimi periodik i regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve;
- Plotësimi i Programit të Transparencës në përputhje me detyrimet ligjore mbi informacionin që bëhet publik pa kërkesë, duke u siguruar që informacioni të jetë i plotë, lehtësisht i aksesueshëm, i përditësuar, i kuptueshëm dhe lehtësisht i përdorshëm nga qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile.

Konkluzione

Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi për periudhën raportuese janar-dhjetor 2025, bazuar në gjetjet që ky dokument ofron, të dhënat analitike të raportuara nga drejtoritë përkatëse dhe analizën e kryer, rezulton se:

Bashkia Kukës ka vijuar me zbatimin e Planit të Integritetit, duke arritur një nivel të mirë realizimi prej 61% të masave të planifikuara në vijimësi për vitin 2025 (në intervalin 60-80%).

Gjatë kësaj periudhe janë arritur rezultate pozitive në:

- Ngritjen e kulturës së integritetit dhe realizimin e treguesve kryesorë të ardhurave dhe shpenzimeve;
- Transparencë më të lartë në publikimin e informacioneve.

Masat dhe aktivitetet e realizuara në kuadër të zbatimit të Planit të Integritetit kanë ndikuar në rritjen e shkallës së integritetit të institucionit. Ky progres e ka pozicionuar bashkinë në një nivel të kënaqshëm integriteti, e cila ndodhet tashmë në procesin e hartimit të Planit të ri të Integritetit të bashkisë.

Rekomandime

- Të vijojë puna për vlerësimin e riskut të integritetit mbi baza objektive, me qëllim hartimin e një plani për fuqizimin e integritetit, llogaridhënies dhe transparencës publike institucionale të Bashkisë Kukës;
- Forcimi i koordinimit dhe bashkëpunimit ndërmjet drejtorive, për një realizim dhe raportim më të rregullt mbi masat e Planit të Integritetit;
- Sigurimi i një raportimi periodik transparent, përmes publikimit të raporteve 6-mujore mbi zbatimin e Planit të Integritetit;
- Trajnimi në vijimësi i Koordinatorit të Integritetit të bashkisë.



RAPORT MONITORIMI

mbi Realizimin e Planeve të Integritetit
të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore

BASHKIA KURBIN

për periudhën
Janar – Dhjetor 2025

Monitorimi i zbatueshmërisë të Planit të Integritetit për vitin 2025

Raporti i Monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit të **Bashkisë Kurbin** për vitin 2025 përbën dokumentin e parë të monitorimit të planit të veprimit të Planit të Integritetit të bashkisë. Plani i Integritetit është konceptuar për t'u zbatuar përgjatë një periudhë pesëvjeçare konkretisht 2025-2029. Në Planin e Integritetit të bashkisë janë përcaktuar gjithsej tre objektiva kryesorë, për të cilat janë parashikuar fushat me risk, si dhe janë planifikuar masat dhe aktivitetet për realizimin e tyre, si vijon:

- **Objektivi I** - Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator në aspektet e veçanta të etikës dhe integritetit.
- **Objektivi II** - Përf forcimi i integritetit institucional të bashkisë, përmes menaxhimit dhe zhvillimit të burimeve njerëzore si dhe forcimit të shërbimeve publike dhe mbështetëse.
- **Objektivi III** - Përmirësimi i transparencës dhe llogaridhënies publike.

Situata e monitorimit të Planit të Integritetit të Bashkisë Kurbin për periudhën janar–dhjetor 2025

Nga procesi i monitorimit rezulton se, në totalin prej 12 masash (aktivitetesh) të parashikuara për zbatim për vitin 2025:

- 6 masa/aktivitete janë realizuar plotësisht, që përfaqëson 50% të totalit
- 1 masa/aktivitete janë në proces realizimi, ose 8 %
- 5 masa/aktivitete mbeten të porealizuara, ose 42 %

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun vijues.

Tabela 25. Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteteve, 2025

Bashkia Kurbin	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të porealizuara
Numri i masave / aktiviteteve	12	6	1	5

Figura 31. Zbatimi i Planit të Integritetit, 2025 (%)





Figura 32. Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Sa më sipër, gjatë vitit 2025, Bashkia Kurbin ka ndërmarrë hapa në drejtim të forcimit të qeverisjes së mirë dhe integritetit institucional. Në këtë kuadër, janë hartuar dhe miratuar disa dokumente strategjike që adresojnë forcimin e etikës dhe integritetit, përmirësimin e funksionimit të strukturave vendore antikorruption, konsolidimin e kuadrit të brendshëm institucional, zhvillimin dhe fuqizimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore, rritjen e rezistencës institucionale ndaj risqeve të integritetit, si dhe përmirësimin e transparencës dhe të besueshmërisë publike.

Gjetjet e Raportit

Objektivi I - Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator në aspektet e veçanta të etikës dhe integritetit

Ky objektivi synon të forcojë strukturat dhe mekanizmat që funksionojnë në nivelin e vetëqeverisjes vendore, të cilat kontribuojnë në rritjen e integritetit institucional dhe veprojnë si instrumente antikorruption. Këto struktura dhe mekanizma ngrihen dhe funksionojnë në përputhje me kornizën ligjore për vetëqeverisjen vendore, të drejtën e informimit, konsultimin publik, menaxhimin dhe kontrollin financiar, sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesit, parandalimin e konfliktit të interesit, etj.

Gjatë periudhës raportues, në kuadër të këtij objektivi, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 5 masa/aktivitete, nga të cilat:


- Janë realizuar 2 masa/aktivitete ose 40 %
- Është në proces realizimi 1 masë/aktivitet ose 20 %
- Nuk janë realizuar 2 masë/aktivitet ose 40 %.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 26. Objektivi I - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objektivi I	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Përmirësimi i Kuadrit Rregullator	5	2	1	2

Figura 33. Objektivi 1 - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Për këtë periudhë raportimi janar-dhjetor 2025, bashkia ka realizuar masa/aktivitete si:

- Zbatimi i ligjit për sinjalizuesit dhe protokolleve të brendshme;
- Kuti fizike për sinjalizim anonim.

Objektivi II - Përforcimi i integritetit institucional të bashkisë, përmes menaxhimit dhe zhvillimit të burimeve njerëzore si dhe forcimit të shërbimeve publike dhe mbështetëse

Ky objektiv synon forcimin e procesit të zhvillimit të burimeve njerëzore dhe të shërbimeve publike e mbështetëse në bashki, me qëllim identifikimin dhe parandalimin e risqeve të integritetit. Përmirësimi i proceseve të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse në institucion, do të sigurojë zhvillimin e kapaciteteve dhe aftësive të nevojshme në kuadër të zbatimit dhe konsolidimit të mekanizmave garantuese të integritetit në institucion, me qëllim rritjen e profesionalizimit të personelit dhe përmirësimin e integritetit të zyrtarëve.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objektivi, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 5 masa/aktivitete:


- Janë realizuar 2 masa/aktivitete ose 40 %
- Nuk janë realizuar 3 masa/aktivitete ose 60 %.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë:

Tabela 27. Objektivi II - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objektivi II	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Fuqizimi i Burimeve Njerëzore	5	2	0	3

Figura 34. Objektivi II - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, për këtë objektiv janë realizuar masa/aktivitete si më poshtë:

- Rritja e kapacitetit të Njesisë së Auditimit;
- Monitorim i zbatimit të rekomandimeve 2025.

Objektivi III - Përmirësimi i transparencës dhe llogaridhënies publike

Publikimi i të dhënave mbi buxhetin dhe shpenzimet në faqen e internetit të bashkisë dhe zhvillimi i konsultimeve publike për çështje të rëndësishme janë tregues pozitivë për angazhimin në transparencë dhe përfshirje qytetare. Megjithatë, mekanizmat e ndërveprimit dhe matjes së mendimit qytetar janë të kufizuar. Në përputhje me standardet e qeverisjes së hapur të promovuara nga BE, është e domosdoshme të zhvillohen mekanizma më aktivë për pjesëmarrje, si pyetësorë online, takime komunitare të strukturuar dhe zyrë për marrëdhënie me publikun. Përmirësimi i këtyre aspekteve rrit besimin e qytetarëve dhe ndihmon në ndërtimin e një administrate më të përgjegjshme.


Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objektivi, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 2 masa/aktivitete, nga të cilat:

- Janë realizuar 2 masa/aktivitete ose 100 %

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 28. Objektivi III - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objektivi III	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa ne proces	Masa të parealizuara
Forcimi i transparencës dhe llogaridhënies	2	2	0	0

Figura 35. Objektivi III - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit

Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, objektivi është realizuar në masën 100%, me zbatimin e masave /aktiviteteve si më poshtë:

- Publikimi proaktiv i kontratave;
- Dëgjesa publike në lagje/fshatra.

Konkluzione

Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi për periudhën raportuese *janar-dhjetor 2025*, bazuar në gjetjet që ky dokument ofron, të dhënat analitike të raportuara nga drejtoritë përkatëse dhe analizën e kryer, rezulton se:

Bashkia Kurbin ka vijuar me zbatimin e Planit të Integritetit, duke arritur një nivel bazik realizimi prej 50% të masave të planifikuara për vitin 2025 (në intervalin 40-60%). Gjatë kësaj periudhe janë arritur rezultate pozitive në:

- Ngritjen e kulturës së integritetit dhe llogaridhënies në bashki;
- Transparencë në publikimin e informacioneve;
- Rritja e pjesëmarrjes qytetare dhe nxitja e sinjalizimit, përmes krijimit të kanaleve efektive dhe anonime për denoncime;

Masat dhe aktivitetet e realizuara në kuadër të zbatimit të Planit të Integritetit kanë ndikuar në rritjen e shkallës së integritetit të institucionit. Ky progres e ka ndikuar në krijimin e një kulture integriteti institucional dhe forcimin e besueshmërisë publike ndaj institucionit.

Rekomandime

- Të vijojë puna për realizimin e masave /aktiviteteve të planifikuara në Planin e Integritetit;
- Zgjerimi i trajnimeve dhe fushatave ndërgjegjëse, me fokus në parandalimin e sjelljeve që cenojnë integritetin;
- Forcimi i koordinimit dhe bashkëpunimit ndërmjet drejtorive, për një raportim më të rregullt mbi masat e Planit të Integritetit;
- Sigurimi i një raportimi periodik transparent, përmes publikimit të raporteve 6-mujore mbi zbatimin e Planit të Integritetit;
- Trajnimi në vijimësi i Koordinatorit të Integritetit të bashkisë.



RAPORT MONITORIMI

mbi Realizimin e Planeve të Integritetit
të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore

BASHKIA LIBOHOVË

për periudhën
Janar – Dhjetor 2025

Monitorimi i zbatueshmërisë të Planit të Integritetit për vitin 2025

Raporti i Monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit të **Bashkisë Libohovë** për vitin 2025 përbën dokumentin e parë të monitorimit të planit të veprimit të Planit të Integritetit të bashkisë.

Plani i Integritetit është konceptuar për t'u zbatuar përgjatë një periudhe katërvjeçare, konkretisht 2024-2027.

Në Planin e Integritetit të bashkisë janë përcaktuar gjithsej tre objektiva, për të cilat janë parashikuar fushat me risk, si dhe janë planifikuar masat dhe aktivitetet për realizimin e tyre, si vijon:

- **Objektivi I** - Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator dhe institucional;
- **Objektivi II** - Menaxhimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore në bashki, për identifikimin dhe parandalimin e risqeve të integritetit;
- **Objektivi III** - Rritja e transparencës në ndarjen e të dhënave me publikun.

Për bashkinë Libohovë, Plani i Integritetit për periudhën janar-dhjetor 2025, referuar Planit të Veprimit, përmban masa dhe aktivitete të planifikuara sipas objektivave të përcaktuara në Planin e Veprimit.

Situata e monitorimit të Planit të Integritetit të Bashkisë Libohovë për periudhën janar–dhjetor 2025



Nga procesi i monitorimit rezulton se, në totalin prej 23 masash (aktivitetesh) të parashikuara për zbatim për vitin 2025:

- 16 masa/aktivitete janë realizuar plotësisht, që përfaqëson 69% të totalit
- 1 masë/aktivitet është në proces realizimi, ose 5%
- 6 masa/aktivitete mbeten të porealizuara, ose 26%

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun vijues.

Tabela 1. Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Bashkia Libohovë	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të porealizuara
Numri i masave / aktiviteteve	23	16	1	6

Figura 1. Zbatimi i Planit të Integritetit, 2025 (%)**Figura 2. Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025**

Bashkia Libohovë, gjatë vitit 2025, ka ndërmarrë një sërë hapash në drejtim të forcimit të qeverisjes së mirë dhe integritetit institucional. Në këtë kuadër, ka hartuar dhe miratuar disa dokumente strategjike që adresojnë forcimin e etikës dhe integritetit, përmirësimin e funksionimit të strukturave vendore antikorrupsion, konsolidimin e kuadrit të brendshëm institucional, zhvillimin dhe fuqizimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore, rritjen e rezistencës institucionale ndaj risqeve të integritetit, si dhe përmirësimin e transparencës dhe besueshmërisë publike.

Gjetjet e Raportit

Objektivi I - Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator dhe institucional

Ky objektivi synon forcimin e kuadrit të brendshëm rregullator për etikën dhe integritetin, në përputhje me kornizën ligjore për vetëqeverisjen vendore, të drejtën e informimit, konsultimin

publik, menaxhimin dhe kontrollin financiar, sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesit, parandalimin e konfliktit të interesit, etj.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objekti, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 8 masa/aktivitete, nga të cilat:


- Janë realizuar 5 masa/aktivitete ose 63%
- Është në proces realizimi 1 masë/aktivitet ose 12%
- Nuk janë realizuar 2 masa/aktivitete ose 25%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 2. Objekti I - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objekti I	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Forcimi i Kuadrit Rregullator	8	5	1	2

Figura 3. Objekti I - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektiv është realizuar në masën 63%, me zbatimin e masave/aktiviteteve si më poshtë:

- Hartimi i një Kodi Etike, në përputhje me ndryshimet e kuadrit rregullator për etikën në Shqipëri, si dhe me Manualin e DAP-it;
- Ngritja dhe vënia në funksionim e Autoritetit Përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesave në bashki, me urdhër të Kryetarit;
- Miratimi i regjistrave sipas modelit të ILDKPKI-së dhe administrimi i tyre;
- Hartimi dhe miratimi i rregullores për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidencialitetit, duke përshtatur modelin e ILDKPKI-së në kontekstin e Bashkisë Libohovë;

- Hartimi dhe miratimi i rregullores për hetimin administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja, duke përshtatur modelin e ILDKPKI-së në kontekstin e bashkisë.

Objektivi II - Menaxhimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore në bashki, për identifikimin dhe parandalimin e risqeve të integritetit

Ky objektivi synon të forcojë mekanizmat që lidhen me garantimin e integritetit duke përmirësuar menaxhimin dhe kapacitetet e burimeve njerëzore të bashkisë. Nëpërmjet përmirësimit të proceseve të menaxhimit të burimeve njerëzore në institucion, do të sigurohen kapacitetet dhe aftësitë e nevojshme për zbatimin dhe konsolidimin e mekanizmave garantues të integritetit në institucion, me qëllim rritjen e profesionalizimit të personelit dhe zhvillimin në karrierë të zyrtarëve, në përputhje me performancën e tyre në punë.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objektivi, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 11 masa/aktivitete, nga të cilat:


- Janë realizuar 7 masa/aktivitete ose 64%
- Janë në proces realizimi 0 masa/aktivitete ose 0%
- Nuk janë realizuar 4 masa/aktivitete ose 36%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 3. Objektivi II - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objektivi II	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të përealizuara
Fuqizimi i Burimeve Njerëzore	11	7	0	4

Figura 4. Objektivi II - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektivi është realizuar në masën 64%, me zbatimin e masave/aktiviteteve si më poshtë:

- Rishikimi i strukturës së Bashkisë Libohovë në përputhje me skemën e administrimit të shërbimit civil;
- Rishikimi i strukturës së Bashkisë Libohovë, me objektiv krijimin e një drejtorie shërbimesh ku të përfshihen fushat/funksionet horizontale;
- Marrja e masave për plotësimin në kohë të vakancave në staf;
- Rishikimi i kategorive të pagave, në bashkëpunim me AMVV-në, për funksionet që kanë mungesë punonjësish në territor;
- Bashkëpunim me ASPA apo institucionet përkatëse të specializuara, për realizimin e trajnimeve;
- Dedikim i një fondi të veçantë në buxhetin e bashkisë, për trajnime specifike që nuk ofrohen falas nga institucionet përkatëse.

Objektivi III - Rritja e transparencës në ndarjen e të dhënave me publikun

Ky objektivi synon të forcojë strukturat dhe mekanizmat që funksionojnë në nivelin e vetëqeverisjes vendore, të cilat kontribuojnë në rritjen e integritetit institucional dhe veprojnë si instrumente antikorrupsion. Këto struktura dhe mekanizma ngrihen dhe funksionojnë në përputhje me kornizën ligjore për vetëqeverisjen vendore, të drejtën e informimit, konsultimin publik, menaxhimin dhe kontrollin financiar, sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesit, parandalimin e konfliktit të interesit, etj.


Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objektivi, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 4 masa/aktivitete, nga të cilat:

- Janë realizuar 4 masa/aktivitete ose 100%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 4. Objektivi III - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objektivi III	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Forcimi i Transparencës dhe Llogaridhënies	4	4	0	0

Figura 5. Objektivi III - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit

Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektivi është realizuar në masën 100%, me zbatimin e masave/aktiviteteve si më poshtë:

- Plotësimi dhe përditësimi i Programit të Transparencës me informacion aktual;
- Publikimi i shpalljeve për vendet e lira në shërbimin civil, në përputhje me ligjin 152/2013 (i ndryshuar) dhe aktet nënligjore, në faqen e internetit dhe në stendat e informimit të publikut të bashkisë;
- Publikimi i raporteve të monitorimit të buxhetit, sipas periodicitetit të parashikuar, në faqen e internetit të bashkisë;
- Në bazë të “Listës tip të dokumenteve me afatet e ruajtjes” dhe të “Listës së dokumenteve me rëndësi historike kombëtare”, të shpallura nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, hartimi dhe publikimi i listës konkrete të dokumenteve me rëndësi historike kombëtare dhe të dokumenteve me afat ruajtjeje të përkohshme, si dhe përcaktimi i afateve të ruajtjes sipas modelit nr. 11 të DPA-së.

Konkluzione

Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi për periudhën raportuese janar-dhjetor 2025, bazuar në gjetjet që ky dokument ofron, të dhënat analitike të raportuara nga drejtoritë përkatëse dhe analizën e kryer, rezulton se:

Bashkia Libohovë ka vijuar me zbatimin e Planit të Integritetit, duke arritur një nivel të mirë realizimi prej 69% të masave të planifikuara për vitin 2025 (në intervalin 60-80%). Gjatë kësaj periudhe janë arritur rezultate në drejtim të:

- Ngritjes së kulturës së integritetit dhe llogaridhënies në bashki;
- Trajnimeve dhe aktiviteteve që mbështesin etikën institucionale;
- Trajnimit dhe zhvillimit të burimeve njerëzore;
- Plotësimit të Programit të Transparencës, etj.

Masat dhe aktivitetet e realizuara në kuadër të zbatimit të Planit të Integritetit kanë ndikuar në rritjen e shkallës së kulturës së integritetit institucional. Si rezultat, janë hartuar disa dokumente strategjike mbi etikën në aspekte të punës dhe të shërbimeve të ofruara, si dhe instrumente për raportimin e korrupsionit apo shkeljeve të tjera, të cilat janë bërë të aksesueshme online në adresën zyrtare të bashkisë.

Rekomandime

- Të vijojë puna lidhur me zbatimin e masave/aktiviteteve të Planit të Integritetit;
- Të njihet personeli i bashkisë me ndryshimet e fundit ligjore të paketës antikorrupsion, si dhe të hartohet dhe miratohet rregullorja për konfliktin e interesit, në përputhje me ndryshimet e fundit ligjore;
- Sigurimi i një raportimi periodik transparent, përmes publikimit të raporteve 6-mujore mbi zbatimin e Planit të Integritetit;
- Trajnimi në vijimësi i Koordinatorit të Integritetit të bashkisë.



RAPORT MONITORIMI

mbi Realizimin e Planeve të Integritetit
të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore

BASHKIA LIBRAZHID

për periudhën
Janar – Dhjetor 2025

Monitorimi i zbatueshmërisë të Planit të Integritetit për vitin 2025

Raporti i Monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit të **Bashkisë Librazhd** për vitin 2025 përbën dokumentin e parë të monitorimit të planit të veprimit të Planit të Integritetit të bashkisë.

Plani i Integritetit është konceptuar për t'u zbatuar përgjatë një periudhe katërvjeçare, konkretisht 2025-2028.

Në Planin e Integritetit të bashkisë janë përcaktuar gjithsej tre objektiva, për të cilat janë parashikuar fushat me risk, si dhe janë planifikuar masat dhe aktivitetet për realizimin e tyre, si vijon:

- **Objektivi I** - Përmirësimi i kuadrit rregullator dhe institucional, me qëllim forcimin e etikës dhe integritetit të institucionit;
- **Objektivi II** - Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe zhvillimi profesional i punonjësve të bashkisë;
- **Objektivi III** - Përmirësimi i transparencës dhe llogaridhënies së bashkisë;

Për bashkinë Librazhd, Plani i Integritetit për periudhën janar-dhjetor 2025, referuar Planit të Veprimit, përmban masa dhe aktivitete të planifikuara vetëm për Objektivin I, të përcaktuara në Planin e Veprimit.

Situata e monitorimit të Planit të Integritetit të Bashkisë Librazhd për periudhën janar–dhjetor 2025



Nga procesi i monitorimit rezulton se, në totalin prej 3 masash (aktivitetesh) të parashikuara për zbatim për vitin 2025, në kuadër të Objektivit I:

- 2 masa/aktivitete janë realizuar plotësisht, që përfaqëson 67% të totalit
- 0 masa/aktivitete janë në proces realizimi, ose 0%
- 1 masë/aktivitet mbetet e përealizuar, ose 33%

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun vijues.

Tabela 1. Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Bashkia Librazhd	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të përealizuara
Numri i masave / aktiviteteve	3	2	0	1

Figura 1. Zbatimi i Planit të Integritetit, 2025 (%)**Figura 2. Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025**

Bashkia Librazhd, gjatë vitit 2025, ka bërë hapa në drejtim të forcimit të qeverisjes së mirë dhe integritetit institucional. Në këtë kuadër, ka hartuar dhe miratuar disa dokumente strategjike që adresojnë forcimin e etikës dhe integritetit, përmirësimin e funksionimit të strukturave vendore antikorrupsion, si dhe konsolidimin e kuadrit të brendshëm institucional.

Gjetjet e Raportit

Objektivi I - Përmirësimi i kuadrit rregullator dhe institucional, me qëllim forcimin e etikës dhe integritetit të institucionit

Ky objektivi synon forcimin e kuadrit të brendshëm rregullator për etikën dhe integritetin, në përputhje me kornizën ligjore për vetëqeverisjen vendore, të drejtën e informimit, konsultimin publik, menaxhimin dhe kontrollin financiar, sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesit, parandalimin e konfliktit të interesit, etj.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objekti, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 3 masa/aktivitete, nga të cilat:


- Janë realizuar 2 masa/aktivitete ose 67%
- Janë në proces realizimi 0 masa/aktivitete ose 0%
- Nuk është realizuar 1 masë/aktivitet ose 33%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 2. Objekti I - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objekti I	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuar
Përmirësimi i Kuadrit Rregullator	3	2	0	1

Figura 3. Objekti I - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektiv është realizuar në masën 67%, me zbatimin e masave/aktiviteteve si më poshtë:

- Rishikimi i Kodit të Etikës së Bashkisë Librazhd, në përputhje me ndryshimet e kuadrit rregullator për etikën në Shqipëri, si dhe me Manualin e DAP-it;
- Informimi i stafit të bashkisë mbi përmbajtjen e tij.

Konkluzione

Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi për periudhën raportuese janar-dhjetor 2025, bazuar në gjetjet që ky dokument ofron, të dhënat analitike të raportuara nga drejtoritë përkatëse dhe analizën e kryer, rezulton se:

Bashkia Librazhd ka vijuar me zbatimin e Planit të Integritetit, me një nivel realizimi, vetëm për Objektivin I sipas Planit të Veprimit, prej 67% të masave të planifikuara për vitin 2025 (në intervalin 60-80%).

Gjatë kësaj periudhe janë arritur rezultate në:

- Ngritjen e kulturës së integritetit në bashki.

Masat dhe aktivitetet e realizuara në kuadër të zbatimit të Planit të Integritetit kanë ndikuar në rritjen e shkallës së kulturës së integritetit institucional.

Rekomandime

- Të vijojë puna për realizimin e masave dhe aktiviteteve të planifikuara në Planin e Integritetit;
- Të vijojë puna për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies publike të bashkisë;
- Forcimi i koordinimit dhe bashkëpunimit ndërmjet drejtorive, për një raportim më të rregullt mbi masat e Planit të Integritetit;
- Sigurimi i një raportimi periodik transparent, përmes publikimit të raporteve 6-mujore mbi zbatimin e Planit të Integritetit.



RAPORT MONITORIMI

mbi Realizimin e Planeve të Integritetit
të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore

BASHKIA LUSHNJË

për periudhën
Janar – Dhjetor 2025

Monitorimi i zbatueshmërisë të Planit të Integritetit për vitin 2025

Raporti i Monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit të **Bashkisë Lushnjë** për vitin 2025 përbën dokumentin e dytë të monitorimit të planit të veprimit të Planit të Integritetit të bashkisë.

Plani i Integritetit është konceptuar për t'u zbatuar përgjatë një periudhe katërvjeçare, konkretisht 2025-2028.

Në Planin e Integritetit të bashkisë janë përcaktuar gjithsej katër objektiva, për të cilat janë parashikuar fushat me risk, si dhe janë planifikuar masat dhe aktivitetet për realizimin e tyre, si vijon:

- **Objektivi I** - Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit;
- **Objektivi II** - Menaxhimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore në bashki, për identifikimin dhe parandalimin e risqeve të integritetit;
- **Objektivi III** - Rritja e transparencës dhe ndërveprimit me publikun;
- **Objektivi IV** - Menaxhimi i riskut të integritetit në fusha të veçanta të përgjegjësisë së bashkisë.

Për bashkinë Lushnje, Plani i Integritetit për periudhën janar-dhjetor 2025, referuar Planit të Veprimit, përmban masa dhe aktivitete të planifikuara sipas objektivave të përcaktuara në Planin e Veprimit.

Situata e monitorimit të Planit të Integritetit të Bashkisë Lushnje për periudhën janar–dhjetor 2025



Nga procesi i monitorimit rezulton se, në totalin prej 50 masash (aktivitetesh) të parashikuara për zbatim për vitin 2025:

- 35 masa/aktivitete janë realizuar plotësisht, që përfaqëson 70% të totalit
- 4 masa/aktivitete janë në proces realizimi, ose 8%
- 11 masa/aktivitete mbeten të porealizuara, ose 22%

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun vijues.

Tabela 1. Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Bashkia Lushnje	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të porealizuara
Numri i masave / aktiviteteve	50	35	4	11

Figura 1. Zbatimi i Planit të Integritetit, 2025 (%)**Figura 2. Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025**

Sa më sipër, gjatë vitit 2025, Bashkia Lushnje ka ndërmarrë një sërë hapash në drejtim të forcimit të qeverisjes së mirë dhe integritetit institucional. Në këtë kuadër, janë hartuar dhe miratuar disa dokumente strategjike që adresojnë forcimin e etikës dhe integritetit, përmirësimin e funksionimit të strukturave vendore antikorrupsion, konsolidimin e kuadrit të brendshëm institucional, zhvillimin dhe fuqizimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore, rritjen e rezistencës institucionale ndaj risqeve të integritetit, si dhe përmirësimin e transparencës dhe të besueshmërisë publike.

Gjetjet e Raportit

Objektivi I - Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit

Ky objektivi synon forcimin e kuadrit të brendshëm rregullator për etikën dhe integritetin, në përputhje me kornizën ligjore për vetëqeverisjen vendore, të drejtën e informimit, konsultimin publik, menaxhimin dhe kontrollin financiar, sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesit, parandalimin e konfliktit të interesit, etj.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objektivi, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 3 masa/aktivitete, nga të cilat:


- Janë realizuar 2 masa/aktivitete ose 67%
- Është në proces realizimi 1 masë/aktivitet ose 33%
- Nuk janë realizuar 0 masa/aktivitete ose 0%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 2. Objektivi I - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objektivi I	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Forcimi i Kuadrit Rregullator	3	2	1	0

Figura 3. Objektivi I - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektivi është realizuar në masën 67%, me zbatimin e masave/aktiviteteve si më poshtë:

- Hartimi i udhëzuesve të brendshëm për parandalimin e konfliktit të interesit dhe sjelljen etike në vendin e punës;
- Trajnime vjetore për stafin mbi etikën, integritetin dhe konfliktin e interesit.

Objektivi II - Menaxhimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore në bashki, për identifikimin dhe parandalimin e risqeve të integritetit

Ky objektivi synon të forcojë mekanizmat që lidhen me garantimin e integritetit duke përmirësuar menaxhimin dhe kapacitetet e burimeve njerëzore të bashkisë. Nëpërmjet përmirësimit të proceseve të menaxhimit të burimeve njerëzore në institucion, do të sigurohen kapacitetet dhe aftësitë e nevojshme për zbatimin dhe konsolidimin e mekanizmave garantues të integritetit në institucion, me qëllim rritjen e profesionalizimit të personelit dhe zhvillimin në karrierë të zyrtarëve, në përputhje me performancën e tyre në punë.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objektivi, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 9 masa/aktivitete, nga të cilat:


- Janë realizuar 6 masa/aktivitete ose 66%
- Është në proces realizimi 1 masë/aktivitet ose 11%
- Nuk janë realizuar 2 masa/aktivitete ose 23%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 3. Objektivi II - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objektivi II	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Fuqizimi i Burimeve Njerëzore	9	6	1	2

Figura 4. Objektivi II - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektivi është realizuar në masën 66%, me zbatimin e masave/aktiviteteve si më poshtë:

- Përcaktimi i një zëri specifik në buxhetin e vitit 2026, për trajnime të pavarura profesionale për integritet, etikë dhe menaxhim;
- Hartimi i një mekanizmi për shpërblyeme jofinanciare (vlerësime, promovim, pjesëmarrje në projekte) për stafin me performancë të lartë;

- Zbatimi i trajnimeve praktike në terren për drejtoritë dhe njësitë administrative, mbi PBA-në dhe procesin e programimit buxhetor me fokus në rezultate;
- Hartimi dhe miratimi i një protokolli standard për arkivimin e komunikimeve elektronike me rëndësi;
- Formalizimi i bashkëpunimit me NJVR-të, përmes marrëveshjes institucionale dhe trajnimeve të përbashkëta;
- Rishikimi dhe përmirësimi i faqes së internetit, për aksesueshmëri, qartësi dhe përditësim automatik të rubrikave të transparencës.

Objektivi III - Rritja e transparencës dhe ndërveprimit me publikun

Transparenca e bashkisë gjatë procesit të zbatimit të politikave vendore është shumë e rëndësishme për rritjen e pjesëmarrjes së aktorëve të ndryshëm në veprimtarinë e bashkisë dhe të publikut në tërësi. Në këtë kuadër, është me rëndësi edhe siguri i pjesëmarrjes së publikut në procesin e identifikimit të prioritetëve strategjike afatgjata. Për këtë arsye, bashkia angazhohet të forcojë mekanizmat e pjesëmarrjes për shoqërinë civile dhe grupe të veçanta të interesit, gjatë hartimit dhe konsultimit të dokumenteve të politikave të ndryshme vendore.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objektivi, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 5 masa/aktivitete, nga të cilat:


- Janë realizuar 5 masa/aktivitete ose 100%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 4. Objektivi III - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objektivi III	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Forcimi i Transparencës dhe Llogaridhënies	5	5	0	0

Figura 5. Objektivi III - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektiv është realizuar në masën 100%, me zbatimin e masave/aktiviteteve si më poshtë:

- Përmirësimi i strukturës dhe përmbajtjes së faqes zyrtare të bashkisë, për të përmbushur standardet e transparencës proaktive;
- Zbatimi i një kalendari vjetor për dëgjuesat publike dhe konsultimet me grupet e interesit;
- Krijimi i një mekanizmi online për mbledhjen e komenteve dhe sugjerimeve nga publiku, për draft-vendimet;
- Zbatimi i një programi informimi për qytetarët mbi të drejtat e tyre për akses në informacion;
- Krijimi i një seksioni “Pyetje & Përgjigje” në faqen zyrtare, me temat më të shpeshta të interesit publik.

Objektivi IV - Menaxhimi i riskut të integritetit në fusha të veçanta të përgjegjësisë së bashkisë

Nëpërmjet këtij objektivi synohet menaxhimi i riskut të integritetit në fushat kryesore të përgjegjësisë së bashkisë, duke u fokusuar në proceset e punës të vlerësuara si më të ekspozuarat ndaj rrezikut të korrupsionit. Në tërësinë e tij, menaxhimi i integritetit i Bashkisë Lushnje paraqet sfida, të cilat janë parashikuar edhe në Planin e Veprimit 2025-2028 të Strategjisë për Qeverisjen Vendore, dhe që hasen më së shumti në fusha të veçanta të përgjegjësisë, të tilla si fusha e menaxhimit financiar, menaxhimi i pronave të bashkisë, shërbimet publike dhe arkivimi.


Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objektivi, për vitin 2025 janë planifikuar për t’u realizuar gjithsej 33 masa/aktivitete, nga të cilat:

- Janë realizuar 22 masa/aktivitete ose 67%
- Janë në proces realizimi 2 masa/aktivitete ose 6%
- Nuk janë realizuar 9 masa/aktivitete ose 27%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 5. Objektivi IV - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objektivi IV	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Fusha të Veçanta	33	22	2	9

Figura 6. Objektivi IV - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit

Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektivi është realizuar në masën 67%, me zbatimin e masave/aktiviteteve si më poshtë:

- Fuqizimi i mbikëqyrjes së procedurave përmes listave të kontrollit (formular vlerësimi);
- Trajnime të detyrueshme vjetore për njësinë e prokurimit mbi integritetin;
- Publikimi i rregullt i të dhënave për administrimin e pronave;
- Rritja e kontrollit mbi mbledhjen e detyrimeve fiskale;
- Trajnime për stafin mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- Trajnime për stafin mbi shmangien e konfliktit të interesit;
- Rishikimi i kriterëve dhe transparencës për përfitimet sociale;
- Mbikëqyrje mbi shpërndarjen e ndihmës ekonomike dhe shërbimeve për grupet në nevojë;
- Bashkëpunim i vazhdueshëm me NJVR-të dhe institucione partnere;
- Krijimi i një mekanizmi online për komente të qytetarëve mbi projekt-vendimet;
- Raportim tremujor mbi dëgjesat dhe pjesëmarrjen qytetare;
- Trajnimi i stafit për përdorimin e sistemit;
- Përfshirja e burimeve njerëzore dhe buxhetore në planin vjetor;
- Udhëzime dhe kontrole periodike për përdorimin zyrtar të postës elektronike;
- Sigurimi i kopjeve rezervë (backup) dhe arkivimit të komunikimeve;
- Përgatitja e një dokumenti të rishikuar dhe trajnimi i stafit;
- Organizimi i trajnimeve për punonjësit e bashkisë;
- Hartimi, shpërndarja dhe analiza e një pyetësoi anonim për perceptimin e integritetit;
- Postera, broshura, postime dhe takime publike për integritetin në administratë;
- Auditim vjetor i brendshëm për identifikimin e zonave me risk;
- Përditësimi i planit në bazë të gjetjeve të auditit ose vlerësimeve të reja;
- Përgatitja dhe publikimi i raportit për transparencën publike.

Konkluzione

Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi për periudhën raportuese janar-dhjetor 2025, bazuar në gjetjet që ky dokument ofron, të dhënat analitike të raportuara nga drejtoritë përkatëse dhe analizën e kryer, rezulton se:

Bashkia Lushnje ka vijuar me zbatimin e Planit të Integritetit, duke arritur një nivel të mirë realizimi prej 70% të masave të planifikuara për vitin 2025 (në intervalin 60-80%). Gjatë kësaj periudhe janë arritur rezultate të mira në drejtim të:

- Ngritjes së kulturës së integritetit dhe llogaridhënies në bashki;
- Transparencës më të lartë në publikimin e informacioneve;
- Trajnimeve dhe aktiviteteve që mbështesin etikën institucionale;
- Modernizimit të administratës përmes digjitalizimit të dokumentacionit;

Masat dhe aktivitetet e realizuara në kuadër të zbatimit të Planit të Integritetit kanë ndikuar ndjeshëm në rritjen e shkallës së transparencës së institucionit. Si rezultat, një sërë dokumentesh strategjike, aspekte të punës dhe të shërbimeve të ofruara, rezultatet e kontrolleve financiare, si dhe instrumentet për raportimin e korrupsionit apo shkeljeve të tjera, janë bërë të aksesueshme online në adresën zyrtare të bashkisë. Ky progres e ka renditur këtë objektiv në vend të parë, duke e pozicionuar bashkinë në një nivel proaktiv të transparencës.

Rekomandime

- Të vijojë puna për zbatimin e masave/aktiviteteve të planit të veprimit të Planit të Integritetit;
- Forcimi i koordinimit dhe bashkëpunimit ndërmjet drejtorive, për një raportim më të rregullt mbi masat e Planit të Integritetit;
- Sigurimi i një raportimi periodik transparent, përmes publikimit të raporteve 6-mujore mbi zbatimin e Planit të Integritetit;
- Trajnimi në vijimësi i Koordinatorit të Integritetit të bashkisë.



RAPORT MONITORIMI

mbi Realizimin e Planeve të Integritetit
të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore

BASHKIA MALIQ

për periudhën
Janar – Dhjetor 2025

Monitorimi i zbatueshmërisë të Planit të Integritetit për vitin 2025

Raporti i Monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit të **Bashkisë Maliq** për vitin 2025 përbën dokumentin e katërt të monitorimit të planit të veprimit të Planit të Integritetit të bashkisë.

Plani i Integritetit është konceptuar për t'u zbatuar përgjatë një periudhe katërvjeçare, konkretisht 2022-2025.

Në Planin e Integritetit të bashkisë janë përcaktuar gjithsej tre objektiva, për të cilat janë parashikuar fushat me risk, si dhe janë planifikuar masat dhe aktivitetet për realizimin e tyre, si vijon:

- **Objektivi I** - Përmirësimi i mekanizmave rregullatorë dhe strategjikë të bashkisë në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit;
- **Objektivi II** - Konsolidimi i një administrate të qëndrueshme dhe profesionale nëpërmjet zhvillimit të burimeve njerëzore në bashki;
- **Objektivi III** - Rritja e efektivitetit të veprimtarisë së bashkisë nëpërmjet menaxhimit të riskut të integritetit në fusha të veçanta të përgjegjësisë.

Për bashkinë Maliq, Plani i Integritetit për periudhën janar-dhjetor 2025, referuar Planit të Veprimit, përmban masa dhe aktivitete të planifikuara në vijimësi, vetëm në kuadër të Objektivit II dhe III.

Situata e monitorimit të Planit të Integritetit të Bashkisë Maliq për periudhën janar–dhjetor 2025



Nga procesi i monitorimit rezulton se, në totalin prej 7 masash (aktivitetesh) të parashikuara në vijimësi për zbatim për vitin 2025:

- 4 masa/aktivitete janë realizuar plotësisht, që përfaqëson 57% të totalit
- 2 masa/aktivitete janë në proces realizimi, ose 28%
- 1 masë/aktivitet mbetet e përealizuar, ose 15%

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun vijues.

Tabela 1. Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Bashkia Maliq	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të përealizuara
Numri i masave / aktiviteteve	7	4	2	1

Figura 1. Zbatimi i Planit të Integritetit, 2025 (%)**Figura 2. Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025**

Sa më sipër, gjatë vitit 2025, Bashkia Maliq ka vijuar me zbatimin e masave në vijimësi, në drejtim të forcimit të qeverisjes së mirë dhe integritetit institucional. Në këtë kuadër, janë hartuar dhe miratuar disa dokumente strategjike që adresojnë konsolidimin e një administrate të qëndrueshme dhe profesionale, nëpërmjet zhvillimit të burimeve njerëzore në bashki, për rritjen e rezistencës institucionale ndaj risqeve të integritetit.

Gjetjet e Raportit

Objektivi II - Konsolidimi i një administrate të qëndrueshme dhe profesionale nëpërmjet zhvillimit të burimeve njerëzore në bashki

Ky objektivi synon konsolidimin e një administrate të qëndrueshme dhe profesionale, nëpërmjet përmirësimit të proceseve të menaxhimit të burimeve njerëzore. Objektivi përfshin ndërmarrjen

e masave/aktiviteteve që synojnë përmirësimin e kapaciteteve teknike dhe njerëzore të bashkisë, duke adresuar nevojat specifike profesionale të personelit.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objekti, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar në vijimësi gjithsej 6 masa/aktivitete, nga të cilat:


- Janë realizuar 4 masa/aktivitete ose 67%
- Janë në proces realizimi 2 masa/aktivitete ose 33%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 2. Objekti II - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objekti II	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Fuqizimi i Burimeve Njerëzore	6	4	2	0

Figura 3. Objekti II - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Për periudhën raportuese janar-dhjetor 2025, bashkia ka realizuar masat dhe aktivitetet si më poshtë:

- Publikimi i kriterëve të sakta për çdo vakancë, për pozicionet e punës që shpallen nga bashkia;
- Realizimi i procedurave rekrutuese të rregullta, në përputhje me kriteret dhe përshkrimin e punës;
- Përcaktimi në rregulloren e brendshme i detyrimit për hartimin e Planit të Brendshëm Vjetor të Trajnimeve;
- Hartimi i Planit të Brendshëm të Trajnimeve dhe Analizës së Performancës, çdo vit.

Objektivi III - Rritja e efektivitetit të veprimtarisë së bashkisë nëpërmjet menaxhimit të riskut të integritetit në fusha të veçanta të përgjegjësisë

Ky objektivi synon menaxhimin e riskut të integritetit institucional në fusha të veçanta të përgjegjësisë: menaxhimi financiar, auditimi i brendshëm dhe kontrolli, shërbimet publike, transparencë, administrimi i pronave dhe menaxhimi i territorit, arkivimi i dokumenteve. Masat e parashikuara nën këtë objektivi kanë për qëllim reduktimin ose eliminimin e risqeve të identifikuara në këto fusha.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objektivi, për vitin 2025 është planifikuar për t'u realizuar gjithsej 1 masë/aktivitet, e cila:


- Nuk është realizuar, ose 0%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 3. Objektivi III - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objektivi III	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Fusha të Veçanta	1	0	0	1

Figura 4. Objektivi III - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektivi nuk është realizuar.

Konkluzione

Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi për periudhën raportuese janar-dhjetor 2025, bazuar në gjetjet që ky dokument ofron, të dhënat analitike të raportuara nga drejtoritë përkatëse dhe analizën e kryer, rezulton se:

Bashkia Maliq ka vijuar me zbatimin e Planit të Integritetit, duke arritur një nivel mesatar realizimi prej 57% të masave të planifikuara për vitin 2025 (në intervalin 40-60%). Gjatë kësaj periudhe janë arritur rezultate në vijimësi në drejtim të:

- Zhvillimit të burimeve njerëzore, ku realizimi i masave/aktiviteteve si publikimi i kriterëve të punësimit, përshkrimet e pozicioneve dhe rregullimi i trajnimeve kanë kontribuar në një administratë më të drejtë, profesionale dhe me më pak hapësira për ndërhyrje arbitrare, duke konsoliduar parimet e meritokracisë dhe përgjegjshmërisë;
- Trajnimit dhe planifikimit të tij të bazuar në performancë, si dhe hartimit të planeve vjetore të trajnimeve, çka ka sjellë zhvillimin e burimeve njerëzore si një element të rëndësishëm që ndikon në rritjen e integritetit institucional.

Rekomandime

- Të vijojë realizimi i masave/aktiviteteve të planifikuara në Planin e ri vijues të Integritetit;
- Forcimi i koordinimit dhe bashkëpunimit ndërmjet drejtorive, për një raportim më të rregullt mbi masat e Planit të Integritetit;
- Trajnimi në vijimësi i Koordinatorit të Integritetit të bashkisë.



RAPORT MONITORIMI

mbi Realizimin e Planeve të Integritetit
të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore

BASHKIA MALËSI E MADHE

për periudhën
Janar – Dhjetor 2025

Monitorimi i zbatueshmërisë të Planit të Integritetit për vitin 2025

Raporti i Monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit të **Bashkisë Malësi e Madhe** për vitin 2025 përbën dokumentin e parë të monitorimit të planit të veprimit të Planit të Integritetit të bashkisë.

Plani i Integritetit është konceptuar për t'u zbatuar përgjatë një periudhe trevjeçare, konkretisht 2025-2027.

Në Planin e Integritetit të bashkisë janë përcaktuar gjithsej tre objektiva, për të cilat janë parashikuar fushat me risk, si dhe janë planifikuar masat dhe aktivitetet për realizimin e tyre, si vijon:

- **Objektivi I** - Përmirësimi i kuadrit të brendshëm politik dhe rregullator, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, si dhe parimeve të etikës dhe standardeve të sjelljes profesionale;
- **Objektivi II** - Konsolidimi i burimeve njerëzore, strukturave antikorruption dhe pozicioneve të punës në bashki, të lidhura me funksionimin e mekanizmave të integritetit në institucion;
- **Objektivi III** - Përmirësimi i menaxhimit të riskut të integritetit për fusha të veçanta të përgjegjësisë së bashkisë.

Për bashkinë Malësi e Madhe, Plani i Integritetit për periudhën janar-dhjetor 2025, referuar Planit të Veprimit, përmban masa dhe aktivitete të planifikuara sipas objektivave të përcaktuara në Planin e Veprimit.

Situata e monitorimit të Planit të Integritetit të Bashkisë Malësi e Madhe për periudhën janar–dhjetor 2025



Nga procesi i monitorimit rezulton se, në totalin prej 79 masash (aktivitetesh) të parashikuara për zbatim për vitin 2025:

- 21 masa/aktivitete janë realizuar plotësisht, që përfaqëson 27% të totalit
- 3 masa/aktivitete janë në proces realizimi, ose 3%
- 55 masa/aktivitete mbeten të porealizuara, ose 70%

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun vijues.

Tabela 1. Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Bashkia Malësi e Madhe	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të porealizuara
Numri i masave / aktiviteteve	79	21	3	55

Figura 1. Zbatimi i Planit të Integritetit, 2025 (%)**Figura 2. Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025**

Bashkia Malësi e Madhe, gjatë vitit 2025, ka ndërmarrë disa hapa fillestare në drejtim të forcimit të qeverisjes së mirë dhe integritetit institucional. Në këtë kuadër, ka hartuar dhe miratuar disa dokumente strategjike që adresojnë forcimin e etikës dhe integritetit, përmirësimin e funksionimit të strukturave vendore antikorrupsion, konsolidimin e kuadrit të brendshëm institucional, zhvillimin dhe fuqizimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore, rritjen e rezistencës institucionale ndaj risqeve të integritetit, si dhe përmirësimin e transparencës dhe besueshmërisë publike.

Gjetjet e Raportit

Objektivi I - Përmirësimi i kuadrit të brendshëm politik dhe rregullator, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, si dhe parimeve të etikës dhe standardeve të sjelljes profesionale

Ky objektiv synon forcimin e kuadrit të brendshëm rregullator për etikën dhe integritetin, në përputhje me kornizën ligjore për vetëqeverisjen vendore, të drejtën e informimit, konsultimin publik, menaxhimin dhe kontrollin financiar, sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesit, parandalimin e konfliktit të interesit, etj.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objektivi, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 42 masa/aktivitete, nga të cilat:


- Janë realizuar 10 masa/aktivitete ose 24%
- Është në proces realizimi 1 masë/aktivitet ose 2%
- Nuk janë realizuar 31 masa/aktivitete ose 74%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 2. Objektivi I - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objektivi I	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Forcimi i Kuadrit Rregullator	42	10	1	31

Figura 3. Objektivi I - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektiv është realizuar në masën 24%, me zbatimin e masave/aktiviteteve si më poshtë:

- Publikimi i urdhrat të Kryetarit të bashkisë për ngritjen dhe funksionimin e njësisë së prokurimit në Bashkinë Malësi e Madhe;
- Informimi i stafit të bashkisë për funksionimin e kësaj njësie në bashki;
- Hartimi, miratimi dhe publikimi i politikës së institucionit për mbrojtjen e të dhënave personale;

- Hartimi dhe miratimi i PSV-ve për shërbimet publike që ofron bashkia, për dhënien e hapësirës publike për shërbimin e parkimit dhe transportit;
- Informimi i stafit të bashkisë për përmbajtjen e tyre;
- Parashikimi në rregulloren e KB-së i mundësisë së realizimit të mbledhjeve online në raste emergjencash, si ai i shkaktuar nga pandemia e COVID-19;
- Komunikim periodik për korrespondencën elektronike brenda bashkisë dhe me institucionet e tjera, nëpërmjet postës elektronike zyrtare;
- Ngritja e Regjistrat për Konfliktin e Interesit në bashki;
- Trajnime për personelin e bashkisë dhe anëtarët e KB-së;
- Informimi i personelit për rregulloren e konfliktit të interesit në bashki.

Objektivi II - Konsolidimi i burimeve njerëzore, strukturave antikorruption dhe pozicioneve të punës në bashki, të lidhura me funksionimin e mekanizmave të integritetit në institucion

Ky objektivi synon të forcojë mekanizmat që lidhen me garantimin e integritetit duke përmirësuar menaxhimin dhe kapacitetet e burimeve njerëzore të bashkisë. Nëpërmjet përmirësimit të proceseve të menaxhimit të burimeve njerëzore në institucion, do të sigurohen kapacitetet dhe aftësitë e nevojshme për zbatimin dhe konsolidimin e mekanizmave garantues të integritetit në institucion, me qëllim rritjen e profesionalizimit të personelit dhe zhvillimin në karrierë të zyrtarëve, në përputhje me performancën e tyre në punë.


Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objektivi, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 20 masa/aktivitete, nga të cilat:

- Janë realizuar 5 masa/aktivitete ose 25%
- Janë në proces realizimi 2 masa/aktivitete ose 10%
- Nuk janë realizuar 13 masa/aktivitete ose 65%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 3. Objektivi II - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objektivi II	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të përealizuara
Fuqizimi i Burimeve Njerëzore	20	5	2	13

Figura 4. Objektivi II - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit

Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektivi është realizuar në masën 25%, me zbatimin e masave/aktiviteteve si më poshtë:

- Realizimi i trajnimeve të dedikuara për stafin e njësisë së auditit, mbi përditësimet ligjore në fushën e auditimit (p.sh. auditimi i faturave fiskale etj.);
- Vlerësimi i nevojave për vende pune shtesë, me qëllim përfshirjen e inxhinierëve dhe ekonomistëve;
- Përcaktimi i roleve dhe përgjegjësisë për punonjësit që do të menaxhojnë dosjet e personelit në sistemin e centralizuar, si dhe reflektimi i roleve dhe përgjegjësisë në sistemin nëpërmjet të drejtave “read” dhe “edit”;
- Krijimi i një plani pune me afate të vendosura, për ndjekjen dhe minimizimin e vonësive të pajustificuara;
- Parashikimi në Rregulloren e Këshillit Bashkiak i detyrimit për rakordimin e dokumenteve buxhetore të miratuara në KB, me projektbuxhetin e miratuar nga bashkia.

Objektivi III - Përmirësimi i menaxhimit të riskut të integritetit për fusha të veçanta të përgjegjësisë së bashkisë

Ky objektivi synon adresimin e risqeve të integritetit në fushat funksionale të përgjegjësisë së bashkisë. Masat e parashikuara synojnë të përmirësojnë efektivitetin, eficiencën dhe cilësinë e proceseve të punës në fushat funksionale të bashkisë, me qëllim përmirësimin e shërbimeve publike, planifikimin e territorit, menaxhimin e pronave dhe aseteve publike, menaxhimin financiar, etj.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objektivi, për vitin 2025 janë planifikuar për t’u realizuar gjithsej 17 masa/aktivitete, nga të cilat:


- Janë realizuar 6 masa/aktivitete ose 35%
- Janë në proces realizimi 0 masa/aktivitete ose 0%
- Nuk janë realizuar 11 masa/aktivitete ose 65%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 4. Objektivi III - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objektivi III	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Fusha të Vecanta	17	6	0	11

Figura 5. Objektivi III - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektivi është realizuar në masën 35%, me zbatimin e masave/aktiviteteve si më poshtë:

- Konsultimi me grupet e interesit mbi kostot dhe përfitimet e paketës fiskale, para miratimit të paketës fiskale;
- Publikimi i paketës fiskale në faqen e internetit të bashkisë;
- Informimi dhe aksesimi mbi paketën fiskale, pranë zyrave të bashkisë;
- Informimi i publikut (në faqen zyrtare të bashkisë) mbi masat ndëshkuese lidhur me moszbatimin e detyrimeve (përfshirë edhe afatet);
- Rikujtesë periodike e punonjësve mbi funksionin dhe kontaktin e sinjalizuesit;
- Hartimi, miratimi dhe publikimi i instrumenteve monitoruese të performancës së shërbimit.

Konkluzione

Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi për periudhën raportuese janar-dhjetor 2025, bazuar në gjetjet që ky dokument ofron, të dhënat analitike të raportuara nga drejtoritë përkatëse dhe analizën e kryer, rezulton se:

Bashkia Malësi e Madhe ka vijuar me zbatimin e Planit të Integritetit, duke arritur një nivel minimal realizimi prej 27% të masave të planifikuara për vitin 2025. Duhet theksuar se, gjatë hartimit të Planit të Integritetit nga Grupi i Punës, nuk është bërë si duhet planifikimi i shpërndarjes së masave dhe aktiviteteve në 3 vite (afatmesme), ashtu siç e parashikon vlerësimi i riskut të integritetit për bashkinë, por të gjitha masat/aktivitetet janë planifikuar për t'u realizuar brenda vitit 2025.

Sa më sipër, pavarësisht se bashkia ka arritur rezultate në objektivat e planifikuara, me masat dhe aktivitetet e realizuara si:

- Ngritjen e kulturës së integritetit dhe llogaridhënies në bashki;
- Transparencë më të lartë në publikimin e informacioneve;
- Trajnime dhe aktivitete që mbështesin etikën institucionale;
- Modernizimin e administratës përmes digjitalizimit të dokumentacionit.

Ky progres realisht nuk përcillet ende në rezultatin final të nivelit të realizimit.

Rekomandime

- Të rishikohet edhe një herë vlerësimi i riskut të integritetit dhe të planifikohet realizimi i masave/aktiviteteve brenda periudhës për të cilën është hartuar plani 2025-2027, dhe jo brenda një viti të vetëm;
- Forcimi i koordinimit dhe bashkëpunimit ndërmjet drejtorive, për një raportim më të rregullt mbi masat e Planit të Integritetit;
- Sigurimi i një raportimi periodik transparent, përmes publikimit të raporteve 6-mujore mbi zbatimin e Planit të Integritetit;
- Trajnimi në vijimësi i Koordinatorit të Integritetit të bashkisë.



RAPORT MONITORIMI

mbi Realizimin e Planeve të Integritetit
të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore

BASHKIA PATOS

për periudhën
Janar – Dhjetor 2025

Monitorimi i zbatueshmërisë të Planit të Integritetit për vitin 2025

Raporti i Monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit të **Bashkisë Patos** për vitin 2025 përbën dokumentin e parë të monitorimit të planit të veprimit të Planit të Integritetit të bashkisë.

Plani i Integritetit është konceptuar për t’u zbatuar përgjatë një periudhe trevjeçare, konkretisht 2025-2027.

Në Planin e Integritetit të bashkisë janë përcaktuar gjithsej tre objektiva, për të cilat janë parashikuar fushat me risk, si dhe janë planifikuar masat dhe aktivitetet për realizimin e tyre, si vijon:

- **Objektivi I** - Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit;
- **Objektivi II** - Menaxhimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore në bashki, për identifikimin dhe parandalimin e risqeve të integritetit;
- **Objektivi III** - Menaxhimi i riskut të integritetit në fusha të veçanta të përgjegjësisë së bashkisë.

Për bashkinë Patos, Plani i Integritetit për periudhën janar-dhjetor 2025, referuar Planit të Veprimit, përmban masa dhe aktivitete të planifikuara sipas objektivave të përcaktuara në Planin e Veprimit.

Situata e monitorimit të Planit të Integritetit të Bashkisë Patos për periudhën janar–dhjetor 2025



Nga procesi i monitorimit rezulton se, në totalin prej 18 masash (aktivitetesh) të parashikuara për zbatim për vitin 2025:

- 12 masa/aktivitete janë realizuar plotësisht, që përfaqëson 67% të totalit
- 6 masa/aktivitete mbeten të porealizuara, ose 33%

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun vijues.

Tabela 1. Shkalla e realizimit të masave/aktiviteve, 2025

Bashkia Patos	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të porealizuara
Numri i masave / aktiviteteve	18	12	0	6

Figura 1. Zbatimi i Planit të Integritetit, 2025 (%)**Figura 2. Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025**

Sa më sipër, gjatë vitit 2025, Bashkia Patos ka ndërmarrë një sërë hapash në drejtim të forcimit të qeverisjes së mirë dhe integritetit institucional. Në këtë kuadër, janë hartuar dhe miratuar disa dokumente strategjike që adresojnë forcimin e etikës dhe integritetit, përmirësimin e funksionimit të strukturave vendore antikorrupsion, konsolidimin e kuadrit të brendshëm institucional, zhvillimin dhe fuqizimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore, si dhe rritjen e rezistencës institucionale ndaj risqeve të integritetit.

Gjetjet e Raportit

Objektivi I - Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit

Ky objektivi synon forcimin e kuadrit rregullator në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit, duke shtuar dispozita të caktuara, kryesisht ato që lidhen me aspektet dhe çështjet e integritetit, përditësimit me ndryshimet më të fundit ligjore, rregullimit të funksioneve dhe detyrave të njësive në bashki, si edhe pasqyrimin të ndryshimeve që ka pësuar struktura institucionale.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objekti, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 11 masa/aktivitete, nga të cilat:


- Janë realizuar 7 masa/aktivitete ose 64%
- Nuk janë realizuar 4 masa/aktivitete ose 36%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 2. Objekti I - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objekti I	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Forcimi i Kuadrit Rregullator	11	7	0	4

Figura 3. Objekti I - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektiv është realizuar në masën 64%, me zbatimin e masave/aktiviteteve si më poshtë:

- Hartimi dhe miratimi i PSV-ve dhe rregullave të brendshme për disa prej proceseve kryesore, si: PSV për rekrutimin dhe procedurat e shpalljes së vendeve të lira;
- PSV për procedurën e zhvillimit të trajnimeve dhe përpilimin e planit vjetor të trajnimeve;
- PSV për administrimin e kontratave dhe detyrimeve financiare;
- PSV për hartimin dhe zbatimin e planit të masave për risket;
- PSV për auditimet e performancës;
- PSV për procedurën e mbledhjes së taksave dhe tarifave vendore;
- Organizimi i trajnimeve të brendshme për stafin e përfshirë në monitorimin e kontratave publike, për të siguruar njohje sa më të mirë të PSV-së së miratuar.

Objektivi II - Menaxhimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore në bashki, për identifikimin dhe parandalimin e risqeve të integritetit

Ky objektivi synon të përforcojë mirëfunksionimin e administratës së institucionit, nëpërmjet forcimit të kapaciteteve njerëzore, trajnimit dhe rekrutimit të stafit të nevojshëm në përputhje me strukturën dhe organikën, si dhe sanksionimit të procedurave të qarta për të gjitha proceset e punës në njësitë e bashkisë.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objektivi, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 4 masa/aktivitete, nga të cilat:


- Janë realizuar 3 masa/aktivitete ose 75%
- Nuk është realizuar 1 masë/aktivitet ose 25%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 3. Objektivi II - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objektivi II	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Fuqizimi i Burimeve Njerëzore	4	3	0	1

Figura 4. Objektivi II - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Për periudhën raportuese janar-dhjetor 2025, bashkia ka realizuar masat dhe aktivitetet si më poshtë:

- Trajnimi i vazhdueshëm i punonjësve mbi ndryshimet ligjore në fushën e prokurimit publik, në bashkëpunim me ASPA-n;
- Ofrimi i trajnimeve të personelit në këtë fushë;
- Shpallja e të gjitha vendeve të lira të punës jashtë shërbimit civil, në faqen zyrtare të bashkisë, dhe plotësimi i këtyre vendeve përmes Zyrës Vendore të Punësimit.

Objektivi III - Menaxhimi i riskut të integritetit në fusha të veçanta të përgjegjësisë së bashkisë

Ky objektivi synon menaxhimin e riskut të integritetit institucional në fusha të veçanta të përgjegjësisë: menaxhimi financiar, auditimi i brendshëm dhe kontrolli, shërbimet publike, transparenca, administrimi i pronave dhe menaxhimi i territorit, arkivimi i dokumenteve. Masat e parashikuara nën këtë objektivi kanë për qëllim reduktimin ose eliminimin e risqeve të identifikuara në këto fusha.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objektivi, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 3 masa/aktivitete, nga të cilat:


- Janë realizuar 2 masa/aktivitete ose 67%
- Nuk është realizuar 1 masë/aktivitet ose 33%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 4. Objektivi III - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objektivi III	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Fusha Të Veçanta	3	2	0	1

Figura 5. Objektivi III - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Për periudhën raportuese janar-dhjetor 2025, bashkia ka realizuar masat dhe aktivitetet si më poshtë:

- Konsultimi me grupet e interesit mbi përfitimet dhe kostot e paketës fiskale të propozuar;
- Përcaktimi i këtij detyrimi në rregulloren e brendshme të bashkisë.

Konkluzione

Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi për periudhën raportuese janar-dhjetor 2025, bazuar në gjetjet që ky dokument ofron, të dhënat analitike të raportuara nga drejtoritë përkatëse dhe analizën e kryer, rezulton se:

Bashkia Patos ka vijuar me zbatimin e Planit të Integritetit, duke arritur një nivel të mirë realizimi prej 67% të masave të planifikuara për vitin 2025 (në intervalin 60-80%). Gjatë kësaj periudhe janë arritur rezultate pozitive në:

- Rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore, përmes trajnimeve të fokusuara në etikë dhe konfliktin e interesit;
- Forcimin dhe menaxhimin e burimeve njerëzore;
- Forcimin e kuadrit të brendshëm rregullator, ku vërehet përmirësimi i kuadrit etik dhe rregullator brenda bashkisë, zhvillimi i trajnimeve në fushat e etikës, konfliktit të interesit dhe kontrollit të brendshëm, krijimi i mekanizmave për transparencë dhe llogaridhënie, si dhe nxitja e pjesëmarrjes së qytetarëve përmes kanaleve të komunikimit elektronik.

Rekomandime

- Zgjerimi i trajnimeve dhe fushatave ndërgjegjëse, me fokus në parandalimin e sjelljeve që cenojnë integritetin;
- Rritja e pjesëmarrjes qytetare dhe nxitja e sinjalizimit, përmes krijimit të kanaleve efektive dhe anonime për denoncime;
- Forcimi i koordinimit dhe bashkëpunimit ndërmjet drejtorive, për një raportim më të rregullt mbi masat e Planit të Integritetit;
- Sigurimi i një raportimi periodik transparent, përmes publikimit të raporteve 6-mujore mbi zbatimin e Planit të Integritetit;
- Trajnimi në vijimësi i Koordinatorit të Integritetit të bashkisë.



RAPORT MONITORIMI

mbi Realizimin e Planeve të Integritetit
të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore

BASHKIA PEQIN

për periudhën
Janar – Dhjetor 2025

Monitorimi i zbatueshmërisë të Planit të Integritetit për vitin 2025

Raporti i Monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit të Bashkisë Peqin për vitin 2025 përbën dokumentin e parë të monitorimit të planit të veprimit të Planit të Integritetit të bashkisë.

Plani i Integritetit është konceptuar për t'u zbatuar përgjatë një periudhe trevjeçare, konkretisht 2025-2027.

Në Planin e Integritetit të bashkisë janë përcaktuar gjithsej tre objektiva, për të cilat janë parashikuar fushat me risk, si dhe janë planifikuar masat dhe aktivitetet për realizimin e tyre, si vijon:

- **Objektivi I** - Përmirësimi i kuadrit të brendshëm rregullator në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit;
- **Objektivi II** - Menaxhimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore në bashki, për identifikimin dhe parandalimin e risqeve të integritetit;
- **Objektivi III** - Përmirësimi i transparencës dhe llogaridhënies së bashkisë;

Për bashkinë Peqin, Plani i Integritetit për periudhën janar-dhjetor 2025, referuar Planit të Veprimit, përmban masa dhe aktivitete të planifikuara sipas objektivave të përcaktuara në Planin e Veprimit.

Situata e monitorimit të Planit të Integritetit të Bashkisë Peqin për periudhën janar–dhjetor 2025



Nga procesi i monitorimit rezulton se, në totalin prej 36 masash (aktivitetesh) të parashikuara për zbatim për vitin 2025:

- 16 masa/aktivitete janë realizuar plotësisht, që përfaqëson 44% të totalit
- 0 masa/aktivitete janë në proces realizimi, ose 0%
- 20 masa/aktivitete mbeten të porealizuara, ose 56%

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun vijues.

Tabela 1. Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Bashkia Peqin	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të porealizuara
Numri i masave / aktiviteteve	36	16	0	20

Figura 1. Zbatimi i Planit të Integritetit, 2025 (%)**Figura 2. Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025**

Bashkia Peqin, gjatë vitit 2025, ka ndërmarrë hapa në drejtim të forcimit të qeverisjes së mirë dhe integritetit institucional. Në këtë kuadër, ka hartuar dhe miratuar disa dokumente strategjike që adresojnë forcimin e etikës dhe integritetit, përmirësimin e funksionimit të strukturave vendore antikorrupsion, konsolidimin e kuadrit të brendshëm institucional, zhvillimin dhe fuqizimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore, rritjen e rezistencës institucionale ndaj risqeve të integritetit, si dhe përmirësimin e transparencës dhe besueshmërisë publike.

Gjetjet e Raportit

Objektivi I - Përmirësimi i kuadrit të brendshëm rregullator në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit

Ky objektivi synon forcimin e kuadrit të brendshëm rregullator për etikën dhe integritetin, në përputhje me kornizën ligjore për vetëqeverisjen vendore, të drejtën e informimit, konsultimin

publik, menaxhimin dhe kontrollin financiar, sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesit, parandalimin e konfliktit të interesit, etj.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objekti, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 15 masa/aktivitete, nga të cilat:


- Janë realizuar 6 masa/aktivitete ose 40%
- Janë në proces realizimi 0 masa/aktivitete ose 0%
- Nuk janë realizuar 9 masa/aktivitete ose 60%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 2. Objekti I - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objekti I	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të përealizuara
Forcimi i Kuadrit Rregullator	15	6	0	9

Figura 3. Objekti I - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektiv është realizuar në masën 40%, me zbatimin e masave/aktiviteteve si më poshtë:

- Përditësimi (dhe miratimi) i rregullores së bashkisë me strukturën aktuale;
- Përcaktimi i plotë dhe i qartë në rregullore i detyrave dhe linjave të komunikimit dhe hierarkisë ndërmjet strukturave të bashkisë;
- Parashikimi i qartë i linjave të kontrollit (raportuese/bashkëpunuese/informuese) në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë;
- Përfshirja në rregulloren e Koordinatorit të Integritetit e rregullave mbi parandalimin e konfliktit të interesit në fushën e shërbimeve publike;

- Publikimi i instrumentit të miratuar dhe treguesve përkatës të performancës në Programin e Transparencës së bashkisë;
- Krijimi i regjistrit për deklarimin e dhuratave në bashki.

Objektivi II - Menaxhimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore në bashki, për identifikimin dhe parandalimin e risqeve të integritetit

Ky objektivi synon të forcojë mekanizmat që lidhen me garantimin e integritetit duke përmirësuar menaxhimin dhe kapacitetet e burimeve njerëzore të bashkisë. Nëpërmjet përmirësimit të proceseve të menaxhimit të burimeve njerëzore në institucion, do të sigurohen kapacitetet dhe aftësitë e nevojshme për zbatimin dhe konsolidimin e mekanizmave garantues të integritetit në institucion, me qëllim rritjen e profesionalizimit të personelit dhe zhvillimin në karrierë të zyrtarëve, në përputhje me performancën e tyre në punë.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objektivi, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 12 masa/aktivitete, nga të cilat:


- Është realizuar 1 masë/aktivitet ose 8%
- Janë në proces realizimi 0 masa/aktivitete ose 0%
- Nuk janë realizuar 11 masa/aktivitete ose 92%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 3. Objektivi II - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objektivi II	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Fuqizimi i Burimeve Njerëzore	12	1	0	11

Figura 4. Objektivi II - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektivi është realizuar në masën 8%, me zbatimin e masës/aktivitetit si më poshtë:

- Përfshirja në rregulloren e administratës e rregullave mbi rekrutimin në punë të punonjësve.

Objektivi III - Përmirësimi i transparencës dhe llogaridhënies së bashkisë

Transparenca e bashkisë gjatë procesit të zbatimit të politikave vendore është shumë e rëndësishme për rritjen e pjesëmarrjes së aktorëve të ndryshëm në veprimtarinë e bashkisë dhe të publikut në tërësi. Në këtë kuadër, është me rëndësi edhe siguri i pjesëmarrjes së publikut në procesin e identifikimit të prioritetëve strategjike afatgjatë. Për këtë arsye, bashkia angazhohet të forcojë mekanizmat e pjesëmarrjes për shoqërinë civile dhe grupe të veçanta të interesit, gjatë hartimit dhe konsultimit të dokumenteve të politikave të ndryshme vendore.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objekti, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 9 masa/aktivitete, nga të cilat:


- Janë realizuar 9 masa/aktivitete ose 100%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 4. Objektivi III - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objektivi III	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuar
Forcimi i transparencës dhe llogaridhënies	9	9	0	0

Figura 5. Objektivi III - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektivi është realizuar në masën 100%, me zbatimin e masave/aktiviteteve si më poshtë:

- Miratimi dhe publikimi i Programit të Transparencës së bashkisë, në përputhje me udhëzimet e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe legjislacionin përkatës;
- Përditësimi i vazhdueshëm i Programit të Transparencës me informacionin e nevojshëm;
- Publikimi i procedurave për lëshimin e lejeve, në Programin e Transparencës së bashkisë;

- Publikimi i raporteve të mekanizmave të kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm, në faqen zyrtare të bashkisë;
- Plotësimi i Programit të Transparencës së bashkisë me informacionin e kërkuar, në përmbushje të detyrimeve ligjore për transparencë proaktive;
- Lehtësimi i aksesit në Programin e Transparencës dhe vendosja e informacionit në gjuhë të huaj;
- Marrja e masave për publikimin e rregulloreve mbi sinjalizimin dhe njësinë përgjegjëse, në faqen zyrtare të bashkisë;
- Publikimi i informacionit publik me fokus procesin e konsultimeve publike, si dhe atë të pjesëmarrjes në vendimmarrjen e bashkisë;
- Hartimi dhe publikimi i një udhëzuesi/rregulloreje që do të zbërthente kuadrin rregullator në kontekstin e bashkisë.

Konkluzione

Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi për periudhën raportuese janar-dhjetor 2025, bazuar në gjetjet që ky dokument ofron, të dhënat analitike të raportuara nga drejtoritë përkatëse dhe analizën e kryer, rezulton se:

Bashkia Peqin ka vijuar me zbatimin e Planit të Integritetit, duke arritur një nivel mesatar realizimi prej 44% të masave të planifikuara për vitin 2025 (në intervalin 40-60%). Gjatë kësaj periudhe janë arritur disa rezultate pozitive si:

- Fuqizimi i transparencës dhe llogaridhënies së bashkisë, realizuar në masën 100%;
- Ngritja e kulturës së integritetit në bashki;
- Trajnime dhe aktivitete që mbështesin etikën institucionale;
- Njohja me bazën ligjore antikorrupsion, etj.

Masat dhe aktivitetet e realizuara në kuadër të zbatimit të Planit të Integritetit kanë ndikuar në rritjen e shkallës së kulturës së integritetit institucional. Si rezultat, janë hartuar disa dokumente strategjike, si dhe instrumente për transparencën dhe llogaridhënien, të cilat janë bërë të aksesueshme online në adresën zyrtare të bashkisë, si dhe kuadri rregullator mbi etikën dhe integritetin.

Rekomandime

- Të vijojë puna për zbatimin e Planit të Veprimit të Planit të Integritetit;
- Të vijojë puna për trajnimin e burimeve njerëzore dhe forcimin e kapaciteteve të tyre;
- Forcimi i koordinimit dhe bashkëpunimit ndërmjet drejtorive, për një raportim më të rregullt mbi masat e Planit të Integritetit;
- Sigurimi i një raportimi periodik, përmes publikimit të raporteve 6-mujore mbi zbatimin e Planit të Integritetit;
- Trajnimi në vijimësi i Koordinatorit të Integritetit të bashkisë.



RAPORT MONITORIMI

mbi Realizimin e Planeve të Integritetit
të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore

BASHKIA POGRADEÇ

për periudhën
Janar – Dhjetor 2025

Monitorimi i zbatueshmërisë të Planit të Integritetit për vitin 2025

Raporti i Monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit të **Bashkisë Pogradec** për vitin 2025 përbën dokumentin e parë të monitorimit të planit të veprimit të Planit vijues të Integritetit të bashkisë.

Plani i Integritetit është konceptuar për t'u zbatuar përgjatë një periudhe katërvjeçare, konkretisht 2025-2028.

Në Planin e Integritetit vijues të bashkisë janë përcaktuar gjithsej tre objektiva, për të cilat janë parashikuar fushat me risk, si dhe janë planifikuar masat dhe aktivitetet për realizimin e tyre, si vijon:

- **Objektivi I** - Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit;
- **Objektivi II** - Forcimi i rezistencës institucionale ndaj shkeljeve të integritetit nëpërmjet konsolidimit të menaxhimit dhe zhvillimit të burimeve njerëzore në bashki;
- **Objektivi III** - Forcimi i transparencës dhe efikasitetit sipas fushave të përgjegjësisë dhe llogaridhënies publike të bashkisë;

Për bashkinë Pogradec, Plani i Integritetit për periudhën janar-dhjetor 2025, referuar Planit të Veprimit, përmban masa dhe aktivitete të planifikuara sipas objektivave të përcaktuara në Planin e Veprimit.

Situata e monitorimit të Planit të Integritetit të Bashkisë Pogradec për periudhën janar–dhjetor 2025



Nga procesi i monitorimit rezulton se, në totalin prej 23 masash (aktivitetesh) të parashikuara për zbatim për vitin 2025:

- 14 masa/aktivitete janë realizuar plotësisht, që përfaqëson 61% të totalit
- 3 masa/aktivitete janë në proces realizimi, ose 13%
- 6 masa/aktivitete mbeten të porealizuara, ose 26%

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun vijues.

Tabela 1. Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Bashkia Pogradec	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të porealizuara
Numri i masave / aktiviteteve	23	14	3	6

Figura 1. Zbatimi i Planit të Integritetit, 2025 (%)**Figura 2. Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025**

Bashkia Pogradec, gjatë vitit 2025, ka ndërmarrë një sërë hapash në drejtim të forcimit të qeverisjes së mirë dhe integritetit institucional. Në këtë kuadër, ka hartuar dhe miratuar disa dokumente strategjike që adresojnë forcimin e etikës dhe integritetit, përmirësimin e funksionimit të strukturave vendore antikorruption, konsolidimin e kuadrit të brendshëm institucional, zhvillimin dhe fuqizimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore, rritjen e rezistencës institucionale ndaj risqeve të integritetit, si dhe përmirësimin e transparencës dhe besueshmërisë publike.

Gjetjet e Raportit

Objektivi I - Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit

Ky objektivi synon forcimin e kuadrit të brendshëm rregullator për etikën dhe integritetin, në përputhje me kornizën ligjore për vetëqeverisjen vendore, të drejtën e informimit, konsultimin

publik, menaxhimin dhe kontrollin financiar, sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesit, parandalimin e konfliktit të interesit, etj.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objekti, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 11 masa/aktivitete, nga të cilat:


- Janë realizuar 8 masa/aktivitete ose 73%
- Janë në proces realizimi 0 masa/aktivitete ose 0%
- Nuk janë realizuar 3 masa/aktivitete ose 27%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 2. Objekti I - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objekti I	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Forcimi i Kuadrit Rregullator	11	8	0	3

Figura 3. Objekti I - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektiv është realizuar në masën 73%, me zbatimin e masave/aktiviteteve si më poshtë:

- Hartimi i kalendarit të trajnimeve për stafin;
- Trajnime për personelin e bashkisë dhe anëtarët e KB-së, për përmbajtjen e kësaj rregulloreje dhe akteve mbështetëse;
- Realizimi i trajnimeve të domosdoshme për procesin e hetimit dhe shqyrtimit administrativ të sinjalizimeve për praktika apo veprime të dyshuara korrupsioni, për stafin e AB-së, të ofruara nga ASPA apo ILDKPKI;
- Rikujtesë periodike e punonjësve mbi funksionin dhe kontaktin e sinjalizuesit;
- Trajnimi i punonjësve të bashkisë mbi çështjet e integritetit (trajtimi i rasteve të korrupsionit, deklarimi i dhuratave, regjistri i dhuratave, etj.);

- Parashikimi i qartë në Rregulloren e Brendshme i rregullave etike për veprimtaritë e jashtme të punonjësve të bashkisë, ose përfshirja e tyre në Kodin e Sjelljes së Bashkisë;
- Publikimi i rregullores në Programin e Transparencës së bashkisë;
- Njohja e personelit të bashkisë me këto rregulla.

Objektivi II - Forcimi i rezistencës institucionale ndaj shkeljeve të integritetit nëpërmjet konsolidimit të menaxhimit dhe zhvillimit të burimeve njerëzore në bashki

Ky objektivi synon të forcojë mekanizmat që lidhen me garantimin e integritetit duke përmirësuar menaxhimin dhe kapacitetet e burimeve njerëzore të bashkisë. Nëpërmjet përmirësimit të proceseve të menaxhimit të burimeve njerëzore në institucion, do të sigurohen kapacitetet dhe aftësitë e nevojshme për zbatimin dhe konsolidimin e mekanizmave garantues të integritetit në institucion, me qëllim rritjen e profesionalizimit të personelit dhe zhvillimin në karrierë të zyrtarëve, në përputhje me performancën e tyre në punë.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objektivi, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 6 masa/aktivitete, nga të cilat:


- Janë realizuar 2 masa/aktivitete ose 33%
- Janë në proces realizimi 3 masa/aktivitete ose 50%
- Nuk është realizuar 1 masë/aktivitet ose 17%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 3. Objektivi II - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objektivi II	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Fuqizimi i Burimeve Njerëzore	6	2	3	1

Figura 4. Objektivi II - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektiv është realizuar në masën 33%, me zbatimin e masave/aktiviteteve si më poshtë:

- Hartimi i Planit Vjetor të Trajnimeve, sipas nevojave të drejtorive;
- Ofrimi i trajnimeve të personelit në fushën e Integritetit Evropian.

Objektivi III - Forcimi i transparencës dhe efikasitetit sipas fushave të përgjegjësisë dhe llogaridhënies publike të bashkisë

Ky objektiv synon të forcojë strukturat dhe mekanizmat që funksionojnë në nivelin e vetëqeverisjes vendore, të cilat kontribuojnë në rritjen e integritetit institucional dhe veprojnë si instrumente antikorrupsion. Këto struktura dhe mekanizma ngrihen dhe funksionojnë në përputhje me kornizën ligjore për vetëqeverisjen vendore, të drejtën e informimit, konsultimin publik, menaxhimin dhe kontrollin financiar, sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesit, parandalimin e konfliktit të interesit, etj.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objektivi, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 6 masa/aktivitete, nga të cilat:


- Janë realizuar 4 masa/aktivitete ose 67%
- Janë në proces realizimi 2 masa/aktivitete ose 33%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 4. Objektivi III - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objektivi III	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Forcimi i transparencës dhe llogaridhënies	6	4	2	0

Figura 5. Objektivi III - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektiv është realizuar në masën 67%, me zbatimin e masave/aktiviteteve si më poshtë:

- Plotësimi i Programit të Transparencës së bashkisë me informacionin e kërkuar, në përmbushje të detyrimeve ligjore për transparencë proaktive;
- Adresimi i problemeve teknike në aksesimin e rubrikave të ndryshme në faqen e internetit;
- Hartimi periodik i raporteve gjashtëmujore mbi të gjitha donacionet e përfituara nga bashkia (jo vetëm bashkëfinancimet me fonde IPA), sipas kërkesave të Rregullores së Këshillit Bashkiak;
- Publikimi në Programin e Transparencës i informacionit për donacionet e përfituara nga bashkia, duke përfshirë emrin e donatorit, shumën e donacionit dhe qëllimin e donacionit.

Konkluzione

Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi për periudhën raportuese janar-dhjetor 2025, bazuar në gjetjet që ky dokument ofron, të dhënat analitike të raportuara nga drejtoritë përkatëse dhe analizën e kryer, rezulton se:

Bashkia Pogradec ka vijuar me zbatimin e Planit të Integritetit, duke arritur një nivel të mirë realizimi prej 61% të masave të planifikuara për vitin 2025 (në intervalin 60-80%). Gjatë kësaj periudhe janë arritur rezultate pozitive në:

- Ngritjen e kulturës së integritetit dhe llogaridhënies në bashki;
- Transparencë më të lartë në publikimin e informacioneve;
- Trajnime dhe aktivitete që mbështesin etikën institucionale;
- Modernizimin e administratës përmes digjitalizimit të dokumentacionit.

Masat dhe aktivitetet e realizuara në kuadër të zbatimit të Planit të Integritetit kanë ndikuar ndjeshëm në rritjen e shkallës së transparencës së institucionit. Si rezultat, një sërë dokumentesh strategjike, aspekte të punës dhe të shërbimeve të ofruara, rezultatet e kontrolleve financiare, si dhe instrumentet për raportimin e korrupsionit apo shkeljeve të tjera, janë bërë të aksesueshme online në adresën zyrtare të bashkisë. Ky progres e ka renditur këtë objektiv në një nivel proaktiv të transparencës.

Rekomandime

- Zgjerimi i trajnimeve për zhvillimin e kapaciteteve teknike të burimeve njerëzore;
- Rritja e pjesëmarrjes qytetare dhe nxitja e sinjalizimit, përmes krijimit të kanaleve efektive dhe anonime për denoncime;
- Forcimi i koordinimit dhe bashkëpunimit ndërmjet drejtorive, për një raportim më të rregullt mbi masat e Planit të Integritetit;
- Sigurimi i një raportimi periodik transparent, përmes publikimit të raporteve 6-mujore mbi zbatimin e Planit të Integritetit;
- Trajnimi në vijimësi i Koordinatorit të Integritetit të bashkisë.



RAPORT **MONITORIMI**

mbi Realizimin e Planeve të Integritetit
të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore

BASHKIA POLIÇAN

për periudhën
Janar – Dhjetor 2025

Monitorimi i zbatueshmërisë të Planit të Integritetit për vitin 2025

Raporti i Monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit të **Bashkisë Poliçan** për vitin 2025 përbën dokumentin e parë të monitorimit të planit të veprimit të Planit të Integritetit të bashkisë.

Plani i Integritetit është konceptuar për t'u zbatuar përgjatë një periudhe katërvjeçare, konkretisht 2025-2028.

Në Planin e Integritetit të bashkisë janë përcaktuar gjithsej tre objektiva, për të cilat janë parashikuar fushat me risk, si dhe janë planifikuar masat dhe aktivitetet për realizimin e tyre, si vijon:

- **Objektivi I** - Menaxhimi i riskut të integritetit në fusha të veçanta të përgjegjësisë së bashkisë;
- **Objektivi II** - Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit;
- **Objektivi III** - Menaxhimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore në bashki, për identifikimin dhe parandalimin e risqeve të integritetit për të gjitha nivelet dhe funksionet në bashki.

Për bashkinë Poliçan, Plani i Integritetit për periudhën janar-dhjetor 2025, referuar Planit të Veprimit, përmban masa dhe aktivitete të planifikuara sipas objektivave të përcaktuara në Planin e Veprimit.

Situata e monitorimit të Planit të Integritetit të Bashkisë Poliçan për periudhën janar–dhjetor 2025



Nga procesi i monitorimit rezulton se, në totalin prej 82 masash (aktivitetesh) të parashikuara për zbatim për vitin 2025:

- 46 masa/aktivitete janë realizuar plotësisht, që përfaqëson 56% të totalit
- 0 masa/aktivitete janë në proces realizimi, ose 0%
- 36 masa/aktivitete mbeten të porealizuara, ose 44%

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun vijues.

Tabela 1. Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Bashkia Poliçan	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të porealizuara
Numri i masave / aktiviteteve	82	46	0	36

Figura 1. Zbatimi i Planit të Integritetit, 2025 (%)**Figura 2. Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025**

Sa më sipër, gjatë vitit 2025, Bashkia Poliçan ka ndërmarrë një sërë hapash të rëndësishëm në drejtim të forcimit të integritetit institucional. Në këtë kuadër, janë hartuar dhe miratuar disa dokumente strategjike që adresojnë forcimin e etikës dhe integritetit, përmirësimin e funksionimit të strukturave vendore antikorrupsion, konsolidimin e kuadrit të brendshëm institucional, zhvillimin dhe fuqizimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore, si dhe rritjen e rezistencës institucionale ndaj risqeve të integritetit.

Gjetjet e Raportit

Objektivi I - Menaxhimi i riskut të integritetit në fusha të veçanta të përgjegjësisë së bashkisë

Ky objektivi synon menaxhimin e riskut të integritetit institucional në fusha të veçanta të përgjegjësisë: menaxhimi financiar, auditimi i brendshëm dhe kontrolli, shërbimet publike, transparenca, administrimi i pronave dhe menaxhimi i territorit, arkivimi i dokumenteve. Masat

e parashikuara nën këtë objektiv kanë për qëllim reduktimin ose eliminimin e risqeve të identifikuar në këto fusha.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objektivi, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 31 masa/aktivitete, nga të cilat:


- Janë realizuar 19 masa/aktivitete ose 61%
- Nuk janë realizuar 12 masa/aktivitete ose 39%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 2. Objektivi I - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objektivi I	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Fusha të Veçanta	31	19	0	12

Figura 3. Objektivi I - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektiv është realizuar në masën 61%, me zbatimin e masave/aktiviteteve si më poshtë:

- Parashikimi në Rregulloren e Këshillit Bashkiak i detyrimit për rakordimin e dokumenteve buxhetore të miratuara në Këshillin Bashkiak, me projekt-buxhetin e propozuar nga bashkia;
- Parashikimi në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë i rasteve të ndryshimit të zërave të buxhetit, nivelit miratues sipas rastit, rakordimit mujor për realizimin e buxhetit ndërmjet Qendrave të Kostos dhe Zyrës së Buxhetit, si dhe detyrimit për përgatitjen e një relacioni ku argumentohet kërkesa për ndryshim;
- Parashikimi në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë i detyrimit për informim periodik për realizimin e buxhetit pranë drejtorive të përgjithshme dhe Kryetarit të Bashkisë;
- Numri i analizave të kryera për paketën fiskale dhe publikimi i tyre;
- Analiza e nevojave urgjente të njësive të largëta administrative dhe alokimi i fondeve për përmbushjen e shërbimeve publike thelbësore;

- Hartimi i formularëve tip, për procedurat e shërbimeve dhe lëvizjeve të punonjësve të kësaj drejtorie;
- Ngritja e një grupi pune për vlerësimin e problematikave ligjore të evidentuara nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, për menaxhimin e kontratave të shërbimit publik;
- Përcaktimi në Rregulloren e Brendshme i përgjegjësive dhe roleve të mbikëqyrësit për monitorimin e zbatimit të kontratave publike;
- Publikimi i raporteve të monitorimit të kontratave të shërbimit publik në faqen zyrtare të bashkisë;
- Hartimi dhe miratimi i një metodologjie për procesin e monitorimit të zbatimit të kontratave;
- Rivlerësimi i të drejtave të aksesit dhe dhënia e të drejtave personave të caktuar të DAJP në bashki;
- Pajisja me një sistem informativ të qendëruar për administrimin dhe përdorimin e pronave të bashkisë, i cili mundëson akses elektronik dhe akses në person pranë sporteleve të informacionit;
- Përditësimi i akteve administrative (formularëve) në përputhje me kërkesat e Kodit të Ri të Procedurave Administrative;
- Përcaktimi në rregullore i kushteve teknike për ruajtjen e Fondit Arkivor;
- Transferimi i Fondit Arkivor pranë Arkivës Qendrore;
- Asgjësimi i dokumenteve që e kanë humbur vlerën e tyre;
- Përditësimi periodik i Programit të Transparencës, sipas detyrimeve të Ligjit për të Drejtën e Informimit.

Objektivi II - Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit

Ky objektivi synon forcimin e kuadrit rregullator në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit, duke shtuar dispozita të caktuara, kryesisht ato që lidhen me aspektet dhe çështjet e integritetit, përditësimin me ndryshimet më të fundit ligjore, rregullimit të funksioneve dhe detyrave të njësive në bashki, si edhe pasqyrimin të ndryshimeve që ka pësuar struktura institucionale.


Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objektivi, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 29 masa/aktivitete, nga të cilat:

- Janë realizuar 13 masa/aktivitete ose 45%
- Nuk janë realizuar 16 masa/aktivitete ose 55%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 3. Objektivi II - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objektivi II	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të përealizuara
Forcimi i Kuadrit Rregullator	29	13	0	16

Figura 4. Objektivi II - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit

Për periudhën raportuese janar-dhjetor 2025, bashkia ka realizuar masat dhe aktivitetet si më poshtë:

- Parashikim i qartë në rregulloren e bashkisë i rregullave për zhdëmtimin dhe keqpërdorimin e aktiveve të bashkisë;
- Informimi i personelit të bashkisë për këto rregulla;
- Hartimi dhe miratimi i rregullave të brendshme të funksionimit të GMS-së, si organ kolegjal në bashki, në përputhje me Ligjin nr. 8840/1999 për funksionimin e organeve kolegjiale;
- Miratimi i rregullave të qarta për përcaktimin e numrit proporcional dhe nevojës kohore të emërimeve në Kabinetin e Kryetarit të Bashkisë, si dhe roleve dhe detyrave të tyre, në drejtim të rritjes së performancës së bashkisë;
- Përditësimi i rregullave për hartimin e planit të trajnimeve, vlerësimin e trajnimeve të jashtme dhe shpërndarjen e njohurive të marra përmes trajnimeve;
- Parashikimi në Rregulloren e Brendshme i rregullave për ndërveprimin ndërmjet drejtorive të bashkisë, në lidhje me praktikat për të drejtën e informimit, si dhe komunikimin me Koordinatorin për të Drejtën e Informimit;
- Hartimi dhe miratimi i rregullores së Këshillit Bashkiak, në përputhje me bazën ligjore në fuqi;
- Informimi i personelit përkatës për PSV-në dhe trajnime të brendshme mbi konfliktin e interesit;
- Rishikimi i rregullores për të formalizuar linjat dhe mënyrën e komunikimit ndërmjet drejtorive të ndryshme të bashkisë, institucioneve të varësisë dhe institucioneve të tjera;
- Detajimi i rregullave për pranimin dhe deklarimin e dhuratave për personelin e bashkisë;
- Parashikimi i qartë në Rregulloren e Brendshme i rregullave etike për veprimtaritë e jashtme të punonjësve të bashkisë, ose përfshirja e tyre në Kodin e Sjelljes së Bashkisë;

- Përditësimi i rregullave për Auditin e Brendshëm në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë, duke siguruar pavarësinë e Departamentit të Auditimit nga Kryetari;
- Informimi i personelit të bashkisë për rolin, funksionin dhe detyrat e njësisë së Auditit të Brendshëm.

Objektivi III - Menaxhimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore në bashki, për identifikimin dhe parandalimin e risqeve të integritetit për të gjitha nivelet dhe funksionet në bashki

Ky objektivi synon të forcojë mekanizmat që lidhen me garantimin e integritetit duke përmirësuar menaxhimin dhe kapacitetet e burimeve njerëzore të bashkisë. Nëpërmjet përmirësimit të proceseve të menaxhimit të burimeve njerëzore në institucion, do të sigurohen kapacitetet dhe aftësitë e nevojshme për zbatimin dhe konsolidimin e mekanizmave garantues të integritetit në institucion, me qëllim rritjen e profesionalizimit të personelit dhe zhvillimin në karrierë të zyrtarëve, në përputhje me performancën e tyre në punë.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objektivi, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 22 masa/aktivitete, nga të cilat:


- Janë realizuar 14 masa/aktivitete ose 64%
- Nuk janë realizuar 8 masa/aktivitete ose 36%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 4. Objektivi III - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objektivi III	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Fuqizimi i Burimeve Njerëzore	22	14	0	8

Figura 5. Objektivi III - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Për periudhën raportuese janar-dhjetor 2025, bashkia ka realizuar masat dhe aktivitetet si më poshtë:

- Përfshirja e një treguesi të posaçëm të numrit të aktiviteteve të konsultimit publik të dokumenteve buxhetore të bashkisë, ku anëtarët e GMS-së kanë qenë pjesëmarrës, në Raportin Vjetor të Transparencës së bashkisë;
- Përcaktimi i këtij detyrimi në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë;
- Përcaktimi në rregullore i linjave të qarta të komunikimit ndërmjet drejtorive të ndryshme të bashkisë me Koordinatorin për të Drejtën e Informimit dhe atë të Njoftimit dhe Konsultimit Publik;
- Përcaktimi i roleve dhe përgjegjësi për punonjësit që do të menaxhojnë dosjet e personelit në sistemin e qendëruar;
- Realizimi i trajnimeve të domosdoshme për procesin e hetimit dhe shqyrtimit administrativ të sinjalizimeve për praktika apo veprime të dyshuara korrupsioni, për punonjësit e AB-së, të ofruara nga ASPA apo ILDKPKI;
- Informimi i të gjithë punonjësve mbi rregulloren e sinjalizuesit;
- Publikimi i rregullores në Programin e Transparencës së bashkisë;
- Hartimi dhe miratimi i një PSV-je për bashkërendimin dhe koordinimin mes të gjitha strukturave brenda bashkisë, për menaxhimin e rasteve;
- Informimi i personelit të bashkisë për këtë PSV;
- Vlerësimi i nevojës për ndarjen e këtyre funksioneve në dy punonjës të bashkisë;
- Rishikimi i kriterëve të punësimit në DAJP, me qëllim përfshirjen e specialistëve topografë dhe inxhinierë në drejtori;
- Vlerësimi i nevojave për vende pune shitesë në njësinë e Auditimit të Brendshëm dhe shpallja e vendeve të mundshme sipas kriterëve përkatëse;
- Ngritja e një grupi pune për vlerësimin e nevojave për kapacitete njerëzore në fushën e topografisë, gjeodezisë dhe grafik-dizajnit, në Drejtorinë e Projektimit pranë DPPZHT-së.

Konkluzione

Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi për periudhën raportuese janar-dhjetor 2025, bazuar në gjetjet që ky dokument ofron, të dhënat analitike të raportuara nga drejtoritë përkatëse dhe analizën e kryer, rezulton se:

Bashkia Poliçan ka vijuar me zbatimin e Planit të Integritetit, duke arritur një nivel mesatar realizimi prej 56% të masave të planifikuara për vitin 2025 (në intervalin 40-60%). Gjatë kësaj periudhe janë arritur rezultate pozitive në drejtim të:

- Rritjes së ndërgjegjësimit institucional për menaxhimin e integritetit;
- Rritjes së kapaciteteve të burimeve njerëzore, përmes trajnimeve të fokusuara në etikë;
- Forcimit dhe menaxhimit të burimeve njerëzore;
- Forcimit të kuadrit të brendshëm rregullator, ku vërehet përmirësimi i kuadrit etik dhe rregullator brenda bashkisë, zhvillimi i trajnimeve në fushat e etikës, konfliktit të interesit dhe kontrollit të brendshëm, krijimi i mekanizmave për transparencë dhe llogaridhënie, si dhe nxitja e pjesëmarrjes së qytetarëve përmes kanaleve të komunikimit elektronik.

Rekomandime

- Të vijojë puna për realizimin e masave/aktiviteteve të planifikuara në Planin e Integritetit;
- Forcimi i zbatimit të masave për transparencë dhe përmirësimi i kuadrit rregullator, me synim rritjen e integritetit në menaxhimin financiar, menaxhimin e burimeve njerëzore dhe administrimin e aseteve;
- Rritja e pjesëmarrjes qytetare dhe nxitja e sinjalizimit, përmes krijimit të kanaleve efektive dhe anonime për denoncime;
- Forcimi i koordinimit dhe bashkëpunimit ndërmjet drejtorive, për një raportim më të rregullt mbi masat e Planit të Integritetit;
- Sigurimi i një raportimi periodik transparent, përmes publikimit të raporteve 6-mujore mbi zbatimin e Planit të Integritetit;
- Trajnimi në vijimësi i Koordinatorit të Integritetit të bashkisë.



RAPORT MONITORIMI

mbi Realizimin e Planeve të Integritetit
të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore

BASHKIA PRRENJAS

për periudhën
Janar – Dhjetor 2025

Monitorimi i zbatueshmërisë të Planit të Integritetit për vitin 2025

Raporti i Monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit të **Bashkisë Prrenjas** për vitin 2025 përbën dokumentin e parë të monitorimit të planit të veprimit të Planit të Integritetit të bashkisë.

Plani i Integritetit është konceptuar për t’u zbatuar përgjatë një periudhe trevjeçare, konkretisht 2025-2027.

Në Planin e Integritetit të bashkisë janë përcaktuar gjithsej katër objektiva, për të cilat janë parashikuar fushat me risk, si dhe janë planifikuar masat dhe aktivitetet për realizimin e tyre, si vijon:

- **Objektivi I** - Përmirësimi i kuadrit të brendshëm rregullator në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit;
- **Objektivi II** - Menaxhimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore në bashki, për identifikimin dhe parandalimin e risqeve të integritetit;
- **Objektivi III** - Rritja e transparencës dhe llogaridhënies publike;
- **Objektivi IV** - Menaxhimi i riskut të integritetit në fusha të veçanta të përgjegjësisë së bashkisë.

Për bashkinë Prrenjas, Plani i Integritetit për periudhën janar-dhjetor 2025, referuar Planit të Veprimit, përmban masa dhe aktivitete të planifikuara sipas objektivave të përcaktuara në Planin e Veprimit.

Situata e monitorimit të Planit të Integritetit të Bashkisë Prrenjas për periudhën janar–dhjetor 2025



Nga procesi i monitorimit rezulton se, në totalin prej 38 masash (aktivitetesh) të parashikuara për zbatim për vitin 2025:

- 33 masa/aktivitete janë realizuar plotësisht, që përfaqëson 87% të totalit
- 0 masa/aktivitete janë në proces realizimi, ose 0%
- 5 masa/aktivitete mbeten të parealizuara, ose 13%

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun vijues.

Tabela 1. Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Bashkia Prrenjas	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Numri i masave / aktiviteteve	38	33	0	5

Figura 1. Zbatimi i Planit të Integritetit, 2025 (%)**Figura 2. Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025**

Bashkia Prrenjas, gjatë vitit 2025, ka ndërmarrë një sërë hapash në drejtim të forcimit të qeverisjes së mirë dhe integritetit institucional. Në këtë kuadër, ka hartuar dhe miratuar disa dokumente strategjike që adresojnë forcimin e etikës dhe integritetit, përmirësimin e funksionimit të strukturave vendore antikorruption, konsolidimin e kuadrit të brendshëm institucional, zhvillimin dhe fuqizimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore, rritjen e rezistencës institucionale ndaj risqeve të integritetit, si dhe përmirësimin e transparencës dhe besueshmërisë publike.

Gjetjet e Raportit

Objektivi I - Përmirësimi i kuadrit të brendshëm rregullator në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit

Ky objektivi synon forcimin e kuadrit të brendshëm rregullator për etikën dhe integritetin, në përputhje me kornizën ligjore për vetëqeverisjen vendore, të drejtën e informimit, konsultimin

publik, menaxhimin dhe kontrollin financiar, sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesit, parandalimin e konfliktit të interesit, etj.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objekti, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 13 masa/aktivitete, nga të cilat:


- Janë realizuar 10 masa/aktivitete ose 76%
- Nuk janë realizuar 3 masa/aktivitete ose 24%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 2. Objekti I - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objekti I	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Forcimi i Kuadrit Rregullator	13	10	0	3

Figura 3. Objekti I - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektiv është realizuar në masën 76%, me zbatimin e masave/aktiviteteve si më poshtë:

- Rishikimi i rregullores me qëllim përfshirjen e përshkrimeve për të gjitha pozicionet e punës të pasqyruara në strukturën e bashkisë;
- Hartimi i planeve vjetore të punës për të gjitha njësitë në bashki;
- Hartimi i një plani të përbashkët pune të bashkisë, që përfshin planet e hartuara nga secila njësi;
- Përfshirja e detyrave shtesë të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit në vlerësimin vjetor të performancës në punë;
- Përditësimi i rregullores me qëllim përfshirjen e pozicionit të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit;
- Përditësimi i rregullores me qëllim përfshirjen e pozicionit të Koordinatorit për Konsultimin Publik;

- Përfshirja e detyrave shtesë të Koordinatorit për Konsultimin Publik në vlerësimin vjetor të performancës në punë;
- Hartimi dhe miratimi i PSV-së lidhur me proceset e punës të sektorit të arkivës;
- Marrja e masave për parashikimin në rregulloren e administratës të detyrave të veçanta për pozicionet e arkivës dhe protokollit;
- Përfundimi i procedurave të rekrutimit për të gjitha pozicionet e punës që janë pjesë e shërbimit civil.

Objektivi II - Menaxhimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore në bashki, për identifikimin dhe parandalimin e risqeve të integritetit

Ky objektivi synon të forcojë mekanizmat që lidhen me garantimin e integritetit duke përmirësuar menaxhimin dhe kapacitetet e burimeve njerëzore të bashkisë. Nëpërmjet përmirësimit të proceseve të menaxhimit të burimeve njerëzore në institucion, do të sigurohen kapacitetet dhe aftësitë e nevojshme për zbatimin dhe konsolidimin e mekanizmave garantues të integritetit në institucion, me qëllim rritjen e profesionalizimit të personelit dhe zhvillimin në karrierë të zyrtarëve, në përputhje me performancën e tyre në punë.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objektivi, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 10 masa/aktivitete, nga të cilat:


- Janë realizuar 8 masa/aktivitete ose 80%
- Nuk janë realizuar 2 masa/aktivitete ose 20%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 3. Objektivi II - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objektivi II	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Fuqizimi i Burimeve Njerëzore	10	8	0	2

Figura 4. Objektivi II - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektiv është realizuar në masën 80%, me zbatimin e masave/aktiviteteve si më poshtë:

- Plotësimi i Programit të Transparencës së bashkisë me informacionin pa kërkesë, duke plotësuar detyrimet ligjore për transparencë proaktive;
- Trajnimi i vazhdueshëm i punonjësve mbi ndryshimet ligjore në fushën e prokurimit publik, në bashkëpunim me ASPA-n;
- Marrja e masave për koordinimin e kërkesave buxhetore me të gjithë sektorët e bashkisë;
- Miratimi i kërkesave në nivel drejtorie/sektori dhe diskutimi i tyre me Ekipet e Menaxhimit të Buxhetit;
- Marrja e masave për plotësimin e pozicionit të Sekretarit të Përgjithshëm në bashki;
- Rishikimi i strukturës së bashkisë për të shtuar edhe një punonjës tjetër me profil IT;
- Rishikimi i strukturës për të shtuar një jurist në Drejtorinë e Auditimit;
- Vlerësimi i nevojës për rishikimin e organigramës dhe rekrutimin e burimeve njerëzore të specializuara në Sektorin e Planifikimit të Territorit;
- Marrja e masave për trajnimin e punonjësve të rinj mbi rregullat dhe kuadrin ligjor mbi arkivat.

Objektivi III - Rritja e transparencës dhe llogaridhënies publike

Ky objektiv synon të forcojë strukturat dhe mekanizmat që funksionojnë në nivelin e vetëqeverisjes vendore, të cilat kontribuojnë në rritjen e integritetit institucional dhe veprojnë si instrumente antikorrupsion. Këto struktura dhe mekanizma ngrihen dhe funksionojnë në përputhje me kornizën ligjore për vetëqeverisjen vendore, të drejtën e informimit, konsultimin publik, menaxhimin dhe kontrollin financiar, sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesit, parandalimin e konfliktit të interesit, etj.


Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objektivi, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 9 masa/aktivitete, nga të cilat:

- Janë realizuar 9 masa/aktivitete ose 100%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 4. Objektivi III - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objektivi III	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuar
Forcimi i transparencës dhe llogaridhënies	9	9	0	0

Figura 5. Objektivi III - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit

Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektivi është realizuar në masën 100%, me zbatimin e masave/aktiviteteve si më poshtë:

- Plotësimi i Programit të Transparencës së bashkisë me informacionin pa kërkesë, duke plotësuar detyrimet ligjore për transparencë proaktive;
- Lehtësimi i aksesit në Programin e Transparencës dhe vendosja e informacionit në gjuhën shqipe;
- Përcaktimi i një personi përgjegjës për hartimin dhe plotësimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak;
- Marrja e masave për publikimin e rregulloreve mbi sinjalizimin dhe njësinë përgjegjëse, në faqen zyrtare të bashkisë;
- Publikimi i procedurave për lëshimin e lejeve, në Programin e Transparencës së bashkisë;
- Publikimi i regjistrit të kontratave për pronat në pronësi ose administrim të bashkisë, në faqen zyrtare të bashkisë;
- Publikimi i plotë i procedurave të ankimit ndaj aktiviteteve të njësisë së IMT-së, në faqen zyrtare të bashkisë;
- Marrja e masave për përditësimin e faqes zyrtare të bashkisë, në seksionin “Taksa dhe Tarifa Vendore”;
- Publikimi i taksave dhe tarifave vendore për vitin aktual.

Objektivi IV - Menaxhimi i riskut të integritetit në fusha të veçanta të përgjegjësisë së bashkisë

Nëpërmjet këtij objektivi synohet menaxhimi i riskut të integritetit në fushat kryesore të përgjegjësisë së bashkisë, duke u fokusuar në proceset e punës të vlerësuara si më të ekspozuarat ndaj rrezikut të korrupsionit. Në tërësinë e tij, menaxhimi i integritetit i Bashkisë Prrenjas paraqet sfida, të cilat janë parashikuar edhe në Strategjinë për Qeverisjen Vendore dhe që hasen më së shumti në fusha të veçanta të përgjegjësisë, të tilla si fusha e menaxhimit financiar, menaxhimi i pronave të bashkisë, shërbimet publike dhe arkivimi.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objektivi, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 6 masa/aktivitete, nga të cilat:


- Janë realizuar 6 masa/aktivitete ose 100%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 5. Objektivi IV - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objektivi IV	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Fusha të Veçanta	6	6	0	0

Figura 6. Objektivi IV - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektivi është realizuar në masën 100%, me zbatimin e masave/aktiviteteve si më poshtë:

- Vlerësimi i nevojës për pajisjen e Sektorit të Planifikimit, Hartimit dhe Implementimit të Projekteve dhe Pronave me instrumente IT që sigurojnë ruajtjen e informacioneve kritike (“back-up”, “cloud computing”, etj.);
- Vlerësimi i nevojës për lidhjen e një marrëveshjeje bashkëpunimi me ASHK-në, për arritjen sa më të shpejtë të informacionit mbi pronat;
- Parashikimi në PBA dhe alokimi i logjistikës së nevojshme (kompjuter, skaner dhe fotokopje) tek Sektori i Planifikimit të Territorit;
- Marrja e masave për vendosjen e autoritetit për konfliktin e interesit pranë njësisë së Burimeve Njerëzore;
- Publikimi i të dhënave mbi autoritetin përgjegjës, në faqen zyrtare;
- Përfshirja e detyrave të autoritetit për konfliktin e interesit në rregulloren e administrates.

Konkluzione

Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi për periudhën raportuese janar-dhjetor 2025, bazuar në gjetjet që ky dokument ofron, të dhënat analitike të raportuara nga drejtoritë përkatëse dhe analizën e kryer, rezulton se:

Bashkia Prrenjas ka vijuar me zbatimin e Planit të Integritetit, duke arritur një nivel të lartë të zbatimit të planit të veprimit, me një nivel realizimi prej 87% të masave të planifikuara për vitin 2025 (në intervalin 80-100%). Gjatë kësaj periudhe janë arritur rezultate në drejtim të:

- Ngritjes së kulturës së integritetit dhe llogaridhënies në bashki;
- Trajnimeve dhe aktiviteteve që mbështesin etikën institucionale;
- Trajnimit dhe zhvillimit të burimeve njerëzore;
- Njohjes me bazën ligjore antikorrupsion;
- Transparencës proaktive dhe llogaridhënies publike.

Masat dhe aktivitetet e realizuara në kuadër të zbatimit të Planit të Integritetit kanë ndikuar në rritjen e shkallës së kulturës së integritetit institucional. Si rezultat, janë hartuar disa dokumente strategjike mbi etikën në aspekte të punës dhe të shërbimeve të ofruara, si dhe instrumente për raportimin e korrupsionit apo shkeljeve të tjera, të cilat janë bërë të aksesueshme online në adresën zyrtare të bashkisë.

Rekomandime

- Të vijojë puna për zbatimin e Planit të Veprimit të Planit të Integritetit;
- Forcimi i koordinimit dhe bashkëpunimit ndërmjet drejtorive, për një raportim më të rregullt mbi masat e Planit të Integritetit;
- Sigurimi i një raportimi periodik transparent, përmes publikimit të raporteve 6-mujore mbi zbatimin e Planit të Integritetit;
- Trajnimi në vijimësi i Koordinatorit të Integritetit të bashkisë.



RAPORT MONITORIMI

mbi Realizimin e Planeve të Integritetit
të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore

BASHKIA PUKË

për periudhën
Janar – Dhjetor 2025

Monitorimi i zbatueshmërisë të Planit të Integritetit për vitin 2025

Raporti i Monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit të Bashkisë Pukë për vitin 2025 përbën dokumentin e katërt të monitorimit të planit të veprimit të Planit të Integritetit të bashkisë.

Plani i Integritetit është konceptuar për t'u zbatuar përgjatë një periudhe katërvjeçare, konkretisht 2022-2025.

Në Planin e Integritetit të bashkisë janë përcaktuar gjithsej tre objektiva, për të cilat janë parashikuar fushat me risk, si dhe janë planifikuar masat dhe aktivitetet për realizimin e tyre, si vijon:

- **Objektivi I** - Përmirësimi i kuadrit rregullator të bashkisë mbi aspekte të etikës dhe integritetit sipas fushave funksionale të bashkisë;
- **Objektivi II** - Menaxhim efektiv i riskut të integritetit me fokus fushat e përgjegjësisë së bashkisë;
- **Objektivi III** - Përmirësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore në të gjitha nivelet dhe funksionet në bashki.

Për bashkinë Pukë, Plani i Integritetit për periudhën janar-dhjetor 2025, referuar Planit të Veprimit, përmban masa dhe aktivitete të planifikuara në vijimësi, në mbështetje të objektivave të planifikuara në Planin e Veprimit.

Situata e monitorimit të Planit të Integritetit të Bashkisë Pukë për periudhën janar–dhjetor 2025



Nga procesi i monitorimit rezulton se, në totalin prej 19 masash (aktivitetesh) të parashikuara në vijimësi për zbatim për vitin 2025:

- 10 masa/aktivitete janë realizuar plotësisht, që përfaqëson 53% të totalit
- 0 masa/aktivitete janë në proces realizimi, ose 0%
- 9 masa/aktivitete mbeten të porealizuara, ose 47%

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun vijues.

Tabela 1. Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Bashkia Pukë	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të porealizuara
Numri i masave / aktiviteteve	19	10	0	9

Figura 1. Zbatimi i Planit të Integritetit, 2025 (%)**Figura 2. Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025**

Sa më sipër, gjatë vitit 2025, Bashkia Pukë ka ndërmarrë hapa në vijimësi, në drejtim të forcimit të qeverisjes së mirë dhe integritetit institucional. Në këtë kuadër, janë hartuar dhe miratuar dokumente strategjike që adresojnë forcimin e etikës dhe integritetit, përmirësimin e funksionimit të strukturave vendore antikorruption, konsolidimin e kuadrit të brendshëm institucional, zhvillimin dhe fuqizimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore, rritjen e rezistencës institucionale ndaj risqeve të integritetit, si dhe përmirësimin e transparencës dhe të besueshmërisë publike.

Gjetjet e Raportit

Objektivi I - Përmirësimi i kuadrit rregullator të bashkisë mbi aspekte të etikës dhe integritetit sipas fushave funksionale të bashkisë

Ky objektivi synon të forcojë strukturat dhe mekanizmat që funksionojnë në nivelin e vetëqeverisjes vendore, të cilat kontribuojnë në rritjen e integritetit institucional dhe veprimet

si instrumente antikorrupsion. Këto struktura dhe mekanizma ngrihen dhe funksionojnë në përputhje me kornizën ligjore për vetëqeverisjen vendore, të drejtën e informimit, konsultimin publik, menaxhimin dhe kontrollin financiar, sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesit, parandalimin e konfliktit të interesit, etj.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objekti, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 6 masa/aktivitete, nga të cilat:


- Janë realizuar 2 masa/aktivitete ose 33%
- Nuk janë realizuar 4 masa/aktivitete ose 67%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 2. Objekti I - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objekti I	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Forcimi i Kuadrit Rregullator	6	2	0	4

Figura 3. Objekti I - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektiv është realizuar në masën 33%, me zbatimin e masave/aktiviteteve si më poshtë:

- Regjistri për Koordinatorin e Integritetit, plotësimi dhe raportimi rast pas rasti;
- Informimi i personelit të bashkisë në lidhje me regjistrin e Koordinatorit të Integritetit dhe detyrimet përkatëse për deklarimin e konfliktit të interesit dhe regjistrimin e dhuratave.

Objektivi II - Menaxhim efektiv i riskut të integritetit me focus fusha të veçanta të përgjegjësisë së bashkisë

Ky objektivi synon adresimin e risqeve të integritetit në fushat funksionale të përgjegjësisë së bashkisë. Masat e parashikuara synojnë të përmirësojnë efektivitetin, eficiencën dhe cilësinë e proceseve të punës në fushat funksionale të bashkisë, me qëllim përmirësimin e shërbimeve publike, planifikimin e territorit, menaxhimin e pronave dhe aseteve publike, menaxhimin financiar, etj.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objekti, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 7 masa/aktivitete, nga të cilat:


- Janë realizuar 3 masa/aktivitete ose 43%
- Nuk janë realizuar 4 masa/aktivitete ose 57%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 3. Objektivi II - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objektivi II	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Fusha të veçanta	7	3	0	4

Figura 4. Objektivi II - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektivi është realizuar në masën 43%, me zbatimin e masave/aktiviteteve si më poshtë:

- Evidentimi i pronave të paazhurnuara dhe krijimi i listës prioritare të tyre;
- Publikimi në Programin e Transparencës i informacionit për pronat e kategorive të ndryshme dhe statusin e tyre, për t'u vënë në dispozicion të palëve të interesuara;
- Ngritja e një grupi pune me punonjës të bashkisë, për të përshpejtuar mbarëvajtjen e procesit të inventarizimit, në mbështetje të planit të punës.

Objektivi III - Përmirësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore në të gjitha nivelet dhe funksionet në bashki

Ky objektivi synon të përforcojë mirëfunksionimin e administratës së institucionit, nëpërmjet forcimit të kapaciteteve njerëzore, trajnimit dhe rekrutimit të stafit të nevojshëm në përputhje me strukturën dhe organikën, si dhe sanksionimit të procedurave të qarta për të gjitha proceset e punës në njësitë e bashkisë.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objektivi, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 6 masa/aktivitete, nga të cilat:


- Janë realizuar 5 masa/aktivitete ose 83%
- Nuk është realizuar 1 masë/aktivitet ose 17%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 4. Objektivi III - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objektivi III	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Fuqizimi i Burimeve Njerëzore	6	5	0	1

Figura 5. Objektivi III - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektivi është realizuar në masën 83%, me zbatimin e masave/aktiviteteve si më poshtë:

- Trajnime periodike të punonjësve për ligjin “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” dhe rregullores përkatëse;
- Trajnime të punonjësve të bashkisë për ligjin “Për parandalimin e konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të funksioneve publike” dhe të rregullores përkatëse;
- Publikimi i rregullores “Për parandalimin e konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të funksioneve publike”, në Programin e Transparencës;

- Trajnime të brendshme për rritjen e njohurive të punonjësve dhe drejtuesve të bashkisë rreth shkeljeve të etikës dhe masave përkatëse disiplinore, në përputhje me Kodin e Sjelljes së Bashkisë;
- Organizimi i takimeve informuese nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore me të gjithë stafin menaxhues të drejtorive të bashkisë, për menaxhimin e burimeve njerëzore me fokus vlerësimin e performancës së stafit.

Konkluzione

Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi për periudhën raportuese janar-dhjetor 2025, bazuar në gjetjet që ky dokument ofron, të dhënat analitike të raportuara nga drejtoritë përkatëse dhe analizën e kryer, rezulton se:

Bashkia Pukë ka vijuar me zbatimin e Planit të Integritetit, duke arritur një nivel bazik realizimi prej 53% të masave të planifikuara për vitin 2025 (në intervalin 40-60%). Gjatë kësaj periudhe janë arritur rezultate pozitive në:

- Ngritjen e kulturës së integritetit dhe llogaridhënies në bashki;
- Transparencë më të lartë në publikimin e informacioneve;
- Trajnime periodike dhe aktivitete që mbështesin etikën institucionale;

Masat dhe aktivitetet e realizuara në kuadër të zbatimit të Planit të Integritetit kanë ndikuar ndjeshëm në rritjen e shkallës së integritetit të institucionit. Ky progres ka ndikuar në rritjen e shkallës së integritetit të Bashkisë Pukë.

Rekomandime

- Të vijojë puna për vlerësimin e riskut të integritetit mbi baza objektive, me qëllim hartimin e një plani për fuqizimin e integritetit, llogaridhënies dhe transparencës publike institucionale të Bashkisë Pukë;
- Forcimi i koordinimit dhe bashkëpunimit ndërmjet drejtorive, për një raportim më të rregullt mbi masat e Planit të Integritetit;
- Sigurimi i një raportimi periodik transparent, përmes publikimit të raporteve 6-mujore mbi zbatimin e Planit të Integritetit;
- Trajnimi në vijimësi i Koordinatorit të Integritetit të bashkisë.



RAPORT MONITORIMI

mbi Realizimin e Planeve të Integritetit
të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore

BASHKIA PËRMET

për periudhën
Janar – Dhjetor 2025

Monitorimi i zbatueshmërisë të Planit të Integritetit për vitin 2025

Raporti i Monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit të Bashkisë Përmet për vitin 2025 përbën dokumentin e parë të monitorimit të planit të veprimit të Planit të ri të Integritetit të bashkisë.

Plani i Integritetit është konceptuar për t'u zbatuar përgjatë një periudhe trevjeçare, konkretisht 2025-2027.

Në Planin e Integritetit të bashkisë janë përcaktuar gjithsej katër objektiva, për të cilat janë parashikuar fushat me risk, si dhe janë planifikuar masat dhe aktivitetet për realizimin e tyre, si vijon:

- **Objektivi I** - Forcimi, menaxhimi efektiv dhe zhvillimi i vazhdueshëm i burimeve njerëzore, për parandalimin dhe identifikimin e risqeve të integritetit për të gjitha nivelet dhe funksionet në bashki;
- **Objektivi II** - Menaxhimi i riskut të integritetit në fusha të veçanta të përgjegjësisë së bashkisë;
- **Objektivi III** - Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit;
- **Objektivi IV** - Përmirësimi i transparencës dhe llogaridhënies publike.

Për bashkinë Përmet, Plani i Integritetit për periudhën janar-dhjetor 2025, referuar Planit të Veprimit, përmban masa dhe aktivitete të planifikuara vetëm në kuadër të Objektivit II, III dhe IV, sipas përcaktimeve në Planin e Veprimit.

Situata e monitorimit të Planit të Integritetit të Bashkisë Përmet për periudhën janar–dhjetor 2025



Nga procesi i monitorimit rezulton se, në totalin prej 32 masash (aktivitetesh) të parashikuara për zbatim për vitin 2025:

- 19 masa/aktivitete janë realizuar plotësisht, që përfaqëson 59% të totalit
- 0 masa/aktivitete janë në proces realizimi, ose 0%
- 13 masa/aktivitete mbeten të parealizuara, ose 41%

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun vijues.

Tabela 1. Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Bashkia Përmet	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Numri i masave / aktiviteteve	32	19	0	13

Figura 1. Zbatimi i Planit të Integritetit, 2025 (%)**Figura 2. Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025**

Bashkia Përmet, gjatë vitit 2025, ka ndërmarrë një sërë hapash në drejtim të forcimit të qeverisjes së mirë dhe integritetit institucional. Në këtë kuadër, ka hartuar dhe miratuar disa dokumente strategjike që adresojnë forcimin e etikës dhe integritetit, përmirësimin e funksionimit të strukturave vendore antikorrupsion, konsolidimin e kuadrit të brendshëm institucional, zhvillimin dhe fuqizimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore, rritjen e rezistencës institucionale ndaj risqeve të integritetit, si dhe përmirësimin e transparencës dhe besueshmërisë publike. Bashkia ka realizuar masa/aktivitete të planifikuara për vitin 2025, sipas Planit të Veprimit, të cilat lidhen me Objektivin II, III dhe IV.

Gjetjet e Raportit

Objektivi II - Menaxhimi i riskut të integritetit në fusha të veçanta të përgjegjësisë së bashkisë

Nëpërmjet këtij objektivi synohet menaxhimi i riskut të integritetit në fushat kryesore të përgjegjësisë së bashkisë, duke u fokusuar në proceset e punës të vlerësuara si më të ekspozuarat ndaj rrezikut të korrupsionit. Në tërësinë e tij, menaxhimi i integritetit i Bashkisë Përmet paraqet sfida, të cilat janë parashikuar edhe në Strategjinë për Qeverisjen Vendore dhe që hasen më së shumti në fusha të veçanta të përgjegjësisë, të tilla si fusha e menaxhimit financiar, menaxhimi i pronave të bashkisë, shërbimet publike dhe arkivimi.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objektivi, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 11 masa/aktivitete, nga të cilat:


- Janë realizuar 7 masa/aktivitete ose 64%
- Nuk janë realizuar 4 masa/aktivitete ose 36%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 2. Objektivi II - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objektivi II	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Fusha të Veçanta	11	7	0	4

Figura 3. Objektivi II - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektiv është realizuar në masën 64%, me zbatimin e masave/aktiviteteve si më poshtë:

- Sigurimi i infrastrukturës së domosdoshme fizike (ambient i dedikuar) për administrim të efektshëm të dokumenteve arkivore;
- Publikimi i rregullt i njoftimeve për konsultimet publike, në faqen zyrtare të bashkisë dhe kanale të tjera të përshtatshme komunikimi;
- Përcaktimi i treguesve bazë të performancës (KPI);
- Përcaktimi i strukturave mbikëqyrëse dhe monitoruese të PPV-së;

- Hartimi dhe miratimi i procedurave dhe rregullave të rekrutimit dhe promovimit të burimeve njerëzore;
- Publikimi i këtyre procedurave në faqen zyrtare të bashkisë, për njohje dhe transparencë me publikun.

Objektivi III - Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit

Ky objektivi synon forcimin e kuadrit të brendshëm rregullator për etikën dhe integritetin, në përputhje me kornizën ligjore për vetëqeverisjen vendore, të drejtën e informimit, konsultimin publik, menaxhimin dhe kontrollin financiar, sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesit, parandalimin e konfliktit të interesit, etj.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objektivi, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 12 masa/aktivitete, nga të cilat:


- Janë realizuar 5 masa/aktivitete ose 42%
- Nuk janë realizuar 7 masa/aktivitete ose 58%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 3. Objektivi III - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objektivi III	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuar
Forcimi i Kuadrit Rregullator	12	5	0	7

Figura 4. Objektivi III - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektivi është realizuar në masën 42%, me zbatimin e masave/aktiviteteve si më poshtë:

- Koordinimi nëpërmjet platformës së DAP-it, ku të përditësohen kërkesat dhe nevojat për rekrutim;

- Komunikimi me kërkesë zyrtare me DAP-in;
- Hartimi i kuadrit rregullator të brendshëm dhe i PSV-së për pagesën dhe administrimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja;
- Informimi i personelit të bashkisë mbi këto rregulla;
- Publikimi i rregullores në Programin e Transparencës.

Objektivi IV - Përmirësimi i transparencës dhe llogaridhënies publike

Ky objektivi synon të forcojë strukturat dhe mekanizmat që funksionojnë në nivelin e vetëqeverisjes vendore, të cilat kontribuojnë në rritjen e integritetit institucional dhe veprojnë si instrumente antikorrupsion. Këto struktura dhe mekanizma ngrihen dhe funksionojnë në përputhje me kornizën ligjore për vetëqeverisjen vendore, të drejtën e informimit, konsultimin publik, menaxhimin dhe kontrollin financiar, sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesit, parandalimin e konfliktit të interesit, etj.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objektivi, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 9 masa/aktivitete, nga të cilat:


- Janë realizuar 7 masa/aktivitete ose 78%
- Nuk janë realizuar 2 masa/aktivitete ose 22%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 4. Objektivi IV - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objektivi IV	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Forcimi i transparencës dhe llogaridhënies	9	7	0	2

Figura 5. Objektivi IV - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektivi është realizuar në masën 78%, me zbatimin e masave/aktiviteteve si më poshtë:

- Hartimi i Raportit Vjetor të Transparencës në Procesin e Vendimmarrjes (Raporti i Konsultimit Publik), sipas parashikimeve të Ligjit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik;

- Miratimi dhe publikimi i Programit të Transparencës së bashkisë, në përputhje me udhëzimet e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe legjislacionin përkatës, si dhe përditësimi i vazhdueshëm i tij me informacionin e nevojshëm;
- Hartimi periodik i raporteve gjashtëmujore mbi të gjitha donacionet e përfituara nga bashkia (jo vetëm bashkëfinancimet me fonde IPA), sipas kërkesave të Rregullores së Këshillit Bashkiak;
- Publikimi në Programin e Transparencës i informacionit për donacionet e përfituara nga bashkia, duke përfshirë emrin e donatorit, shumën e donacionit dhe qëllimin e donacionit;
- Marrja e masave për përditësimin e faqes zyrtare të bashkisë, në seksionin “Taksa dhe Tarifa Vendore”;
- Publikimi i taksave dhe tarifave vendore për vitin aktual.

Konkluzione

Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi për periudhën raportuese janar-dhjetor 2025, bazuar në gjetjet që ky dokument ofron, të dhënat analitike të raportuara nga drejtoritë përkatëse dhe analizën e kryer, rezulton se Bashkia Përmet ka vijuar me zbatimin e Planit të Integritetit, duke arritur një nivel realizimi prej 59% të masave të planifikuara për vitin 2025 (në intervalin 40-60%). Gjatë kësaj periudhe janë arritur rezultate pozitive në:

- Ngritjen e kulturës së integritetit dhe llogaridhënies në bashki;
- Transparencë më të lartë në publikimin e informacioneve;
- Modernizimin e administratës përmes digjitalizimit të dokumentacionit;

Masat dhe aktivitetet e realizuara në kuadër të zbatimit të Planit të Integritetit kanë ndikuar ndjeshëm në rritjen e shkallës së transparencës së institucionit. Si rezultat, një sërë dokumentesh strategjike, aspekte të punës dhe të shërbimeve të ofruara, rezultatet e kontrolleve financiare, si dhe instrumentet për raportimin e korrupsionit apo shkeljeve të tjera, janë bërë të aksesueshme online në adresën zyrtare të bashkisë. Ky progres e ka renditur këtë objektiv në vend të parë, duke e pozicionuar bashkinë në një nivel proaktiv të transparencës.

Rekomandime

- Të vijojë puna për realizimin e masave/aktiviteteve të planifikuara në Planin e Integritetit;
- Rritja e pjesëmarrjes qytetare dhe nxitja e sinjalizimit, përmes krijimit të kanaleve efektive dhe anonime për denoncime;
- Forcimi i koordinimit dhe bashkëpunimit ndërmjet drejtorive, për një raportim më të rregullt mbi masat e Planit të Integritetit;
- Sigurimi i një raportimi periodik transparent, përmes publikimit të raporteve 6-mujore mbi zbatimin e Planit të Integritetit;
- Trajnimi në vijimësi i Koordinatorit të Integritetit të bashkisë.



RAPORT MONITORIMI

mbi Realizimin e Planeve të Integritetit
të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore

BASHKIA ROSKOVEC

për periudhën
Janar – Dhjetor 2025

Monitorimi i zbatueshmërisë të Planit të Integritetit për vitin 2025

Raporti i Monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit të Bashkisë Roskovec për vitin 2025 përbën dokumentin e tretë të monitorimit të planit të veprimit të Planit të Integritetit të bashkisë.

Plani i Integritetit është konceptuar për t'u zbatuar përgjatë një periudhe katërvjeçare, konkretisht 2023-2026.

Në Planin e Integritetit të bashkisë janë përcaktuar gjithsej katër objektiva, për të cilat janë parashikuar fushat me risk, si dhe janë planifikuar masat dhe aktivitetet për realizimin e tyre, si vijon:

- **Objektivi I** - Zhvillimi i burimeve njerëzore në bashki, për konsolidimin e një administrate të qëndrueshme dhe profesionale;
- **Objektivi II** - Përmirësimi i kuadrit rregullator dhe strategjik të bashkisë në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit;
- **Objektivi III** - Forcimi i transparencës proaktive dhe llogaridhënies publike;
- **Objektivi IV** - Menaxhimi i riskut të integritetit në fusha të veçanta të përgjegjësisë së bashkisë.

Për bashkinë Roskovec, Plani i Integritetit për periudhën janar-dhjetor 2025, referuar Planit të Veprimit, përmban masa dhe aktivitete të planifikuara sipas objektivave të përcaktuara në Planin e Veprimit.

Situata e monitorimit të Planit të Integritetit të Bashkisë Roskovec për periudhën janar–dhjetor 2025



Nga procesi i monitorimit rezulton se, në totalin prej 28 masash (aktivitetesh) të parashikuara për zbatim për vitin 2025:

- 15 masa/aktivitete janë realizuar plotësisht, që përfaqëson 54% të totalit
- 0 masa/aktivitete janë në proces realizimi, ose 0%
- 13 masa/aktivitete mbeten të porealizuara, ose 46%

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun vijues.

Tabela 1. Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Bashkia Roskovec	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të porealizuara
Numri i masave / aktiviteteve	28	15	0	13

Figura 1. Zbatimi i Planit të Integritetit, 2025 (%)**Figura 2. Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025**

Bashkia Roskovec, gjatë vitit 2025, ka ndërmarrë një sërë hapash në drejtim të forcimit të qeverisjes së mirë dhe integritetit institucional. Në këtë kuadër, janë hartuar dhe miratuar disa dokumente strategjike që adresojnë forcimin e etikës dhe integritetit, përmirësimin e funksionimit të strukturave vendore antikorruption, konsolidimin e kuadrit të brendshëm institucional, zhvillimin dhe fuqizimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore, rritjen e rezistencës institucionale ndaj risqeve të integritetit, si dhe përmirësimin e transparencës dhe të besueshmërisë publike.

Gjetjet e Raportit

Objektivi I - Zhvillimi i burimeve njerëzore në bashki, për konsolidimin e një administrate të qëndrueshme dhe profesionale

Ky objektivi synon të përforcojë mirëfunksionimin e administratës së institucionit, nëpërmjet forcimit të kapaciteteve njerëzore, trajnimit dhe rekrutimit të stafit të nevojshëm në përputhje

me strukturën dhe organikën, si dhe sanksionimit të procedurave të qarta për të gjitha proceset e punës në njësitë e bashkisë.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objekti, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 8 masa/aktivitete, nga të cilat:


- Janë realizuar 6 masa/aktivitete ose 75%
- Nuk janë realizuar 2 masa/aktivitete ose 25%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 2. Objekti I - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objekti I	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Fuqizimi i Burimeve Njerëzore	8	6	0	2

Figura 3. Objekti I - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektiv është realizuar në masën 75%, me zbatimin e masave/aktiviteteve si më poshtë:

- Rekrutimi i burimeve njerëzore të nevojshme, për plotësimin e vakancave në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Juridike;
- Ngritja e Komisionit të Përhershëm Disiplinor, në fillim të çdo viti;
- Organizimi i takimeve konsultuese me Zyrën e Komisionerit për Shërbimin Civil, për të adresuar problematikën sistematike të bashkisë në lidhje me plotësimin e vakancave në shërbimin civil me punonjës pa statusin e nëpunësit;
- Përfundimi i procesit të përditësimit dhe verifikimit të dosjeve të personelit;
- Zhvillimi i takimeve informuese me drejtoritë e bashkisë në lidhje me rëndësinë e procesit të vlerësimit të performancës së punonjësve;

- Zëvendësimi eventual i trajnimeve online për stafin me trajnime fizike, për të rritur efektivitetin.

Objektivi II - Përmirësimi i kuadrit rregullator dhe strategjik të bashkisë në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit

Ky objektivi synon të forcojë strukturat dhe mekanizmat që funksionojnë në nivelin e vetëqeverisjes vendore, të cilat kontribuojnë në rritjen e integritetit institucional dhe veprojnë si instrumente antikorrupsion. Këto struktura dhe mekanizma ngrihen dhe funksionojnë në përputhje me kornizën ligjore për vetëqeverisjen vendore, të drejtën e informimit, konsultimin publik, menaxhimin dhe kontrollin financiar, sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesit, parandalimin e konfliktit të interesit, etj.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objektivi, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 3 masa/aktivitete, nga të cilat:


- Janë realizuar 2 masa/aktivitete ose 67%
- Nuk është realizuar 1 masë/aktivitet ose 33%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 3. Objektivi II - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objektivi II	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuar
Forcimi i Kuadrit Rregullator	3	2	0	1

Figura 4. Objektivi II - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektivi është realizuar në masën 67%, me zbatimin e masave/aktiviteteve si më poshtë:

- Hartimi dhe miratimi i Kodit të Sjelljes për administratën e bashkisë;

- Organizimi i takimeve informuese me punonjësit e bashkisë, për të siguruar njohjen e Kodit të Sjelljes nga i gjithë personeli.

Objektivi III - Forcimi i transparencës proaktive dhe llogaridhënies publike

Transparenca e bashkisë gjatë procesit të zbatimit të politikave vendore është shumë e rëndësishme për rritjen e pjesëmarrjes së aktorëve të ndryshëm në veprimtarinë e bashkisë dhe të publikut në tërësi. Në këtë kuadër, është me rëndësi edhe siguri i pjesëmarrjes së publikut në procesin e identifikimit të prioritetëve strategjike afatgjatë. Për këtë arsye, bashkia angazhohet të forcojë mekanizmat e pjesëmarrjes për shoqërinë civile dhe grupe të veçanta të interesit, gjatë hartimit dhe konsultimit të dokumenteve të politikave të ndryshme vendore.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objekti, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 8 masa/aktivitete, nga të cilat:


- Janë realizuar 5 masa/aktivitete ose 62%
- Nuk janë realizuar 3 masa/aktivitete ose 38%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 4. Objektivi III - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objektivi III	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Forcimi i transparencës dhe llogaridhënies	8	5	0	3

Figura 5. Objektivi III - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektivi është realizuar në masën 62%, me zbatimin e masave/aktiviteteve si më poshtë:

- Ristrukturimi i Programit të Transparencës, duke mundësuar publikimin e materialeve në formate lehtësisht të aksesueshme për publikun, etj.;

- Publikimi i informacionit për shërbimet publike dhe shërbimet administrative, në Programin e Transparencës;
- Organizimi i proceseve transparente dhe gjithëpërfshirëse të konsultimit publik, për dokumentacionin e planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të territorit;
- Publikimi i rregullt i raporteve të auditit në Programin e Transparencës, në respektim të detyrimeve të ligjit për të drejtën e informimit;
- Publikimi i informacionit të plotë dhe të kuptueshëm për publikun, në Programin e Transparencës së bashkisë, për dokumentacionin e nevojshëm për marrjen e lejeve dhe licencave, detyrimet ligjore që shoqërojnë veprimtarinë ndërtimore dhe penaltitetet përkatëse.

Objektivi IV - Menaxhimi i riskut të integritetit në fusha të veçanta të përgjegjësisë së bashkisë

Ky objektivi synon adresimin e risqeve të integritetit në fushat funksionale të përgjegjësisë së bashkisë. Masat e parashikuara synojnë të përmirësojnë efektivitetin, eficiencën dhe cilësinë e proceseve të punës në fushat funksionale të bashkisë, me qëllim përmirësimin e shërbimeve publike, planifikimin e territorit, menaxhimin e pronave dhe aseteve publike, menaxhimin financiar, etj.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objektivi, për vitin 2025 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 9 masa/aktivitete, nga të cilat:


- Janë realizuar 2 masa/aktivitete ose 22%
- Nuk janë realizuar 7 masa/aktivitete ose 78%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 5. Objektivi IV - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objektivi IV	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të parealizuara
Fusha të Veçanta	9	2	0	7

Figura 6. Objektivi IV - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektiv është realizuar në masën 22%, me zbatimin e masave/aktiviteteve si më poshtë:

- Marrja e masave administrative dhe ligjore për vjeljen e detyrimeve të pashlyera të të tretëve ndaj bashkisë;
- Përfundimi i procesit të inventarizimit të fondit arkivor.

Konkluzione

Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi për periudhën raportuese janar-dhjetor 2025, bazuar në gjetjet që ky dokument ofron, të dhënat analitike të raportuara nga drejtoritë përkatëse dhe analizën e kryer, rezulton se:

Bashkia Roskovec ka vijuar me zbatimin e Planit të Integritetit, duke arritur një nivel mesatar realizimi prej 54% të masave të planifikuara për vitin 2025 (në intervalin 40-60%). Gjatë kësaj periudhe janë arritur rezultate në drejtim të:

- Ngritjes së kulturës së integritetit në bashki;
- Transparencës më të lartë në publikimin e informacioneve;
- Zhvillimit dhe procedurave të rekrutimit të burimeve njerëzore;

Masat dhe aktivitetet e realizuara në kuadër të zbatimit të Planit të Integritetit kanë ndikuar në rritjen e integritetit institucional. Si rezultat, një sërë dokumentesh strategjike, aspekte të punës dhe të shërbimeve të ofruara, rezultatet e kontroleve financiare, si dhe instrumentet për raportimin e korrupsionit apo shkeljeve të tjera, janë bërë të aksesueshme online në adresën zyrtare të bashkisë, si dhe ka përfunduar procesi i inventarizimit të fondit arkivor.

Rekomandime

- Të vijohet me realizimin e masave dhe aktiviteteve të planifikuara në Planin e Integritetit, mbi përmirësimin e kuadrit rregullator;
- Marrja e masave për rritjen e pjesëmarrjes qytetare dhe metodave për nxitjen e sinjalizimit, përmes krijimit të kanaleve efektive dhe anonime për denoncime;
- Forcimi i koordinimit dhe bashkëpunimit ndërmjet drejtorive, për një raportim më të rregullt mbi masat e Planit të Integritetit;
- Sigurimi i një raportimi periodik transparent, përmes publikimit të raporteve 6-mujore mbi zbatimin e Planit të Integritetit;
- Trajnimi në vijimësi i Koordinatorit të Integritetit të bashkisë.



RAPORT MONITORIMI

mbi Realizimin e Planeve të Integritetit
të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore

BASHKIA SHIJAK

për periudhën
Janar – Dhjetor 2025

Monitorimi i zbatueshmërisë të Planit të Integritetit për vitin 2025

Raporti i Monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit të Bashkisë Shijak për vitin 2025 përbën dokumentin e katërt të monitorimit të planit të veprimit të Planit të Integritetit të bashkisë.

Plani i Integritetit është konceptuar për t'u zbatuar përgjatë një periudhe katërvjeçare, konkretisht 2022-2025.

Në Planin e Integritetit të bashkisë janë përcaktuar gjithsej pesë objektiva, për të cilat janë parashikuar fushat me risk, si dhe janë planifikuar masat dhe aktivitetet për realizimin e tyre, si vijon:

- **Objektivi I** - Përmirësimi i procesit të menaxhimit të riskut të integritetit në fushën e menaxhimit të pronave dhe planifikimit të territorit;
- **Objektivi II** - Efikasitet, efektivitet dhe cilësi e përmirësuar e veprimtarisë funksionale të bashkisë, përmes menaxhimit të risqeve në fushat funksionale dhe proceset përkatëse të punës së bashkisë, duke forcuar rezistencën institucionale ndaj shkeljeve të integritetit;
- **Objektivi III** - Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator në aspektet e veçanta të etikës dhe integritetit;
- **Objektivi IV** - Përforcimi i integritetit institucional të bashkisë, përmes menaxhimit dhe zhvillimit të burimeve njerëzore, si dhe forcimit të shërbimeve publike dhe mbështetëse;
- **Objektivi V** - Forcimi i llogaridhënies publike dhe transparencës së bashkisë, për rritjen e besimit dhe përfshirjes së qytetarëve ndaj veprimtarisë së bashkisë.

Për bashkinë Shijak, Plani i Integritetit për periudhën janar-dhjetor 2025, referuar Planit të Veprimit, përmban masa dhe aktivitete të planifikuara në vijimësi, kryesisht në kuadër të Objektivit IV.

Situata e monitorimit të Planit të Integritetit të Bashkisë Shijak për periudhën janar–dhjetor 2025



Nga procesi i monitorimit rezulton se, në totalin prej 13 masash (aktivitetesh) të parashikuara në vijimësi për zbatim për vitin 2025:

- 7 masa/aktivitete janë realizuar plotësisht, që përfaqëson 54% të totalit
- 1 masë/aktivitet është në proces realizimi, ose 8%
- 5 masa/aktivitete mbeten të porealizuara, ose 38%

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun vijues.

Tabela 1. Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Bashkia Shijak	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të porealizuara
Numri i masave / aktiviteteve	13	7	1	5

Figura 1. Zbatimi i Planit të Integritetit, 2025 (%)**Figura 2. Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025**

Sa më sipër, gjatë vitit 2025, Bashkia Shijak ka realizuar masa/aktivitete në vijimësi, në drejtim të forcimit të qeverisjes së mirë dhe integritetit institucional. Në kuadër të zbatimit të masave të planifikuara në vijimësi të Objektivit IV, janë hartuar dhe miratuar disa dokumente strategjike që adresojnë forcimin dhe konsolidimin e kuadrit të brendshëm institucional, zhvillimin dhe fuqizimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore, për rritjen e rezistencës institucionale ndaj risqeve të integritetit.

Gjetjet e Raportit

Objektivi IV - Përforcimi i integritetit institucional të bashkisë, përmes menaxhimit dhe zhvillimit të burimeve njerëzore, si dhe forcimit të shërbimeve publike dhe mbështetëse

Ky objektivi synon forcimin e procesit të zhvillimit të burimeve njerëzore dhe të shërbimeve publike e mbështetëse në bashki, me qëllim identifikimin dhe parandalimin e risqeve të integritetit. Përmirësimi i proceseve të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe shërbimeve

mbështetëse në institucion do të sigurojë zhvillimin e kapaciteteve dhe aftësive të nevojshme në kuadër të zbatimit dhe konsolidimit të mekanizmave garantues të integritetit në institucion, me qëllim rritjen e profesionalizimit të personelit dhe përmirësimin e integritetit të zyrtarëve.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objekti, për vitin 2025 janë planifikuar në vijimësi për t'u realizuar gjithsej 13 masa/aktivitete, nga të cilat:


- Janë realizuar 7 masa/aktivitete ose 54%
- Është në proces realizimi 1 masë/aktivitet ose 8%
- Nuk janë realizuar 5 masa/aktivitete ose 38%.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 2. Objekti IV - Shkalla e realizimit të masave/aktiviteteve, 2025

Objekti IV	Masa gjithsej	Masa të realizuara	Masa në proces	Masa të përealizuara
Përforcimi i Integritetit Institucional	13	7	1	5

Figura 3. Objekti IV - Zbatimi i masave/aktiviteteve të planeve të integritetit



Për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2025, ky objektiv është realizuar në masën 54%, me zbatimin e masave/aktiviteteve si më poshtë:

- Informimi periodik i punonjësve të bashkisë për rregullat mbi veprimtaritë e jashtme të punonjësve të bashkisë;
- Informimi periodik i stafit të bashkisë për rregullat e komunikimit brenda bashkisë, sipas rregullores së miratuar për këtë qëllim;
- Informimi periodik i stafit të bashkisë për njësinë përgjegjëse të konfliktit të interesit, regjistrin përkatës dhe procesin e KI-së;
- Kryerja nga DBNJ-ja e njoftimeve paraprake, drejtuesve të drejtorive, për afatet e procesit;

- Hartimi i një formati tip në nivel bashkie, i vlerësimit të trajnimeve të kryera nga punonjësit e bashkisë;
- Ofrimi i trajnimeve të brendshme dhe të jashtme, për punonjësit e bashkisë, mbi procesin e sinjalizimit;
- Publikimi i të dhënave të njësisë përgjegjëse për sinjalizimet.

Konkluzione

Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi për periudhën raportuese janar-dhjetor 2025, bazuar në gjetjet që ky dokument ofron, të dhënat analitike të raportuara nga drejtoritë përkatëse dhe analizën e kryer, rezulton se:


Bashkia Shijak ka vijuar me zbatimin e masave të planifikuara në vijimësi të Planit të Veprimit, duke arritur një nivel realizimi prej 54% të masave të planifikuara për vitin 2025 (në intervalin 40-60%). Gjatë kësaj periudhe janë arritur rezultate pozitive në vijimësi, në drejtim të:

- Informimit periodik të punonjësve të bashkisë për rregullat mbi veprimtaritë e jashtme të punonjësve të bashkisë;
- Informimit periodik të stafit të bashkisë për njësinë përgjegjëse të konfliktit të interesit, regjistrin përkatës dhe procesin e KI-së;
- Ofrimit të trajnimeve të brendshme dhe të jashtme, për punonjësit e bashkisë, mbi procesin e sinjalizimit;
- Publikimit të të dhënave të njësisë përgjegjëse për sinjalizimet.

Këto zhvillime kanë ndikuar pozitivisht në rritjen dhe krijimin e një kulture integriteti, si dhe në forcimin e besueshmërisë publike ndaj institucionit.

Rekomandime

- Të vijojë puna për hartimin e Planit të ri të Integritetit të bashkisë;
- Forcimi i koordinimit dhe bashkëpunimit ndërmjet drejtorive, për një raportim më të rregullt mbi masat e Planit të Integritetit;
- Sigurimi i një raportimi periodik transparent, përmes publikimit të raporteve 6-mujore mbi zbatimin e Planit të Integritetit;
- Trajnimi në mënyrë periodike i Koordinatorit të Integritetit të bashkisë.



RAPORT MONITORIMI

mbi Realizimin e Planeve të Integritetit
të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore

BASHKIA TIRANË

për periudhën
Janar – Dhjetor 2025

Monitorimi i zbatueshmërisë të Planit të Integritetit për vitin 2025

Raporti i Monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2025 përbën dokumentin e katërt të monitorimit të planit të veprimit të Planit të Integritetit të bashkisë.

Plani i Integritetit është konceptuar për t'u zbatuar përgjatë një periudhe katërvjeçare, konkretisht 2022-2025.

Në Planin e Integritetit të bashkisë janë përcaktuar gjithsej tre objektiva, për të cilat janë parashikuar fushat me risk, si dhe janë planifikuar masat dhe aktivitetet për realizimin e tyre, si vijon:

- **Objektivi I** - Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator, institucional dhe financiar në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit;
- **Objektivi II** - Menaxhimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore në bashki, për parandalimin dhe identifikimin e risqeve të integritetit për të gjitha nivelet dhe funksionet në bashki;
- **Objektivi III** - Menaxhimi i riskut të integritetit për të gjithë bashkinë, me fokus në fusha të veçanta të përgjegjësisë.

